



INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI
KOSOVO LAW INSTITUTE
KOSOVSKI INSTITUT PRAVDE

02/2020

DREJTËSIA NË SHKALLË TË DYTË



PRISHTINË, MARS 2020

Autor: Lavdim Bajraktari

Redaktorët: Ehat Miftaraj, Betim Musliu, Gzim Shala dhe Yll Zekaj

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rustem Statovci

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Përkrahur nga:

Mars 2020

Prishtinë, Republika e Kosovës



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive	4
2. Metodologjia	7
3. Mandati ligjor dhe organizimi i Gjykatës së Apelit	8
4. Ngarkesa e Gjykatës së Apelit me lëndë.....	9
5. Performanca individuale e Gjyqtarëve të GjA-së	17
5.1 Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil	18
5.2 Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal.....	19
5.3 Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni i Kundërvajtjes	19
5.4 Departamenti i Krimeve të Rënda.....	19
5.5 Departamenti Special për Lëndët në Kompetencë të Prokurorisë Speciale	20
5.6 Departamenti për Çështje Ekonomike	21
5.7 Departamenti për të Mitur.....	21
5.8 Departamenti për Çështje Administrative.....	21
5.9 Divizioni i Gjykatës së Apelit në Mitrovicë të Veriut	22
6. Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rasteve dhe punën e GjA-së	24
7. Trajtimi i rasteve të korrupsionit në Gjykatën e Apelit	32
8. Analizë e veçantë e trajtimit të rasteve të korrupsionit nga Apeli	37
8.1 Rastet e profilit të lartë.....	38
9. Rastet tjera të profilit jo të lartë	65
9.1 Vërtetim i aktgjykimeve liruese.....	65
9.2 Vërtetim i aktgjykimeve dënuese.....	66
9.3 Ndryshim i aktgjykimeve.....	68
9.4 Kthimi i rasteve në rigjykim	68
10. Trajtimi i rasteve të korrupsionit me rastin e konfirmimit/hudhjeve të aktakuzave	70
11. Analizë e rasteve të përzgjedhura jo-korrupsion	73
11. Rekomandime	80

1. Përmbledhje ekzekutive

Sikurse vitet e kaluara, edhe vitet 2018 dhe 2019, Kosova i ka mbyllur pa as edhe një zyrtar të lartë prapa grilave për shkak të korrupsionit, përkundër asaj që në shumicën e matjeve të bëra, Kosova vazhdon të renditet si një ndër vendet më të korruptuara në Evropë. Në raportet ndërkombëtare, korrupsioni në Kosovë cilësohet si endemik, Kosova si shtet i kapur, derisa sistemi i drejtësisë cilësohet si lehtë i ndikueshëm nga politika.

Mungesa e luftës kundër korrupsionit, e sidomos e korrupsionit të profilin të lartë është pasqyruar më së miri edhe në raportet që IKD në periudha të rregullta ka publikuar, sidomos gjatë vitit 2018 dhe 2019, por edhe në raportet e organizatave ndërkombëtare si Transparency International, ku Kosova për dallim nga viti 2017, në vitin 2018 renditej edhe më poshtë për sa i përket indeksit të perceptimit të korrupsionit. Sipas kësaj organizate ndërkombëtare, Kosova ka pësuar përsëri regres në vitin 2019, pasi raporti i kësaj organizate për vitin 2019, e rangon Kosovën edhe më poshtë se sa në vitin 2018.

Si gjykatë e shkallës së dytë, aktgjykimet e të cilës janë të plotfuqishme, Gjykata e Apelit në vitet 2018 dhe 2019, nuk ka pas asnjë aktgjykim dënues për zyrtarët e profilin të lartë të akuzuar për korrupsion.

Madje, edhe dy zyrtarë të profilin të lartë që ishin dënuar nga gjykatat e shkallës së parë për korrupsion, Gjykata e Apelit kishte vendosur t'i lirojë nga akuzat dhe të njëjtit t'i shpall të pafajshëm, kurse në katër raste tjera, Apeli i kishte anuluar aktgjykimet dënuese të gjykatave të shkallës së parë ndaj zyrtarëve të lartë publik të akuzuar për korrupsion dhe lëndët i kishte kthyer në rigjykim.

Të kundërtën e kësaj apo ndryshimin e aktgjykimeve liruese të shkallës së parë në dënuese, apo kthimin në rigjykim të rasteve kur zyrtarë të lartë publik ishin liruar nga shkalla e parë, Apeli se kishte bërë në asnjë rast gjatë dy viteve të kaluara.

Shikuar nga pikëpamja kohore, lëndët e korrupsionit në GjA nuk presin shumë kohë për tu zgjidhur, përjashtimisht ndonjë rast, sikurse kishte qenë rasti "MTPT", i cili kishte pritur më shumë se një vit për tu shqyrtuar ankesat nga ana e Apelit.¹

GjA, gjatë vitit 2018 kishte pasur në punë gjithsej 125 lëndë të korrupsionit. Prej tyre, deri në fund të vitit, kjo gjykatë kishte arritur të përfundojë 107 nga këto lëndë, apo 85.6 % të lëndëve që kishte pasur në punë.

Ndërsa, gjatë vitit 2019, Apeli ka pasur në punë gjithsej 107 lëndë të korrupsionit, nga të cilat kishte zgjidhur 88, apo 82.24 %, të lëndëve të kësaj natyre që kishte pasur në punë.

¹ "Zvarritjet nga Gjykata e Apelit mbajnë aktive aktakuzën në rastin e MTPT-së ndaj Fatmir Limajt, Endrit Shalës dhe të tjerëve". Betimi për Drejtësi (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/zvarritjet-nga-gjykata-e-apelit-mbajne-aktakuzen-ne-rastin-e-mtpt-se-ndaj-fatmir-limajt-endrit-shales-dhe-te-tjereve/>) (Qasur së fundi më, 15 janar 2020).

Shikuar në total sipas statistikave të lëndëve të kryera, vitet 2018 dhe 2019 kishin qenë të suksesshme për Gjykatën e Apelit, pasi vërehet se ka rritje të vazhdueshme të numrit të lëndëve që kryhen nga kjo gjykatë.

Mirëpo, se sa ka ndikuar numri i madh i lëndëve të kryera në cilësinë e vendimeve që ka nxjerrë Apeli, flet më së miri deklarata që Kryetari i Gjykatës së Apelit, Hasan Shala e kishte dhënë në janar të 2019, gjatë prezantimit të raportit vjetor për gjykatën ku udhëheq, ku ndër të tjera e kishte pranuar që deri tani, më shumë i kanë kushtuar rëndësi statistikave se sa cilësisë.²

Mungesën e cilësisë të aktgjykimeve të Apelit, sidomos në rastet e korrupsionit, mund të shohim edhe në vendimet që Gjykata Supreme ka marr gjatë kësaj periudhe, e cila në disa raste, duke përfshirë këtu raste të profilit të lartë, kishte konstatuar shkelje në favor të pandehurve që kishte bërë Gjykata e Apelit dhe Gjykatat Themelore. Gjykata Supreme kishte vendosur kështu në rastin e ish-kryetarit të Komunës së Obiliqit, Mehmet Krasniqi, ish-zëvendëskryeministrit Dalibor Jevtiq, ish-Kryetarit të Gjykatës së Apelit, Salih Mekaj si dhe në rastin “Sekseri” ku i akuzuari kishte qenë Emin Beqiri.

Në pamundësi ligjore për të anuluar këto aktgjykime të Apelit, Supremja vetëm kishte konstatuar shkeljet e bëra nga shkallët më të ulëta të gjyqësorit, ndërsa, të akuzuarit kishin përfituar duke u liruar përfundimisht nga akuzat të cilat rëndonin mbi ta.

Po ashtu, përkundër kritikave që vet kreu i Apelit, Hasan Shala, kishte pasur lidhur me politikën ndëshkimore për rastet e korrupsionit, sipas monitorimit të IKD-së, del se Apeli, edhe pse në kuadër të autorizimeve të veta mund edhe të ashpërsojë dënimet e shkallës së parë kur këto lëndë vinë me ankesa në Apel, një gjë të tillë e kishte bërë në vetëm në një rast të korrupsionit gjatë vitit 2018, kurse gjatë vitit 2019 e kishte bërë vetëm në dy raste.

Në këtë mënyrë, akterët e GjA-së politikën ndëshkimore e kishin kritikuar, por nuk e kishin adresuar.

Luftimi i korrupsionit ishte dhe vazhdon të mbetet edhe kërkesë e Bashkimit Evropian për liberalizimin e vizave dhe për këtë arsye, nga ana e Prokurorit të Shtetit, dhjetëra lëndë janë shënjestruar për këtë proces. Lidhur me këto lëndë, kreu i Apelit, Hasan Shala, ka deklaruar se të gjitha lëndët e shënjestruara ishin përfunduar nga Apeli. Megjithatë, një deklaram i tillë i Shalës, sipas gjetjeve të IKD-së kishte dalur se nuk është i saktë. Kjo, pasi që në një përgjigje zyrtare që IKD ka marr nga Gjykata e Apelit më 24 janar 2019, apo 14 ditë pas konferencës së lartpërmendur del se kjo gjykatë ka pas në punë pesë lëndë të shënjestruara për viza edhe pse kryetari Shala kishte thënë se të gjitha lëndët e tilla ishin përfunduar nga Apeli.

Gjykata e Apelit, në kuadër të autorizimeve që ka, mund edhe t'i prishë aktgjykimet e shkallës së parë dhe lëndët t'i kthej në rigjykim. Vendime të tilla, pra kthimin e lëndëve në rigjykim, Apeli kishte vendosur në rreth 20 % të lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2018.

² “Kryetari i Apelit thotë se i kanë kryer të gjitha lëndët e shënjestruara për viza, bzn thirrje të ndalet bojkoti i avokatëve”. Betimi për Drejtësi (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kryetari-i-apelit-thote-se-i-kane-kryer-te-gjitha-lendet-e-shenjestruara-per-viza-ben-thirrje-te-ndalet-bojkoti-i-avokateve/>) (Qasur së fundi më 15 janar 2020).

Vitin 2019, përqindja e lëndëve që ishin kthyer në rigjykim kishte pësuar një rritje, ashtu që rreth 29 % të lëndëve të korrupsioni që ishin kryer gjatë vitit 2019 ishin kthyer në rigjykim nga Apeli. Disa nga këto raste, ishin kthyer në rigjykim nga dy apo edhe tre herë, çka në të paktën një rast të profilit të lartë, kishte bërë që edhe vepra penale të parashkruhet.

Funksionalizimi i plotë i Divizionit të Gjykatës së Apelit në Mitrovicë gjatë vitit 2018, themeluar sipas Marrëveshjes së Brukselit, ishte quajtur histori suksesi nga kryetari i Apelit, Hasan Shala, kur ky i fundit kishte prezantuar punën e Apelit gjatë vitit 2018. Megjithatë, ky divizion që përbëhej nga shtatë gjyqtar, sipas lëndëve të kryera gjatë dy viteve të kaluara del se as për së afërmi nuk i ngjan një historie suksesi.

Po ashtu, një problem deri diku banal sipas gjetjeve të IKD-së del edhe drejtshkrimi i disa nga aktgjykimet e Gjykatës së Apelit, në të cilat vërehen gabime drejtshkimore të theksuara, si mungesa e përdorimit të shkronjave “ë” dhe “ç”, pastaj mos përdorimi i shenjave të pikësimit e deri te gabimi i datave të ndryshme apo edhe emrave të palëve në procedurë. Këtë shqetësim IKD e ngritë për shkak se shpeshherë këto gabime i bëjnë këto aktgjykime të pakuptueshme. Për më tepër, IKD gjen se në disa prej aktgjykimeve të GjA-së mungon edhe arsyetimi i mjaftueshëm mbi vendimin e marrë.

2. Metodologjia

IKD me qëllim që të përpilojë një raport sa më gjithëpërfshirës dhe analitik, në lidhje me Gjykatën e Apelit, ka përdorur metodologji të përzier të hulumtimit.

Ky raport i IKD-së është bazuar në të dhënat e siguruar nga dokumente të ndryshme zyrtare, legjislacion primar dhe sekondar, raporte zyrtare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Gjykatës së Apelit, si dhe të dhënat të siguruar përmes kërkesave për informata dhe qasje në dokumente zyrtare nga institucionet relevante.

IKD bazuar në obligimet ligjore dhe politikat e Këshillit Prokurorial dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ka krijuar indikator të qartë për matjen e progresit në zbatimin e tyre nga sistemi prokurorial dhe sistemi gjyqësor.

Po ashtu, raporti është bazuar edhe në monitorimin sistematik që IKD i ka bërë Gjykatës së Apelit tash e disa vite. Të gjitha rastet e monitoruara publikohen në platformat online të IKD-së, në faqen www.betimiperdrejtesi.com dhe www.judiciary.org.

Ky raport përfshinë periudhën kohore nga 1 janari 2018 e deri më 31 dhjetor 2019, gjatë të cilës periudhë IKD, ka monitoruar gjithsej 438 seanca gjyqësore në Gjykatën e Apelit, ku përfshihen 438 raste me 818 të akuzuar për vepra të ndryshme penale.

Të gjitha gjetjet e monitorimit sistematik grumbullohen në Qendrën e IKD-së në Prishtinë, në të cilën analistët juridikë të IKD-së zhvillojnë hulumtim ligjor dhe praktik me të dhënat e siguruar.

Kjo metodologji e hulumtimit ofron mundësi praktike që të bëhet identifikimi i problemeve dhe të analizohen të gjitha çështjet që kanë në interes në shërbim të zbatimit të ligjit.

Seancat gjyqësore të monitoruara në Gjykatën e Apelit përfshijnë një numër të madh së të akuzuarve për vepra të ndryshme penale, megjithatë, ky raport i ka trajtuar në mënyrë më specifike rastet që kanë pasur të bëjnë me veprat penale të korrupsionit, e sidomos ato të profilit të lartë. Po ashtu, raporti i trajton edhe disa raste karakteristike, të cilat nuk bëjnë pjesë në rastet e korrupsionit.

Gjetjet e IKD-së janë trajtuar me anë të krahasimit të rasteve, punës me të dhëna statistikore dhe analizimit të thuktë të çdo veprimi apo vendimi nga sistemi i drejtësisë përkritazi me pajtueshmërinë e tyre me legjislacionin në fuqi.

3. Mandati ligjor dhe organizimi i Gjykatës së Apelit

E drejta për mjetet juridike si një e drejtë themelore e të drejtave të njeriut është e garantuar edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përkatësisht në nenin 32 të saj.³

Të gjithë palët e pakënaqura me vendimet e marra nga gjykatat e shkallës së parë, ligji ua garanton të drejtën e ankesës në Gjykatën e Apelit, për të cilin qëllim edhe është themeluar vetë Gjykata e Apelit.

Mandati ligjor, kompetencat dhe organizimi i Gjykatës së Apelit është përcaktuar me Ligjin për Gjykatat, përkatësisht me nenet 21, 22 dhe 24 të këtij ligji.⁴

Gjykata e Apelit, e themeluar si gjykatë e shkallës së dytë ka juridiksion territorial në gjithë Republikën e Kosovës.

Në kuadër të kësaj gjykate funksionojnë gjashtë departamente, përkatësisht: Departamenti i Përgjithshëm, Departamentin për Krime të Rënda, Departamentin për Çështje Ekonomike, Departamentin për Çështje Administrative, Departamenti për të Mitur dhe Departamenti Special për Lëndët në Kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.

Ky i fundit, është formuar me Ligjin e ri të Gjykatave, që ka hyrë në fuqi më 2 janar 2019, dhe ka në kompetencë lëndët që janë kompetencë e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.⁵

Po ashtu, në kuadër të Departamentit të Përgjithshëm funksionojnë tre divizione: Divizioni Civil, Divizioni Penal dhe Divizioni për Kundërvajtje.

Në përputhje me Marrëveshjet e Brukselit⁶ dhe shtojcën e rregullores së KGJK-së për organizimin e brendshëm të gjykatave, gjatë vitit 2018 është funksionalizuar edhe Divizioni i Gjykatës së Apelit në Mitrovicën e Veriut, i cili divizion, gjykon lëndët e katër komunave me shumicë serbe që gjenden në veri të Kosovës, përkatësisht Mitrovicës së Veriut, Zubin Potokut, Zveçanit dhe Leposaviqit.

Si gjykatë e shkallës së dytë, Gjykata e Apelit është kompetente për të shqyrtuar të gjitha ankesat e ushtruara kundër vendimeve të Gjykatave Themelore, të vendosë në shkallë të tretë, sipas ankesës që është e lejuar me Ligj dhe për konfliktin e juridiksionit ndërmjet gjykatave themelore dhe raste të tjera siç përcaktohet me Ligj.

Gjykata e Apelit shqyrton dhe gjykon lëndët në kolegji prej tre gjyqtarëve profesionistë, përveç nëse me ligj parashihet ndryshe.

³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 32.

⁴ LIGJI Nr. 06/L – 054 – për Gjykatat, nenet 21,22 dhe 24.

⁵ Po aty, neni 24. 1.1.4

⁶ Marrëveshjet e arritura në Bruksel me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian në mes të Kosovës dhe Serbisë.


Në dhjetor 2019, në të gjitha departamentet, Gjykata e Apelit kishte pasur gjithsej 52 gjyqtarë.⁷

4. Ngarkesa e Gjykatës së Apelit me lëndë

Vitin 2018, Gjykata e Apelit e kishte filluar me 12 mijë e 576 lëndë të trashëguara nga vitet paraprake. Shumica e këtyre lëndëve i takonin Departamentit të Përgjithshëm – Divizionit Civil.⁸

Numri total i lëndëve të pranuar në Gjykatën e Apelit, gjatë vitit 2018, kishte qenë 14 mijë e 21 lëndë.⁹

Nëse marrim në total numrin e lëndëve të trashëguara dhe atyre të pranuar, Gjykata e Apelit gjatë vitit 2018, del se ka pasur në punë gjithsej 26 mijë e 597 lëndë.



Grafika 1 – Lëndët e trashëguara dhe ato të pranuar gjatë vitit 2018.


Në total, nga 26 mijë e 597 lëndë që kishte pasur në punë, Gjykata e Apelit gjatë vitit 2018 kishte zgjidhur gjithsej 13 mijë e 641 lëndë, i cili numër siç ishte thënë nga Kryetari i Gjykatës së Apelit, Hasan Shala, në prezantimin e raportit vjetor të gjykatës të cilën ai e udhëheq, është për herë të parë numër më i madh se sa numri i lëndëve të mbetura për vitin vijues.¹⁰

⁷ Shënim: Të dhënat zyrtare nga Gjykata e Apelit. (Shih linkun: <https://apeli.gjyqesori-rks.org/mire-se-vini-ne-gjykatën-e-apelit-te-kosoves/gjyqtaret/gjyqtaret-ne-sherbim/>). (Qasur së fundi më 11 nëntor 2019).

⁸ “Raporti vjetor i Gjykatës së Apelit”. (Shih linkun: http://apeli.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/41684_GJApelit-Raporti_vjetor-Statistikor_2018.pdf). (Qasur së fundi më 15 janar 2020).

⁹ “Raporti vjetor i Gjykatës së Apelit”. (Shih linkun: http://apeli.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/41684_GJApelit-Raporti_vjetor-Statistikor_2018.pdf). (Qasur së fundi më 15 janar 2020).

¹⁰ Kryetari i Apelit thotë se i kanë kryer të gjitha lëndët e shënjestrura për viza, bën thirrje të ndalet bojkoti i avokatëve”. Betimi për Drejtësi. 10 janar 2018 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kryetari-i-apelit-thote-se->



Grafika 2 – Totali i lëndëve në punë, atyre që ishin zgjidhur dhe që kishin mbetur pa zgjidhur nga GjA gjatë vitit 2018.

Por, nëse marrim numrin e lëndëve të zgjidhura dhe e krahasojmë me numrin e lëndëve të pranuar gjatë vitit 2018, atëherë del se GjA ka zgjidhur 380 lëndë më pak se sa që ka pranuar gjatë vitit të kaluar. Në këtë mënyrë, gjatë vitit 2018 numri i lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese në GjA është rritur edhe për 380 lëndë të reja.

Nga të gjitha lëndët e trashëguara, 11 mijë e 325 lëndë i takonin lëmisë civile, ku sipas të dhënave zyrtare del se Gjykata e Apelit vazhdon ende të punoj në lëndë civile që datojnë nga viti 2014. Si nga Kryetari i GjA ashtu edhe në KGJK është thënë vazhdimisht se pjesa më problematike e GjA janë lëndët civile¹¹.

Sa i përket departamenteve tjera, GjA qëndron më mirë, ashtu që në Divizionin Penal të Departamentit të Përgjithshëm në vitin 2018 kishin qenë gjithsej 379 lëndë të trashëguara nga viti paraprak, derisa gjatë këtij viti në Divizionin e Kundërvajtjeve të këtij departamenti kishin qenë 8 lëndë të trashëguara, në Departamentin për Çështje Ekonomike 340 lëndë të trashëguara, në Departamentin për Krime të Rënda 79 lëndë të trashëguara, në Departamentin për të Mitur 3

i-kane-kryer-te-gjitha-lendet-e-shenjestrura-per-viza-ben-thirrje-te-ndalet-bojkoti-i-avokateve/). (Qasur së fundi më 11 nëntor 2019). (Qasur së fundi më 15 janar 2020)

¹¹ Shih për më tepër: Nocaj Driton. Drejtësia Civile në Kosovë, Ligji VS Praktika. IKD. Nëntor 2019. f.24-30. (<https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2019/11/IKD-Drejt%C3%ABsia-Civile-Ligji-vs.-Praktika-03.11.2019-1.pdf>). (Qasur së fundi më 8 nëntor 2019).

lëndë të trashëguara dhe në Departamentin për Çështje Administrative 418 lëndë të trashëguara, ndërsa në kategorinë Penale të Ndryshe, ku hyjnë ankesat ndaj aktvendimeve të gjykatave të shkallës së parë lidhur me konfirmimin e aktakuzës dhe caktimin e masave të sigurisë, GjA kishte trashëguar 24 lëndë të këtyre natyrave.

Përveç lëndëve të trashëguara nga viti 2017, gjatë vitit 2018, në Departamentin e Përgjithshëm, Divizionin Civil të GjA ishin pranuar edhe 5,687 lëndë të reja, në Divizionin Penal 1,357 lëndë të reja, në Divizionin për Kundërvajtje 1,327 lëndë të reja, në Departamentin për Krime të Rënda ishin pranuar edhe 629 lëndë të reja, në atë Ekonomik 340 lëndë të reja, në Departamentin Administrativ ishin pranuar gjatë vitit 2018 edhe 665 lëndë të reja si dhe në Departamentin për të Mitur ishin pranuar 92 lëndë të reja.

Prej këtyre lëndëve të trashëguara dhe atyre të pranura gjatë vitit 2018, në Departamentin e Përgjithshëm, Divizionin Civil, ishin zgjidhur gjithsej 5,460 lëndë gjatë vitit 2018, në Divizionin Penal të Departamentit të Përgjithshëm gjatë ishin zgjidhur gjithsej 1,446 lëndë nga GjA, kurse në Divizionin e Kundërvajtjes, ishin zgjidhur 1,186 lëndë.

Në Departamentin për Krime të Rënda, gjatë vitit 2018, janë zgjidhur gjithsej 618 lëndë, ndërsa, Departamenti për të Mitur i Gjykatës së Apelit, gjatë vitit 2018, i ka zgjidhur gjithsej 90 lëndë.

Në Departamentin Për Çështje Ekonomike janë zgjidhur gjithsej 237 lëndë, kurse gjatë vitit 2018, Departamenti për Çështje Administrative i GjA, kishte zgjidhur gjithsej 748 lëndë.

Gjatë vitit, 2018, GjA kishte vendosur edhe në lidhje me 3,855 ankesa ndaj aktvendimeve të gjykatave të shkallës së parë, lidhur me konfirmimin e aktakuzave dhe vendimeve për caktim të masave të sigurisë.



Grafika 3 – Lëndë e zgjidhura nga GjA gjatë 2018 sipas departamenteve.

Si lëndë të papërfunduara në fund të vitit 2018, Gjykatës së Apelit i kishin mbetur edhe 12,956 lëndë.

Konkretisht, Divizionit Civil të GjA i kishin mbetur të pazgjidhura edhe 11,552 lëndë, Divizionit Penal edhe 290 lëndë të pakryera, Divizionit të Kundërvajtjes 148 lëndë, Departamentit të Krimeve të Rënda 90 lëndë, Departamentit për të Mitur 5 lëndë, Departamentit për Çështje Ekonomike 443 lëndë, Departamentit për Çështje Administrative 335 lëndë, ndërsa në kategorinë Penale të Ndryshme kishin mbetur edhe 93 lëndë të pakryera.

Siç shihet edhe nga këto të dhëna, problemi më i madh me lëndë të pazgjidhura në Gjykatën e Apelit mbetet në Divizionin Civil, ku si total, 89.16 % të lëndëve të pazgjidhura të kësaj gjykate i takojnë këtij divizioni, pasuar nga Departamenti Ekonomik me 3.4 % lëndëve, nga Departamenti Administrativ me 2.5 %, Divizioni Penal me 2.2 %, Divizioni i Kundërvajtjeve me 1.14 % të lëndëve, Departamenti i Krimeve të Rënda me 0.69% të lëndëve si dhe Departamenti për të Mitur me vetëm 0.03 % lëndë të pazgjidhura nga numri i përgjithshëm i lëndëve të pazgjidhura në Apel.

Nëse i krahasojmë këto të dhëna me të dhënat që nga viti 2013, kur është themeluar Gjykata e Apelit, atëherë shihet se gjatë vitit 2018, Apeli ka zgjidhur më së shumti lëndë në krahasim me vitet paraprake.

Kështu, në krahasim me vitin 2017, kur Apeli kishte zgjidhur 11 mijë 833 lëndë, dallimi në vitin 2018 është 1,808 lëndë më shumë të zgjidhura, pastaj, dallimi me vitin 2016 është edhe më i madh, përkatësisht 3,107 lëndë më shumë të zgjidhura gjatë vitit 2018. Pra, në total, GjA vazhdimisht ka ngritur performancën, përkatësisht efikasitetin e zgjidhjes së lëndëve.


Megjithatë, për dallim nga viti 2017, jo të gjitha departamentet dhe divizionet e Gjykatës së Apelit janë treguar më shumë efikase në zgjidhjen e lëndëve, pasi që, në Divizionin Penal gjatë vitit 2018 janë zgjidhur 156 lëndë më pak se sa në vitin 2017.

Po ashtu, rënie të numrit të lëndëve të zgjidhura gjatë 2018 në krahasim me 2017, ka pasur edhe Departamenti Ekonomik ku janë zgjidhur 12 lëndë më pak si dhe Departamenti për Krime të Rënda i cili ka pasur 84 lëndë më pak të zgjidhura.

Rritjen më të madhe të efikasitetit gjatë vitit 2018 e ka pasur Divizioni Civil ku për dallim nga viti 2017, në vitin 2018 janë zgjidhur 1,060 lëndë më shumë, pastaj Departamenti Administrativ i cili gjatë vitit 2018 ka zgjidhur 278 lëndë më shumë se sa në vitin 2017 si dhe Divizioni i Kundërvajtjes i cili ka zgjidhur 256 lëndë më shumë në vitin 2018 se sa në vitin 2017.

Vitin 2019, Gjykata e Apelit e kishte nisur me 12,957 lëndë të trashëguara nga vitet paraprake, ndërsa, gjatë vitit, kishte pranuar në punë edhe 16,264 lëndë të reja.

Konkretisht, GjA gjatë kësaj periudhe kishte pasur në punë gjithsej 29,221 lëndë.




Grafika 4 – Numri i lëndëve që GjA ka pasur në punë gjatë vitit 2019.

Gjatë vitit 2019, GjA ka zgjidhur gjithsej 17,598 lëndë, kurse të pazgjidhura i kanë mbetur edhe 11,623 lëndë. Viti 2019, është viti kur GjA ka zgjidhur më së shumti lëndë prej se ekziston gjykatë si Gjykatë e Apelit.

Krahasuar me periudhën e njëjtë me vitin 2018, numri i lëndëve të zgjidhura nga GjA gjatë vitit 2019, është më i lartë për 3,957 lëndë.

Gjithashtu, nëse marrim totalin e lëndëve të pranuar në punë gjatë vitit 2019 dhe numrin e lëndëve të zgjidhura nga GjA gjatë kësaj periudhe, del se kjo gjykatë ka zgjidhur 1,334 lëndë më shumë se sa ka pranuar gjë që tregon një trend më pozitiv krahasuar me vitet paraprake. Një gjë e tillë, sipas kreut të Apelit, Hasan Shala është hera e parë që ndodh.¹²

¹² “Gjykata e Apelit gjatë vitit 2019 zgjidhi afro 18 mijë lëndë”. 10 janar 2020 (Shih linkun: <https://apeli.gjyqesori-rks.org/2020/01/10/gjykata-e-apelit-gjate-vitit-2019-zgjidhi-afro-18-mije-lende/>) (Qasur së fundi më 15 janar 2020)



Grafika 5 - Numri i lëndëve të zgjidhura si dhe atyre që kanë mbetur të pazgjidhura në vitin 2019.

Sa i përket lëndëve të GjA sipas natyrave, në vitin 2019, Divizioni Civil i GjA kishte pranuar në punë gjithsej 6,793 lëndë, ndërsa kishte arritur të zgjidh 8,428 lëndë. Kjo tregon, se ky divizion në vitin 2019 kishte arritur të zgjidh 1,635 lëndë më shumë se sa kishte pranuar në punë.

Trend pozitiv të zgjidhjes së lëndëve gjatë kësaj periudhe ka pasur edhe Departamenti për Çështje Ekonomike, i cili gjatë vitit 2019 ka pranuar në punë 417 lëndë, ndërsa kishte zgjidhur 448 lëndë, apo 31 lëndë më shumë se sa kishte pranuar.

Gjatë vitit 2019, edhe Departamenti për Krime të Rënda kishte arritur të zgjidh më shumë lëndë se sa kishte pranuar në punë. Ky departament, gjatë vitit 2019 kishte pranuar në punë 643 lëndë ndërsa i kishte gjatë gjithë vitit, i kishte zgjidhur 645 lëndë, apo dy më shumë se sa i kishte pranuar.

Divizioni i Kundërvajtjes, kishte pranuar në punë gjatë kësaj periudhe, 1,033 lëndë, ndërsa kishte arritur të zgjidh 1,156 lëndë, apo 123 lëndë më shumë se sa që kishte pranuar.

Një efikasitet të tillë, nuk e kishin pasur gjatë vitit 2019 edhe departamentet, konkretisht, divizionet tjera.

Kështu, Departamenti për Çështje Administrative, gjatë kësaj periudhe kishte pranuar në punë 1,034 lëndë, kurse, kishte zgjidhur 825 nga to, apo 209 lëndë më pak se sa që kishte pranuar.

5 lëndë më pak kishte zgjidhur në krahasim me ato që kishte pranuar Departamenti për të Mitur. Ky departament, gjatë kësaj periudhe kishte pranuar në punë 98 lëndë ndërsa kishte zgjidhur 93 lëndë.

Divizioni Penal i GjA, gjatë vitit 2019, kishte pranuar në punë gjithsej 1,657 lëndë kurse kishte arritur të zgjidh 1,558 lëndë, apo 99 lëndë më pak se sa i kishte pranuar.

Departamenti Special, i cili kishte filluar punën në korrik 2019, deri në fund të vitit kishte pranuar në punë 17 lëndë, nga të cilat i kishte zgjidhur 10 lëndë.


Në fund të vitit 2019, Divizionit Civil i kishin mbetur të pazgjidhura edhe 9,916 lëndë, atij Penal, 391, në Kundërvajtje kishin mbetur të pazgjidhura 25 lëndë, në Departamentin për Krime të Rënda, 90 lëndë, në Departamentin Ekonomik, 412 lëndë, atë për Çështje Administrative, 544 lëndë, Departamentin Special, 7 lëndë, kurse në atë të për të Mitur kishin mbetur edhe 8 lëndë të pakryera.

Ndërsa, të pakryera në fund të vitit 2019 kishin mbetur edhe 205 lëndë që kishin të bëjnë me ankesa ndaj aktvendimeve të gjykatave të shkallës së parë, për konfirmim të aktakuzave si dhe ato për caktim të masave të sigurisë.

Ndikim në rritjen e zgjidhjes së lëndëve gjatë vitit 2019, ka pasur edhe rritja e numrit të gjykatësve pasi që në fillim të vitit 2019, në GjA kanë filluar punën edhe 10 gjykatës të ri, nëntë prej të cilëve janë caktuar të punojnë në Divizionin Civil, kurse një në Departamentin Ekonomik.

Në numrin e lëndëve të pakryera, sipas kryetarit të GjA, Hasan Shala, ka edhe lëndë që datojnë nga vitet 2014 dhe 2015. Për zgjidhjen më të shpejtë të lëndëve, sidomos në Divizionin Civil, Shala kishte thënë se nevojiten edhe të paktën 10 gjykatës të ri.


Shikuar në përgjithësi, nga viti 2013, kur në GjA ishin zgjidhur gjithsej 11,375 lëndë, numri i lëndëve të zgjidhura brenda një viti, është rritur në 17,598 në vitin 2019.



Grafika 6 – Dallimi mes lëndëve të zgjidhura nga Apeli gjatë viteve 2013 – 2019.

Ndryshe, rritja e numrit të lëndëve të zgjidhura nga GjA gjatë viteve 2013 – 2019, ka ndodhur edhe pse nga viti 2013 deri në vitin 2018, numri i gjykatësve në këtë gjykatë ka mbetur relativisht i njëjtë, kurse rritjen më të madhe të numrit të gjykatësve kjo gjykatë e ka pasur gjatë vitit 2019.

Gjatë vitit të kaluar, në GjA kishin zgjidhur lëndë gjithsej 55 gjyqtar. Pasi që, dy gjyqtar ishin pensionuar, kurse një tjetër ishte dekretuar si gjyqtare në Gjykatën Supreme, GjA e kishte përmbyllur vitin 2019 me 52 gjykatës.



Grafika 7 – Numri i gjykatësve që kanë zgjidhur lëndë në Gjykatën e Apelit gjatë viteve 2013-2019.¹³

¹³ Raportet vjetore të Gjykatës së Apelit për vitet 2018 dhe 2019.

5. Performanca individuale e Gjyqtarëve të GjA-së

Gjykata e Apelit e kishte filluar vitin 2018 me 35 gjykatës përfshirë këtu edhe vet kryetarin e gjykatës, ndërsa në ndërkohë, nga GjA në Gjykatën Supreme ishin avancuar dy gjykatës, një gjykatëse ishte pensionuar kurse një tjetër kishte dhënë dorëheqje. Në muajin shkurt të vitit 2018, në GjA kishin filluar punën edhe pesë gjykatës tjerë, ashtu që, vitin 2018 GjA e kishte përmbyllur me 36 gjykatës.¹⁴

Gjykata e Apelit, lëndët i shqyrton në kolegji prej tre gjyqtarëve, ashtu siç është përcaktuar në Ligjin për Gjykatat. Në raste kur një departament apo divizion nuk i ka të paktën tre gjyqtarë për të formuar kolegjin, atëherë i njëjti plotësohet me një gjyqtar nga departamenti tjetër.¹⁵

Nga ky numër total i gjykatësve, 25 kishin qenë të angazhuar në Departamentin e Përgjithshëm. Në kuadër të këtij numri, 17 gjykatës ishin të angazhuar në Divizionin Civil, gjashtë në Divizionin Penal dhe dy në Kundërvajtje.

Në Departamentin për Krime të Rënda, gjatë vitit 2018, kishin qenë të angazhuar shtatë gjyqtarë, të cilën punën e kanë zhvilluar në tri kolegje ndërsa një gjyqtar nga Departamenti i Përgjithshëm, i kishte plotësuar kolegjet por nuk është ngarkuar më lëndë të krimeve të rënda.

Në Departamentin për Çështje Ekonomike ka punuar vetëm një gjyqtar ndërsa për të përmbushur numrin prej tre gjyqtarëve që duhet të ketë kolegji gjyqësor siç e përcakton edhe neni 23 i Ligjit për Gjykatat¹⁶, kolegji në këtë departament ishte formuar edhe me dy gjyqtar të Divizionit Civil kurse në Departamentin për Çështje Administrative kishin qenë të sistemuar dy gjyqtarë, të cilët po ashtu, kolegjin e kishin plotësuar me një gjyqtar nga Divizioni Civil i Departamentit të Përgjithshëm.

Në Departamentin për të Mitur, gjatë vitit 2018, kanë punuar dy gjyqtarë të cilët kolegjin gjyqësor e kishin plotësuar edhe me një gjyqtar nga Departamenti për Krime të Rënda Për shkak të numrit të vogël të lëndëve që kishin pasur në punë, gjyqtarët e këtij departamenti kishin gjykuar edhe lëndë nga Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal,

Në mesatare i bie se gjatë vitit 2018, secili gjykatës i GjA-së ka trashëguar nga 349.3 lëndë, derisa ka pranuar nga 391.05 lëndë të reja. Në këtë mënyrë, gjatë vitit 2018, secili gjykatës i GjA ka pasur në punë nga 739 lëndë. Ndërsa, gjatë vitit 2018, secili gjykatës i GjA ka zgjidhur mesatarisht nga 378.9 lëndë. Në këtë mënyrë, gjatë vitit 2018, gjyqtarët e GjA-së nuk kanë arritur që të zgjidhin aq lëndë sa edhe kanë pranuar.

Në anën tjetër, në fillim të vitit 2019, GjA-së u ishin bashkuar edhe dhjetë gjyqtarë të rinj, nëntë prej të cilëve janë caktuar të punojnë në Divizionin Civil, kurse një në Departamentin Ekonomik.

¹⁵ Shënim: Ligji për Gjykatat, neni 23 përcakton se “Gjykata e Apelit shqyrton dhe gjykon lëndët në kolegji prej tre (3) gjyqtarëve profesionist, përveç nëse me ligj parashihet ndryshe.”

Po ashtu, me formimin e Departamentit Special në Gjykatën e Apelit, kësaj të fundit i ishin shtuar edhe tre gjykatës të rinj që do gjykojnë në këtë departament.

Në këtë mënyrë, në fund të vitit 2019, GjA ka pasur gjithsej 52 gjyqtarë, duke përfshirë këtu edhe gjyqtarët e Divizionit të GjA në Mitrovicën e Veriut.

Sa i përket numrit të lëndëve, në vitin 2019, mesatarisht secili gjyqtar i GjA-së ka trashëguar nga 264.42 lëndë, derisa kanë pranuar në punë edhe nga 331.91 lëndë të reja. Në këtë mënyrë, secili gjyqtar i GjA-së ka qenë i ngarkuar mesatarisht me nga 596 lëndë, derisa ka zgjidhur nga 359.14 lëndë. Pra, mesatarisht, secili gjyqtar i GjA ka zgjidhur nga 29 lëndë më shumë se sa që ka pranuar.¹⁷

Kështu, derisa në vitin 2018, gjyqtarët e GjA kishin zgjidhur më pak lëndë se sa kishin pranuar, kjo ka ndryshuar në vitin 2019, ku gjyqtarët kanë zgjidhur lëndë më shumë se sa i kanë pranuar, çka tregon një trend pozitiv në këtë aspekt për GjA.

Për të dhënë një pasqyrë sa më të detajuar, IKD ka analizuar ngarkesën me lëndë të secilit departament të GjA-së. Në vijim është paraqitur numri i lëndëve të trashëguara, të pranuar, të zgjidhura dhe të pazgjidhura në mesataren e gjyqtarëve për secilin departament. Në këtë drejtim, analiza e mëposhtme është për periudhën dy vjeçare, 1 janar 2018 – 31 dhjetor 2019.¹⁸

5.1 Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

Në Divizionin Civil të Departamentit të Përgjithshëm, në periudhën 1 janar 2018 – 31 dhjetor 2019, kishin zgjidhur lëndë 28 gjykatës, përfshirë këtu edhe ish-kryesuesin e KGJK-së, Nehat Idrizi i cili pas mbarimit të mandatit të kryesuesit të KGJK-së, kishte rifilluar punën si gjykatës në prill 2019. Pas zgjedhjes si zëvendës kryesuese e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, nga gushti i vitit 2019, lëndë nuk ka kryer, gjykatësja Makifete Saliuka.

Në vitin 2018, mesatarja e lëndëve që kishin trashëguar gjyqtarët e Divizionit Civil kishte qenë, 629 lëndë për gjyqtarë, kurse, në vitin 2019, për shkak të rritjes së numrit të gjyqtarëve, mesatarisht secili nga ta ka trashëguar nga 412 lëndë të pakryera nga vitet paraprake.

Përveç lëndëve të trashëguara, gjatë kësaj periudhe dy vjeçare, gjyqtarët e Divizionit Civil kishin pranuar edhe mesatarisht nga 445 lëndë të reja.

Nga ky numër, mesatarja e lëndëve që gjykatësit e këtij divizioni kanë zgjidhur gjatë kësaj periudhe është 488 lëndë, kurse si të pazgjidhura në fund të vitit 2019, mesatarisht secilit gjyqtarë ju kanë mbetur edhe nga 354 lëndë.

¹⁷ Shënim: Në llogaritjet që janë bërë lidhur me numrin e lëndëve të trashëguara, pranuar dhe të zgjidhura, nuk janë të përfshirë edhe gjyqtarët e Divizionit të Mitrovicës së Veriut. Puna e këtyre gjyqtarëve është e pasqyruar në kapitullin që flet për Divizionin e Mitrovicës së Veriut.

¹⁸ Raporti statistikor i Gjykatave Vjetor 2018 (Shih linkun: http://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/63670_SKGJK_Raporti_vjetor_statistikor_per_punen_e_%20gjyqtareve_viti_2018.pdf). (Qasur së fundi më 15 janar 2020).

Pra, mesatarisht, gjyqtarët e këtij divizion kanë zgjidhur më shumë se lëndë se sa që kanë pranuar, mirëpo, duke pasur parasysh numrin e lëndëve të trashëguara, numri i lëndëve të pazgjidhura mbetet ende i lartë.

Sipas rregullores për caktimin e normës së punës së gjyqtarëve, norma vjetore mujore që gjykatësit e Divizionit Civil të GjA duhet të zgjidhin është 219 lëndë. Pra, për periudhën 1 janar 2018 – 31 dhjetor 2019, gjyqtarët e Departamentit të Përgjithshëm – Divizionit Civil kanë qenë të obliguar që ti zgjidhin gjithsej nga 438 lëndë.

Në këtë mënyrë, në mesatare, gjyqtarët e këtij divizioni gjatë periudhës kohore 1 janar 2018 – 31 dhjetor 2019 e kanë arritur normën orientuese të përcaktuar nga KGJK.

5.2 Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

Në Divizionin Penal të Departamentit të Përgjithshëm, gjatë periudhës, 1 janar 2018 – 31 dhjetor 2019, kishin qenë të angazhuar gjithsej gjashtë gjykatës, ndërsa lëndë kishin kryer edhe gjykatës të Departamentit të Krimeve të Rënda.

Vitin 2018, gjyqtarët e këtij divizioni kishin trashëguar mesatarisht nga 63 lëndë, kurse në vitin 2019, numri i lëndëve të trashëguara kishte qenë më i vogël, apo 48 lëndë për gjyqtar.

Gjatë kësaj periudhe dy vjeçare, gjyqtarët e këtij divizioni kishin pranuar edhe mesatarisht nga 502 lëndë.

Nga ky numër, mesatarja e lëndëve që gjykatësit e këtij divizioni kanë zgjidhur gjatë kësaj periudhe është 475.5 lëndë për gjyqtar, kurse, mesatarisht çdonjërit prej tyre ju kanë mbetur pa zgjidhur edhe nga 65 lëndë të pakryera. Mesatarisht, gjyqtarët e Divizionit Penal kanë zgjidhur më pak lëndë se sa që kanë pranuar.

Norma vjetore e lëndëve që duhet të zgjidhen nga gjykatësit e Divizionit Penal, sipas rregullores së KGJK-së është 131, që i bie se norma e përcaktuar nga KGJK për periudhën 1 janar 2018 – 31 dhjetor 2019 është 262 lëndë për secilin gjyqtar, normë të cilën në mesatare e kanë arritur të gjithë gjykatësit e këtij divizioni.

5.3 Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni i Kundërvajtjes

Sa i përket Divizionit të Kundërvajtjes, gjatë periudhës janar 2018 – dhjetor 2019, vetëm dy gjyqtarë kishin qenë të angazhuar për të kryer lëndë, ndërsa kolegji ishte plotësuar edhe me një gjykatës nga Departamenti Administrativ.

Gjatë kësaj periudhe, dy gjyqtarët e këtij divizioni kishin pranuar mesatarisht nga 1,180 lëndë të reja, kurse kishin zgjidhur mesatarisht nga 1,160 lëndë. Në fund të vitit 2019, në këtë divizion kishin mbetur të pakryera vetëm 25 lëndë, apo 12.5 lëndë për gjyqtar.

5.4 Departamenti i Krimeve të Rënda

Në Departamentin për Krime të Rënda të GjA, gjatë periudhës 1 janar 2018 – 31 dhjetor 2019, kishin qenë të angazhuar gjithsej shtatë gjyqtarë, ndërsa lëndë kishin kryer edhe gjykatës që i takojnë Departamentit të Përgjithshëm dhe atij Special, të cilët kishin kryer një numër më të

vogël të lëndëve. Nga korriku 2019, ky departament ka mbetur me vetëm gjashtë gjyqtar, pasi një gjyqtare është dekretuar në Gjykatën Supreme.

Mesatarja e lëndëve që kishin trashëguar gjyqtarët e këtij departamenti në vitin 2018, kishte qenë 11 lëndë, kurse në vitin 2019, kjo mesatare e lëndëve të trashëguar kishte qenë 13 lëndë për gjyqtar.

Gjatë kësaj periudhe dy vjeçare, secili nga gjyqtarët e DKR-së, kishte pranuar në punë edhe nga 181 lëndë të reja, kurse, kishin zgjidhur mesatarisht nga 158 lëndë.

Në fund të vitit 2019, në DKR kanë mbetur të pakryera edhe 90 lëndë, apo përkthyer në mesatare, secilit nga gjashtë gjyqtarët e këtij departamenti ju kanë mbetur edhe nga 15 lëndë të pakryera.

Sa i përket normës vjetore për zgjidhjen e lëndëve të përcaktuar me rregulloren e KGJK-së, e cila është 131 lëndë apo 262 lëndë për dy vjet, për një gjykatës, asnjë nga gjykatësit e Krimeve të Rënda nuk e kanë arritur këtë normë.

Kjo pasi që, edhe numri i lëndëve që kishte pasur ky departament në punë gjatë vitit 2018 kishte qenë 715, pra, edhe nëse shtatë gjykatësit e këtij departamenti sa kishin qenë në vitin 2018, do i zgjidhnin të gjitha këto lëndë, mesatarja e lëndëve të zgjidhura për gjyqtar do ishte 102 lëndë, pra nën normën e përcaktuar nga KGJK. E njëjta gjë vlen edhe për vitin 2019, ku DKR kishte pasur në punë 735 lëndë në total në punë, ashtu që edhe po të zgjidheshin të gjitha, sërish nuk do arrihej norma orientuese vjetore prej 131 lëndë për gjykatës.

5.5 Departamenti Special për Lëndët në Kompetencë të Prokurorisë Speciale

Ligji i ri për Gjykatat, që ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2019, ka paraparë që në kuadër të Gjykatës së Apelit të formohet edhe Departamenti Special për lëndët në kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës

Ky departament, që në shkallë të parë është formuar në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka kompetencë të shqyrtojë lëndët të cilat bien në kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.

Ky departament ka filluar punën e tij në GjA, në korrik 2019, ndërsa përbëhet nga dy kolegje me gjithsej gjashtë gjyqtarë. Njëri nga këto kolegje është nga Divizioni i Apelit në Mitrovicë me ç'rast dy gjyqtarë janë nga komuniteti serb kurse një shqiptar.

Për shkak të numrit të vogël të lëndëve që ka aktualisht ky departament, gjyqtarët e të njëjtit janë caktuar të kryejnë lëndë edhe në kuadër të Departamentit të Krimeve të Rënda.

Nga korriku 2019, kur ka filluar punën ky departament, i njëjti ka pranuar në punë 17 lëndë, nga të cilat i ka zgjidhur shtatë, kurse të pakryera në fund të vitit 2019 i kishin mbetur edhe 10 lëndë.

5.6 Departamenti për Çështje Ekonomike

Departamenti Ekonomik, gjatë vitit 2018 kishte pasur vetëm një gjykatës, kurse disa lëndë ishin kryer edhe nga gjykatës të Divizionit Civil. Nga janari 2019, këtij departamenti i është shtuar edhe një gjykatës i ri.

Vitin 2018, ky departament kishte trashëguar nga viti paraprak, 340 lëndë, kurse në vitin 2019, dy gjyqtarët e këtij departamenti, kanë trashëguar mesatarisht nga 221.5 lëndë secili prej tyre.

Gjatë vitit 2018, gjyqtari i vetëm atë kohë i këtij departamenti, kishte zgjidhur 224 lëndë, kurse në vitin 2019, dy gjyqtarët e këtij departamenti kanë zgjidhur mesatarisht nga 222 lëndë.

Në fund të vitit 2019, gjyqtarëve të këtij departamenti u kanë mbetur edhe mesatarisht nga 206 lëndë të pakryera.

Norma vjetore për këtë departament, e përcaktuar me rregulloren e KGJK-së është 138 lëndë për gjyqtarë, ndërsa për periudhën dy vjeçare që përfshihet në këtë raport, norma që është dashur të plotësohet ka qenë 276 lëndë. Kjo normë është përmbushur nga gjyqtarët e këtij departamenti.

5.7 Departamenti për të Mitur

Në Departamentin për të Mitur, në periudhën 1 janar 2018 – 31 dhjetor 2019, kishin qenë të angazhuar dy gjykatës. Kolegji në këtë departament ishte formuar edhe me një gjykatës nga Departamenti për Krime të Rënda. Për shkak të numrit të vogël të lëndëve, gjykatësit e këtij departamenti kishin qenë të angazhuar edhe në departamentet tjera.

Dy gjyqtarët e këtij departamenti, gjatë kësaj periudhe dy vjeçare kishin pranuar mesatarisht nga 95 lëndë, kurse, kishin zgjidhur mesatarisht nga 91.5 lëndë. Në fund të vitit 2019, vetëm 8 lënda kanë mbetur të pazgjidhur në këtë departament.

Norma vjetore për këtë departament, e përcaktuar me rregulloren e KGJK-së është 119 lëndë për gjykatës, normë të cilën nuk e kanë arritur asnjë gjykatës për shkak se gjatë gjithë vitit 2018 ky departament ka pasur në punë gjithsej vetëm 95, kurse gjatë vitit 2019, vetëm 101 lëndë.

5.8 Departamenti për Çështje Administrative

Departamenti Administrativ gjatë periudhës 1 janar 2018 – 31 dhjetor 2019, ka pasur të angazhuar dy gjykatës të cilët kolegjin e kishin formuar edhe me një gjykatës nga Divizioni Civil.

Në vitin 2018, këtë dy gjyqtar kishin trashëguar mesatarisht nga 209 lëndë nga viti paraprak, kurse në vitin 2019, numri i lëndëve që kanë trashëguar është më i vogël, përkatësisht, 167.5 lëndë për gjyqtarë.

Mesatarisht, gjyqtarët e këtij departamenti kanë pranuar gjatë këtyre dy viteve, edhe nga 849.5 lëndë të reja, kurse, mesatarja e lëndëve që është zgjidhur gjatë kësaj periudhe nga gjyqtarët, është 786.5 lëndë.

Në fund të vitit 2019, të pakryera në këtë departament kishin mbetur edhe 544 lëndë, apo 272 lëndë për secilin nga dy gjyqtarët e departamentit.

Norma vjetore për zgjidhjen e lëndëve në këtë departament, e përcaktuar me rregulloren e KGJK-së, është 263 lëndë, kurse nëse llogarisim këtu dy vitet që i përfshin ky raport, vitin 2018 dhe vitin 2019, i bie që gjyqtarët e këtij departamenti është dashur të zgjidhin nga 526 lëndë, gjë të cilën e kishin bërë gjyqtarët.

5.9 Divizioni i Gjykatës së Apelit në Mitrovicë të Veriut

Në përputhje me Marrëveshjet e Brukselit dhe shtojcën e rregullores së KGJK-së për organizmin e brendshëm të gjykatave, gjatë vitit 2018, është funksionalizuar edhe divizioni i Gjykatës së Apelit në Mitrovicë i cili përbëhej nga shtatë gjyqtar. Në këtë divizion, janë të caktuar dy kolegje, konkretisht, një koleg civil dhe një penal. Në këtë divizion, gjykohen lëndët e katër komunave me shumicë serbe që gjenden në veri të Kosovës, përkatësisht Mitrovicës së Veriut, Zubin Potokut, Zveçanit dhe Leposaviqit.

Kurse, lëndët e gjashtë komunave tjera me shumicë serbe, siç kishte thënë kryetari i Apelit, Hasan Shala në konferencën vjetore për vitin 2018, do të gjykohen në Prishtinë nga një koleg i përbërë prej dy gjykatësve të komunitetit serb dhe një shqiptar.

Funksionalizimi i plotë i Divizionit të Gjykatës së Apelit në Mitrovicë gjatë vitit 2018, themeluar sipas Marrëveshjes së Brukselit, ishte quajtur histori suksesi nga kryetari i Apelit, Hasan Shala, kur ky i fundit kishte prezantuar punën e Apelit gjatë vitit 2018.

Megjithatë, ky divizion në të cilin lëndë kanë kryer pesë gjyqtarë, sipas lëndëve të kryera gjatë dy viteve të kaluar del se as për së afërmi nuk i ngjan një histori suksesi.

Një gjë të tillë e kishte pranuar edhe vet kreu i Apelit, kur kishte prezantuar punën e GjA për vitin 2019, ku kishte thënë se për mos punën e tyre, gjykatësit e këtij divizioni i ka paralajmëruar se mund t'i dërgojë edhe në komision disiplinor. Sipas Shalës, gjatë vitit 2019 vërehet një përmirësim në aspektin e punës edhe sa i përket këtij divizioni.¹⁹

Kështu, gjatë periudhës 1 janar 2018 – 31 dhjetor 2019, gjykatësit e këtij divizioni, Blagoje Miletić, Gordana Vlasković, Milan Bigović, Mirko Rakić dhe Miroslav Ivanović kishin zgjidhur në total, 374 lëndë.

Në mesatare, i bie që secili nga këta gjyqtar, brenda dy vjetëve ka zgjidhur nga 74.8 lëndë, numër ky shumë më i vogël se sa mesatarja e lëndëve të zgjidhur nga kolegët e tyre në Prishtinë.

Në këtë divizion, gjatë vitit 2019 e kanë arritur moshën e pensionimit dy gjyqtar. Përkatësisht, në maj është pensionuar gjyqtari Mirko Rakić, kurse në nëntor, gjyqtari Miroslav Ivanović.

¹⁹ “Kreu i Apelit thotë se dënimet me kusht po stimulojnë kryerjen e veprave të korrupsionit”. Betimi për Drejtësi. 10 janar 2020 (Shih linkun: <https://betimiperdrejttesi.com/kreu-i-apelit-thote-se-denimet-me-kusht-po-stimulojne-kryerjen-e-veprave-te-korrupsionit/>) (Qasur së fundi më 15 janar 2020).

6. Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rasteve dhe punën e GjA-së

Përkundër retorikës së vazhdueshme së të gjithë akterëve të drejtësisë por edhe politikës, gjetjet e IKD-së nga monitorimi sistematik që i bënë gjykatave në Kosovë, bien në përfundim se edhe në vitet 2018 dhe 2019, lufta e proklamuar ndaj korrupsionit nga organet e drejtësisë është një luftë e humbur.

Mungesa e qoftë edhe një aktgjykimi dënues të plotfuqishëm ndaj ndonjë zyrtari të profilit të lartë e tregon më së miri këtë.

Madje, edhe në dy raste të rralla të dënimeve të zyrtarëve të lartë publik, nga gjykatat e shkallës së parë, konkretisht të ish-rektorit të Universitetit të Prishtinës, Enver Hasani dhe ish-kryetarit të Parteshit, Dragan Nikoliq, kishte qenë gjykata e shkallës së dytë që i kishte përmbysur këto vendime dhe kishte nxjerrë aktgjykime liruese.

Po ashtu, Apeli gjatë kësaj periudhe kishte anuluar dënimet e shqiptuara nga shkalla e parë edhe për katër raste tjera ku akuzohen për korrupsion, zyrtarë të lartë publik, përkatësisht Ferid Agani, ish-ministër i Shëndetësisë, Shukri Buja, ish-kryetar i Komunës së Lipjanit, Sokol Bashota, ish-kryetar i Komunës së Klinës dhe Salim Jenuzi, ish-kryetar i Komunës së Dragashit.

Madje, për këtë të fundit, pas kthimit të rastit në rigjykim, vepra penale për të cilën akuzohej kishte arritur afatin e parashkrimit çka kishte bërë që për Jenuzin të refuzohej akuza.

Në të paktën tre vendime që Apeli kishte marr në rastet e profilit të lartë, atë të ish-zëvendëskryeministrit të Qeverisë së Kosovës, Dalibor Jevtiq, ish-kryetarit të Obiliqit, Mehmet Krasniqi dhe ish-kryetarit të Gjykatës së Apelit, Salih Mekaj, shkelje kishte gjetur edhe Gjykata Supreme.

Po ashtu, Gjykata Supreme kishte konstatuar shkelje edhe në rastin e njohur si “Sekseri”, në të cilin rast, Apeli e kishte hudhur poshtë aktakuzën për të akuzuarin Emin Beqirin.

Shkelje nga Gjykata Supreme ishin konstatuar edhe në rastin e bashkakuzuarve të Enver Hasanit, në rastin “Kontrata”, Hakif Veliut dhe Albert Rakipit për të cilët, lënda ishte kthyer në rivendosje.

Në rivendosje nga Supremja ishte kthyer edhe lënda e ish-deputetit Etem Arifi, si dhe lënda e ish-prokurores Vahide Badivuku si dhe ajo producentëve Armond Morina dhe Nehat Fejza, që akuzohen për korrupsion në një rast ku të përfshirë kishin qenë edhe ish-ministrat Astrit Haraqija dhe Valton Beqiri.

Shkeljet që Supremja kishte gjetur në rastet e deputetit Etem Arifi, ish-prokurores Vahide Badivuku dhe në rastin e Hakif Veliut e Albert Rakipit, kishin pasur të bëjnë me përbërjen e kolegjit të Apelit që kishte vendosur në këto raste.

Konkretisht, në këto raste, Apeli kishte vepruar në kundërshtim me dispozitën e nenit 39 par.2 të KPPK-së, ku është përcaktuar se “Gjyqtari përjashtohet si gjyqtar i vetëm gjykues, kryetar i trupit gjykues, anëtar i trupit gjykues, anëtari i kolegjit të apelit apo kolegjit të Gjykatës Supreme

nëse ka marrë pjesë në procedura të mëhershme në të njëjtin rast penal, përveç gjyqtarit që ka shërbyer në kolegjin e mundësisë hetuese të veçantë. Megjithatë, një gjyqtar nuk do të përjashtohet kur ai ose ajo ka qenë vetëm i përfshirë në procedurat e mëparshme në të njëjtën çështje penale, si një anëtar i një paneli shqyrtues”.

Për shkelje të tilla, rastet në fjalë ishin kthyer në rivendosje nga Supremja, ndërsa Apeli, pasi i kishte eliminuar këto shkelje, vendimet që i kishte marr pas rivendosjes kishin qenë të njëjta sikurse herën e parë. Pra, shkelje procedurale të kishin ndodhur në këto raste, kishin pasur ndikim vetëm në kohëzgjatjen deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimeve të këtyre rasteve, pasi që vendimet e Apelit edhe pas kthimit në rivendosje nga Gjykata Supreme kishin qenë të njëjta.

Megjithatë, në raste tjera, sikurse rasti i zëvendëskryeministrit Jevtiq, ish-kryetarit të Obiliqit, Krasniqi apo ish-kreut të Gjykatës së Apelit, Mekaj, krejt çka kishte bërë Supremja kishte qenë fakti se kishte konstatuar në këto raste ka pasur shkelje nga instancat më të ulta gjyqësore.

Duke qenë se këto shkelje, sipas Supremes, kishin shkuar në favor të akuzuarve, atëherë e njëjta nuk ka pasur mundësi tjetër ligjore përveç që t'i konstatoj shkeljet si të tilla.

Kjo, pasi sipas nenit 438, paragrafi 2, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, kur Gjykata Supreme e Kosovës çmon se kërkesa e paraqitur për mbrojtjen e ligjshmërisë në dëm të pandehurit është e bazuar, vetëm konstaton shkeljen e ligjit pa ndikuar në vendimin e formës së prerë.

Sa i përket ish-zëvendëskryeministrit Dalibor Jevtiq, Gjykata Supreme kishte konstatuar se në aktvendimet për hudhje të aktakuzës të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe asaj të Apelit, në rastin e ish-zëvendëskryeministrit Jevtiq, kishte pas shkelje të dispozitave të procedurës penale në favor të pandehurit. Supremja në aktgjykimin e saj theksonte se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 1.12 të KPPK-së sepse arsyetimi i aktvendimit të kontestuar, sipas Supremes, është në kundërshtim me shkresat e lëndës dhe nuk përmban arsyetim të duhur dhe konkret lidhur me faktet vendimtare të kësaj çështjeje juridike. Aq më tepër, sipas Supremes, arsyetimi i shkallës së parë nuk ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresa të çështjes dhe nuk është në pajtim me nenin 370 par.7 të KPPK-së. Gabimet e bëra nga shkalla e parë, sipas Supremes, i kishte përsëritur edhe Gjykata e Apelit kur kishte vendosur që të refuzon ankesën PSRK-së dhe të vërteton vendimin e Themelores.

Ndërsa, në rastin e ish-kryetarit të Obiliqit, Mehmet Krasniqi, në aktgjykimin e Supremes, thuhet se aktgjykimet e Themelores dhe të Apelit, ishin marr me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384.par1 pika 12 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, në pjesët liruese të cilat janë përshkruara nën pikat I, II, III, IV dhe V të shkallës së parë.²⁰

Gjykata Supreme i kishte gjetur si të bazuara pretendimet e prokurorisë për sa i përket shkeljeve esenciale të procedurës penale që konsiston në dhënien e arsyeve të paqarta për faktet

²⁰ Aktgjykimi i Gjykatës Supreme në rastin ndaj Mehmet Krasniqit etj., faqe 1.21 janar 2019.

vendimtare, e sidomos për dashjen e të dënuarve për kryerjen e veprave penale për të cilët janë liruar nga akuza.²¹

Gjykata Supreme, më 1 prill 2019, kishte konstatuar shkelje edhe në rastin e njohur si “Sekseri”, ku ish-drejtori i Krimeve Ekonomike në Policinë e Kosovës, Emin Beqiri akuzohej për keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, pengim i të provuarit dhe moslajmërimi i veprave penale apo kryerësve të tyre, ndërsa Rrahim Hashimi akuzohej për ushtrim të ndikimi dhe mashtrim.²²

Kërkesën e Prokurorit të Shtetit për mbrojtje të ligjshmërisë në këtë rast, e kishte aprovuar si të bazuar, kolegji i Supremes në përbërje të gjykatësve Agim Maliqi, Valdete Daka dhe Rasim Rasimi. sipas të cilëve, me të gjitha provat e dorëzuara nga prokuroria, të cilat janë në përputhje me njëra tjetrën, Gjykata e Apelit ka ardhur në përfundim të gabuar kur ka konstatuar se nuk ka pasur asnjë provë e cila ka involvuar Emin Beqirin në veprat penale për të cilat është akuzuar.

Sipas Supremes, gjykata e shkallës së dytë duke e marrë rolin e gjykatës së shkallës së parë ka pamundësuar që të vërtetohet apo jo fajësia e të pandehurve si dhe vërtetësia apo jo e provave të paraqitura nga prokuroria, e duke i vlerësuar vet provat, edhe pse në mesin e këtyre provave ka pasur prova të cilat e kanë mbështetur dyshimin e bazuar mirë se këta i kanë kryer veprat për të cilat janë akuzuar.

Në rastin e ish-kreut të Gjykatës së Apelit, Salih Mekaj, Supremja kishte konstatuar se, shkalla e parë dhe ajo e dytë në aktgjykimet e veta në mënyrë të drejtë dhe të plotë kanë vërtetuar faktet vendimtare të çështjes konkrete por me lirimin e të akuzuarve, Mekaj dhe Goranit kanë nxjerr përfundimeve të gabuara për ekzistimin e veprës penale, që paraqet shkelje të ligjit penal sepse kanë aplikuar ligjin i cili nuk ka mundur të aplikohet, sepse me aplikimin e drejtë të ligjit penal, sipas Supremes, Mekaj do duhej të shpallej fajtor për veprën që është objekt i akuzës.

Veprimet e Mekajt, sipas Supremes, sipas fakteve të cekura në aktgjykim, paraqesin ushtrim të ndikimit, duke qenë se shkas për bisedat me gjyqtaren L.M, ka qenë lidhja e Mekajt me Goranin e cila nuk ka ekzistuar me herët por ka ndodhur pasi Goranit kishte shkuar për tu interesuar për lëndën e bashkëshortit të saj që akuzohej për një vepër penale. Sipas Supremes, pa iniciativën e Goranit, i pandehuri Mekaj, nuk ka filluar bisedat me gjyqtaren, së paku nga provat e nxjerra nuk del se më parë, ka filluar këto biseda.

Në vendimin e saj, Supremja thekson se fakti se nuk ka pasur sukses gjegjësisht ndikimi nga Mekaj nuk ka arritur rezultatin e synuar nuk e ndryshon pozitën juridiko penale e të pandehurit, siç parashihet me dispozitën e nenit 431.par.1.të KPK.

²¹ Po aty, faqe 4

²² “Supremja konstaton shkelje me rastin e lirim të ish-drejtorit të Krimeve Ekonomike”, Emin Beqiri”. Betimi për Drejtësi. 17 prill 2019 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/supremja-konstaton-shkelje-me-rastin-e-lirim-te-ish-drejtorit-te-krimeve-ekonomike-emin-beqiri/>) (Qasur së fundi më 15 janar 2020).

Gjykata Supreme e Kosovës kishte konstatuar shkelje edhe në rastin e lirimit nga akuza për marrje të ryshfetit, me të cilën ngarkohej inspektori i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM), Lulzim Çitaku.²³

Sipas Supremes, gjykata e shkallës së parë dhe ajo e dytë në aktgjykimet e veta, me lirimin e të pandehurit sa i përket veprës penale të marrjes së ryshfetit kanë nxjerrë përfundime të gabuara për ekzistimin e saj dhe kanë aplikuar ligjin i cili nuk ka mundur të aplikohet, sepse me aplikimin e drejtë të ligjit penal ai do të shpallej fajtor për veprën penale që ishte objekt i akuzës.

Gjykata Supreme e kishte pranuar si të bazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë së paraqitur nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, edhe në rastin e të akuzuve për korrupsion, ish-drejtorit të Urbanizmit në Komunën e Gjilanit, Valon Shefkiu, shefit të inspeksionit të ndërtimit, Milot Shkodra, inspektorëve Baki Azemi e Bahrije Beqiri, si dhe të akuzuarit për heqje ose dëmtim të vulave zyrtare ose shenjave, Abdyl Brestovci. Përveç, të akuzuarit Azemi, të gjithë të akuzuarit tjerë ishin liruar nga akuzat nga Gjykata Themelore në Gjilan, aktgjykim i cili ishte vërtetuar pastaj edhe Gjykata e Apelit.²⁴

Përgjithësisht, IKD vlerëson se politika e dënimeve në rastet e korrupsionit ashtu si në të kaluarën edhe gjatë viteve 2018 dhe 2019, vazhdon të jetë e butë. Në rastet e monitoruara nga IKD gjatë 2018, rezulton se dënime me burgim efektiv ishin shqiptuar vetëm në katër raste, kurse dënime të kushtëzuara ishin shqiptuar në 11 raste dhe dënime me gjobë në katër raste. Ndërsa, aktgjykime liruese kishin qenë 48, kurse aktgjykime refuzuese 4. Siç edhe shihet nga këto të dhëna, rezulton se gjykatësit kryesisht zbatojnë politikë të butë ndëshkimore, ndaj kryesve të veprave penale të korrupsionit.

Për më tepër, në raportin e IKD-së mbi Politikën Ndëshkimore në Kosovë, IKD kishte gjetur se politika ndëshkimore nuk është e uniformuar as vetë brenda Gjykatës së Apelit. “ Fillimisht, pas analizimit të këtyre rasteve, IKD ka gjetur se edhe brenda vetë Gjykatës së Apelit çështja e politikës ndëshkimore, në kuptim të udhëzuesit, nuk është e unifikuar. Kjo për arsye se ka një laramani të madhe në mes të aktgjykimeve të Gjykatës së Apelit për këtë pjesë. Në këtë mënyrë, përderisa edhe brenda vetë Gjykatës së Apelit nuk ka një standard të unifikuar se si veprohet në këto raste, praktika në gjykatat e shkallës së parë do të jetë aq më e pa unifikuar”, thuhej në raportin e IKD-së²⁵.

²³ Gjykata Supreme konstaton shkelje në rastin e lirimit të inspektorit të KPM-së nga akuza për marrje ryshfeti”. Betimi për Drejtësi. 17 shtator 2019 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-supreme-konstaton-shkelje-ne-rastin-e-lirimit-te-inspektorit-te-kpmm-se-nga-akuza-per-marrje-ryshfeti/>) (Qasur së fundi më 15 janar 2020).

²⁴ “Supremja konstaton shkelje në rastin e ish-zyrtarëve të Komunës së Gjilanit që ishin liruar nga akuzat për korrupsion”. Betimi për Drejtësi (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/supremja-konstaton-shkelje-ne-rastin-e-ish-zyrtareve-te-komunes-se-gjilanit-qe-ishin-liruar-nga-akuzat-per-korrupsion/>) (Qasur së fundi më 15 janar 2020).

²⁵ Gzim Shala. Politika Ndëshkimore në Kosovë. IKD. 18 nëntor 2019. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2019/11/Politika-ndeshkimore-ALB-FINAL-2.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 3 shkurt 2020).

Ndryshe, sipas gjetjeve të IKD-së, në rastet e profilit të lartë të monitoruar gjatë vitit 2018 dhe të vitit 2019, del se mesatarisht, nga ngritja e aktakuzës e deri në aktgjykimin e Apelit për këto raste, kalojnë mesatarisht rreth 3 vjet.

Po ashtu, përkundër kritikave që vet kreu i Apelit, Hasan Shala, kishte pasur lidhur me politikën ndëshkimore për rastet e korrupsionit, sipas monitorimit të IKD-së, del se Apeli, edhe pse në kuadër të autorizimeve të veta mund edhe të ashpërsojë dënimet e shkallës së parë, një gjë të tillë e kishte bërë në vetëm në një rast të korrupsionit gjatë vitit 2018, kurse në vitin 2019, vetëm në dy raste. Në këtë mënyrë, akterët e GjA-së politikën ndëshkimore e kishin kritikuar, por nuk e kishin adresuar.

Shikuar në përgjithësi, shkalla e dytë ishte treguar e “mëshirshme” ndaj të akuzuarve për krime të rënda, pasi që, gjatë vitit 2018, kjo gjykatë, përkatësisht Departamenti i Krimeve të Rënda, në 75 raste kishte ndryshuar aktgjykimet e shkallës së parë duke i zbutur dënimet ndaj të akuzuarve, kurse, në vetëm 18 raste kishte bërë të kundërtën.²⁶

Për më tepër, kjo e dhënë është edhe një fakt tjetër se Politika e Dënimeve në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës nuk është e uniformuar dhe konsistente, nisur nga dallimet kaq të mëdha në dënime të Gjykatës së Apelit në raport me Gjykatat Themelore.

Një trend i tillë, vetëm se më pak i theksuar ka vazhduar edhe gjatë vitit 2019, ashtu që në nëntë mujorin e parë këtij viti, Apeli i kishte zbutur dënimet në rastet e të akuzuarve për krime të rënda, në 39 raste, kurse i kishte ashpërsuar dënimet në 27 raste.²⁷

Luftimi i korrupsionit ishte dhe vazhdon të mbetet edhe kërkesë e Bashkimit Evropian për liberalizimin e vizave dhe për këtë arsye, nga ana e Prokurorit të Shtetit, dhjetëra lëndë janë shënjestruar për këtë proces²⁸. Lidhur me këto lëndë, kreu i Apelit, Hasan Shala, në një konferencë për media të mbajtur më 10 janar 2019, ku kishte prezantuar punën një vjeçare të gjykatës që udhëheq, kishte deklaruar se të gjitha lëndët e shënjestruara ishin përfunduar nga Apeli.

Megjithatë, një deklaram i tillë i Shalës, sipas gjetjeve të IKD-së kishte dalur se nuk është i saktë. Kjo, pasi që në një përgjigje zyrtare që IKD ka marr nga Gjykata e Apelit më 24 janar 2019, apo 14 ditë pas konferencës së lartpërmendur del se kjo gjykatë ka pas në punë pesë lëndë të

²⁶ “Raporti vjetor i Këshillit Gjyqësor të Kosovës” (Shih linkun: http://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/96799_KGJK_RAPORTI_VJETOR_2018_SHQ.pdf) . (Qasur së fundi më 11 nëntor 2019).

²⁷ “Raporti statistikor i gjykatave – nëntëmujori 2019:”. Këshilli Gjyqësor i Kosovës (Shih linkun: https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/25932_Raporti_Statistikor_Gjykatave_Nentemujor_2019.pdf)

²⁸ Gashi Leotrim, Kadria Medina. Dështimet në Rastet e Shënjestëruara. IKD. Qershor 2019. (shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2019/07/5.-Deshtimet-ne-rastet-e-shenjestruara-25.06.2019.pdf>). (Qasur së fundi më 11 nëntor 2019).

shënjestruara për viza edhe pse kryetari Shala kishte thënë se të gjitha lëndët e tilla ishin përfunduar nga Apeli.²⁹

Kështu, në janar 2019, të pakryera në Apel, kishin qenë, lënda e ish-sekretarit të Ministrisë së Shëndetësisë (MSH), Ilir Tolaj etj. lënda e njohur në publik si “Kohler”, ku të akuzuar janë Avni Alidemaj etj, lënda e njohur si “Mërgimtari”, ku të akuzuar janë Miftar Dobraj etj si dhe rasti i ish-gjykatëses Safete Tolaj etj, si dhe në fazën e konfirmimit të akuzës kishte qenë edhe rasti ish-krerëve të Telekomit të Kosovës, Agron Mustafa, Ejup Qerimi dhe Rexhë Gjonbalaj.

Gjykata e Apelit, në kuadër të autorizimeve që ka, mund t’i prishë aktgjykimet e shkallës së parë dhe lëndët t’i kthej në rigjykim. Vendime të tilla, pra kthimin e lëndëve në rigjykim, Apeli kishte vendosur në rreth 20 % të lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2018. Disa nga këto lëndë, si psh. rasti ndaj Ilir Dushit dhe të akuzuarve të tjerë lëndë ishte kthyer në rigjykim dy herë apo në rastin e ish-drejtorit të ish-fabrikës “Anthea”, Flurim Gallopeni,³⁰ Apeli e kishte kthyer lëndën në rigjykim tri herë.

Gjatë vitit 2019, ka pasur një rritje të lëndëve të korrupsionit që ishin kthyer në rigjykim, ashtu që, nga 88 lëndë të kësaj natyre që janë zgjidhur nga GjA gjatë këtij viti, 26 nga to janë kthyer në rigjykim apo thënë në përqindje, 29 % të lëndëve që janë zgjidhur janë kthyer në rigjykim.

Në këtë drejtim, IKD vlerëson se, në rastet kur ia mundëson ligji, Gjykata e Apelit duhet të marrë përsipër që të vendosë meritonisht në rastet të cilat i vinë në punë më shumë se një herë, pasi që, kthimi në rigjykim i rasteve shpesh herë mund të ketë pasojë edhe parashkrimin e veprave penale për të akuzuarit, siç edhe kishte ndodhur në rastin e ish-kryetarit të Dragashit, Salim Jenuzi.³¹

Funksionalizimi i plotë i Divizionit të Gjykatës së Apelit në Mitrovicë gjatë vitit 2018, themeluar sipas Marrëveshjes së Brukselit, ishte quajtur histori suksesi nga kryetari i Apelit, Hasan Shala, kur ky i fundit kishte prezantuar punën e Apelit gjatë vitit 2018. Megjithatë, ky divizion i përbërë nga shtatë gjyqtar, sipas lëndëve të kryera gjatë vitit të kaluar del se as për së afërmi nuk i ngjan një historie suksesi.

Një veprim të drejtë në kuptim të rritjes së transparencës Gjykata e Apelit e ka bërë me publikimin e të dhënave individuale për punën e secili gjykatës. Këtë veprim më pas e ka bërë edhe KGJK, ku ka publikuar raportin individual të punës së gjithë gjyqtarëve.

²⁹ “Kryetari i Apelit thotë se i kanë kryer të gjitha lëndët e shënjestruara për viza, bën thirrje të ndalet bojkoti i avokatëve”. Betimi për Drejtësi. 10 janar 2019 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kryetari-i-apelit-thote-se-i-kane-kryer-te-gjitha-lendet-e-shenjestruara-per-viza-ben-thirrje-te-ndalet-bojkoti-i-avokateve/>). (Qasur së fundi më 11 nëntor 2019)

³⁰ “Apeli e kthen sërish në rigjykim rastin ndaj zyrtarëve të AKPPM-së të akuzuar për korrupsion”. Betimi për Drejtësi. 30 maj 2018 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-e-kthen-serish-ne-rigjykim-rastin-ndaj-zyrtareve-te-akppm-se-te-akuzuar-per-korrupsion/>). (Qasur së fundi më 11 nëntor 2019). “I akuzuari për keqpërdorim detyre kërkon përjashtimin e trupit gjykues pasi rasti ndaj tij tre herë u kthye në rigjykim”. Betimi për Drejtësi. 29 janar 2019 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/i-akuzuari-per-keqperdorim-detyre-kerkon-perjashtimin-e-trupit-gjykues-pasi-rasti-ndaj-tij-tre-herë-u-kthye-ne-rigjykim/>). (Qasur së fundi më 11 nëntor 2019)

³¹ “Aktgjykim refuzues ndaj ish-kryetarit të Dragashit, shpallet i pafajshëm i akuzuar për uzurpim prone”. Betimi për Drejtësi. 9 tetor 2018 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/aktgjykim-refuzues-ndaj-ish-kryetarit-te-dragashit-shpallet-i-pafajshem-i-akuzuari-per-uzurpim-prone/>). (Qasur së fundi më 11 nëntor 2019)

Lidhur me publikimin e raportit të punës individuale të Gjyqtarëve, IKD vlerëson se është një vendim i drejtë në kuptim të ngritjes së transparencës. Vendimin e tillë menjëherë pas GjA-së e ka ndërmarrë edhe KGJK, por jo edhe KPK. Përkundër kërkesave të vazhdueshme që KPK të bëjë publike numrin e lëndëve të kryera nga secili prokuror, ky institucion ka refuzuar që të ofrojë qasje në këto të dhëna.

Në anën tjetër, edhe gjatë dy viteve të kaluara, orari i seancave publike të cilat publikohen në faqen zyrtare të gjykatës vazhdon të jetë i mangët.

Sa i përket publikimit të aktgjytimeve në web faqen e saj, GjA është treguar si një ndër gjykatat më transparente në këtë aspekt, ashtu që, aktualisht i ka të publikuara 2541 aktgjytime në të cilat mund të qaset publiku.³²

Po ashtu, problem banal, sipas gjetjeve të IKD-së del edhe drejtshkrimi në disa nga aktgjykimet e Gjykatës së Apelit, në të cilat vërehen gabime drejtshkrimore të theksuara, si mungesa e përdorimit të shkronjave “ë” dhe “ç”, pastaj mos përdorimi i shenjave të pikësimit e deri te gabimi i datave të ndryshme çka shpeshherë i bën këto aktgjytime të pakuptueshme.

Për më tepër, IKD gjen se në disa prej aktgjytimeve të GjA-së mungon edhe arsyetimi i mjaftueshëm mbi vendimin e marrë.

Lidhur me cilësinë e aktgjytimeve, IKD i rikujton GjA-së se për palët, publikun dhe drejtësinë, e rëndësishme është vetëm ajo çfarë gjyqtari e paraqet në aktgjykim. Thënë më ndryshe, bindja e gjyqtarit materializohet në aktgjykimin me shkrim. Për këtë arsye, gjyqtarët duhet të bëjnë përpjekje maksimale që për një vendim të marrë, palët dhe publiku të jenë të bindur se i njëjti është merituar dhe i bazuar në ligj, të cilin ligj në situatën konkrete e ka zbatuar një gjyqtar i caktuar. Në këtë drejtim, rëndësi të veçantë duhet ti kushtohet edhe aspektit drejtshkrimor, në mënyrë që ajo që thuhet në aktgjykimet e GjA-së, të paktën mos të ketë problem që të kuptohet.

Nga 27 seancat e monitoruara të natyrës korruptive që IKD ka monitoruar gjatë vitit 2018 në Gjykatën e Apelit, organi i akuzës apo Prokuroria e Apelit në këtë rast ka prezantuar në vetëm tri prej këtyre seancave. Përkundër se nuk janë të obliguar me ligj, prokuroria nuk kishte dërguar përfaqësuesit e saj për t'i mbrojtur ankesat e tyre apo kundërshtuar ankesat e të akuzuara edhe në raste të tilla si në rastin e ish-prokurores Vahide Badivuku ose rastin e inspektorëve të Komunës së Prishtinës.

Gjithashtu, shifra e lëndëve të kryera nga Apeli gjatë vitit 2018, sipas raportit vjetor të kësaj gjykate, nuk përputhet me raportin statistikor të gjykatave të punuar nga Këshilli Gjyqësor të Kosovës.

Përderisa në Raportin Vjetor të Gjykatës së Apelit, thuhet se kjo gjykatë gjatë vitit 2018 ka zgjidhur 13,641 lëndë, në Raportin Statistikor të Gjykatave të KGJK-së, numri i lëndëve të zgjidhura nga Apeli është 13,647. Një diskrepancë e tillë, ndonëse jo e madhe, paraqitet edhe në

³² Shënim: Ky numër i aktgjytimeve të publikuara ka qenë më 15 janar 2020. (Shih linkun: <https://apeli.gjyqesori-rks.org/publikimet/aktgjykimet/lista-me-aktgjykimet-e-fundit/>)

numrin e lëndëve që janë pranuar në punë nga GjA gjatë vitit 2018, ashtu që sipas raportit të KGJK-së, ky numër është, 14,028 kurse sipas raportit vjetor të GjA, ky numër është 14,021.

Po ashtu, dallim mes raportit të KGJK-së dhe të dhënave të Gjykatës së Apelit ka edhe në numrin e gjyqtarëve që kanë kryer lëndë. Derisa, në raportin e KGJK-së thuhet se në periudhën raportuese për vitin 2018, në Gjykatën e Apelit kishin qenë 41 gjyqtarë që kishin zgjidhur lëndë, në raportin vjetor të GjA ky numër i gjyqtarëve është 36.

Lidhur me këto statistika, IKD i rikujton GjA-së dhe KGJK-së se këto statistika nuk janë formale, por janë burim i pazëvendësueshëm i publikut për tu njoftuar lidhur me punën e institucioneve të drejtësisë. Për këtë arsye, me qëllim të ngritjes së transparencës në njërën anë dhe qartësimin të gjendjes në GjA, të dy këto institucione të sistemit gjyqësor duhet të kujdesen që të dhënat statistikore të jenë në përputhje, dhe mos të krijojnë konfuzitet tek publiku dhe tek vet gjyqësori.

7. Trajtimi i rasteve të korrupsionit në Gjykatën e Apelit

Sikurse në vitet e kaluara edhe gjatë viteve 2018 dhe 2019, kritikët më të mëdha që vazhdojnë t'i bëhen sistemit gjyqësor në Kosovë, vazhdojnë të jenë ato që kanë të bëjnë me rastet e korrupsionit, në veçanti me trajtimin e rasteve të profilit të lartë.

Zëvendëskryeministër, ministra, kryetar e ish-kryetar komunash, rektor të universiteteve publike e kryetar të Organit Shqyrtues të Prokurimit, u liruan përfundimisht nga akuzat për korrupsion gjatë viteve 2018 dhe 2019 nga Gjykata e Apelit.

Për disa nga ta, gjykata e shkallës së dytë ka vërtetuar aktgjykimet liruese të marrë në shkallën e parë, kurse, në disa raste, sikurse atë të ish-rektorit të Universitetit të Prishtinës (UP), Enver Hasani apo të ish-kryetarit të Komunës së Parteshit, Dragan Nikoliq, Apeli i kishte përmbysur aktgjykimet e shkallës së parë duke i liruar të njëjtit nga akuzat për të cilat ishin dënuar nga Gjykatat Themelore.

Në ndërkohë, Apeli nuk e ka bërë asnjëherë të kundërtën, përkatësisht që të shqiptojë dënimin e ndonjë zyrtari të profilit të lartë pasi që paraprakisht i njëjti ishte liruar nga akuzat në shkallë të parë.

Madje, në raste të aktgjyqimeve liruese ndaj të akuzuarve të profilit të lartë, Apeli në asnjë rast nuk kishte vendosur që lëndët të kthehen në rigjykim.

Në këtë mënyrë nuk kishte vepruar me aktgjykimet dënuese të shqiptuara nga Gjykatat Themelore. Në rastet e ish-kryetarit të Komunës së Dragashit, Salim Jenuzi, ish-Kryetarit të Komunës së Lipjanit, Shukri Buja, ish-kryetarit të Komunës së Klinës, Sokol Bashota si dhe në rastin e ish-ministrit të Shëndetësisë, Ferid Agani, të cilët ishin dënuar për korrupsion nga shkalla e parë, GjA i kishte kthyer lëndët në rigjykim.

Po ashtu, në rivendosje, gjatë fazës së konfirmimit të aktakuzës, Apeli i kishte kthyer edhe disa lëndë të profilit të lartë, sikurse ajo për ish-kryetarin e Gjakovës, Pal Lekaj, lëndën e ish-kryetarit të Gjilanit, Qemajl Mustafa, lëndën e ish-kryetarit të Klinës, Sokol Bashota dhe lëndën e ish-kryetarit të Komunës së Drenasit, Nexhat Demaku.

Megjithatë, pas rivendosjes, Apeli kishte konfirmuar pastaj aktakuzat ndaj të lartpërmendurve. Në rastin e Qemajl Mustafës, GjA-së i ishte dashur plotë tre herë të vendos, qysh në fazën e konfirmimit të aktakuzës.

Po ashtu, gjatë kësaj periudhe, Apeli kishte vendosur për konfirmim të aktakuzës edhe ndaj ish-deputetit Milaim Zeka, ish-kryetarit të Komunës së Suharekës, Sali Asllanaj dhe Kryetarit të Komunës së Istogut, Haki Rugova.

Në një rast të rrallë të korrupsionit të profilit të lartë, Apeli e kishte përmbysur vendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, e cila e kishte hudhur poshtë aktakuzën e PSRK-së për rastin e njohur si “Z-Mobile”, ku për korrupsion akuzoheshin ish-shefat e Telekomit të Kosovës, Agron

Mustafa, Rexhë Gjonbalaj dhe Ejup Qerimi, duke e lënë në fuqi kështu aktakuzën dhe duke e udhëzuar shkallën e parë që të procedojë me shqyrtim gjyqësor në këtë rast.³³

Në këtë mënyrë, deri më tani nuk është arritur që në një rast të vetëm, ndaj një zyrtari të profilit të lartë të ketë një dënim me burgim efektiv.

Lidhur me dështimin e aktakuzave të korrupsionit, kryetari i Gjykatës së Apelit, Hasan Shala, kishte adresuar kritika ndaj prokurorëve duke thënë se të njëjtit po tregohen joprofesional kur po vjen puna tek mbrojtja e aktakuzave të korrupsionit.

Një deklaram të tillë, Shala e kishte në korrik të vitit 2018, gjatë një konference për media ku kishte prezantuar punën gjashtë mujore të gjykatës që udhëheq.

“Kem vërejtje në këtë aspekt pasi që akuzat që po ushtrohen në gjykatë, po më duket nuk po mund të argumentohen nga prokurorët. Arsye pse po ndodh kjo është se sigurisht ju mungon profesionalizmi. Mirëpo, është edhe një gjë tjetër, prokurori që bën hetimet rrallë ndodhë që ai prokuror të përfaqësojë atë aktakuzë edhe në gjykatë”, kishte thënë Shala.³⁴

Gjykata e Apelit, vitin 2018 e kishte filluar me 16 lëndë të korrupsionit që ishin trashëguar nga viti 2017, kurse gjatë vitit 2018, kishte pranuar në punë edhe 109 lëndë të tjera të kësaj natyre. Pra, në total, kjo gjykatë në vitin 2018 kishte pasur në punë gjithsej 125 lëndë të natyrës së korrupsionit.


Deri në fund të vitit 2018, kjo gjykatë kishte arritur të përfundojë 107 nga këto lëndë, apo 85.6 % të lëndëve që kishte pasur në punë.

Prej këtyre lëndëve, në 64 raste, Apeli kishte vendosur që të refuzojë ankesat e palëve dhe t’i vërtetojë aktgjykimet e gjykatave të shkallës së parë, kurse në 21 raste tjera apo 19.62 % të lëndëve të zgjidhura në total gjatë vitit 2018, Apeli kishte vendosur që t’i anulojë aktgjykimet e shkallës së parë dhe lëndët t’i kthej në rigjykim.

Shkaku kryesor i kthimit të lëndëve në rigjykim, gjatë vitit 2018, ka qenë shkelja e dispozitave të procedurës penale nga gjykatat e shkallës së parë, pasuar nga vërtetimi i gabuar ose i jo i plotë i gjendjes faktike.

³³ “Apeli vendos që Agron Mustafa dhe ish-drejtnesit e tjerë të Telekomit të Kosovës të gjykohen për rastin “Z-Mobile”. Betimi për Drejtësi. 4 shkurt 2019 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-vendos-qe-agron-mustafa-dhe-ish-drejtnesit-tjere-te-telekomit-te-kosoves-te-gjykohen-per-rastin-z-mobile/>). (Qasur së fundi më 15 janara 2019).

³⁴ “Kryetari i Apelit thotë se prokurorët po tregohen joprofesionalë në mbrojtjen e aktakuzave të korrupsionit” Betimi për Drejtësi. 13 korrik 2018 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kryetari-i-apelit-thote-se-prokuroret-po-tregohen-joprofesionale-ne-mbrojtjen-e-aktakuzave-te-korrupsionit/>). (Qasur së fundi më 15 janar 2019).




Grafika 8 - Vendimet e Gjykatës së Apelit për ankesat në rastet e korrupsionit – viti 2018.

Ndërsa, vitin 2019, Gjykata e Apelit e kishte nisur me 18 lëndë të korrupsionit të trashëguara, kurse deri në fund të vitit, kishte pranuar në punë edhe 89 lëndë, ashtu që numri total i lëndëve të korrupsionit që GjA kishte pasur në punë kishte qenë 107.

Nga ky numër, GjA kishte vendosur në 88 raste, kurse të pakryera në fund të vitit 2019, i kanë mbetur edhe 19 lëndë.

Gjatë vitit 2019, GjA i kishte refuzuar ankesat dhe vërtetuar aktgjykimet e shkallës së parë në 49 raste, 26 tjera i kishte kthyer në rigjykim, në 2 raste i kishte ashpërsuar dënimet, në 4 raste tjera i kishte zbutur dënimet e shqiptuara nga shkalla e parë, në 1 rast ankesa ishte hudhur si e palejuar kurse në 6 raste ishte vendosur në mënyrë tjetër.



Grafika 9 – Vendimet e Gjykatës së Apelit për ankesat në rastet e korrupsionit – 2019.

Kryetari i Gjykatës së Apelit, Hasan Shala, në një konferencë për media, të mbajtur në muajin korrik të vitit 2018, kishte adresuar kritika sa i përket politikës së dënimeve të shqiptuara në rastet e korrupsionit, kur kishte thënë se dënimet e shqiptuara në rastet kur vërtetohet kryerja e veprës penale, duhet të jenë meritore dhe jo të shqiptohen dënime me kusht edhe në rastet kur kemi të bëjmë me shifra nga 100 mijë apo 200 mijë euro.³⁵

Një deklaram të tillë, Shala e kishte përsëritur edhe në konferencën për medie që kishte mbajtur më 10 janar 2020, ku kishte prezantuar punën një vjeçare të gjykatës që ai udhëheq. Ndër të tjera, Shala gjatë kësaj konference kishte theksuar se dënimet me kusht po e stimulojnë kryerjen e veprave të korrupsionit.³⁶

Por, këtë kritikë që Shala më shumë ua kishte drejtuar Gjykatave Themelore, IKD vlerëson se vlen edhe për vet Gjykatën e Apelit. Madje, nisur nga roli i Gjykatës së Apelit si gjykatë përfundimtare, sipas mjeteve të rregullta, përgjegjësia më e madhe në këtë drejtim bie mbi vet Gjykatën e Apelit.

Kjo, pasi që një pjesë e madhe e lëndëve të cilave u ishte referuar Shala, shkojnë edhe në GjA me ankese, e ku kjo e fundit në kuadër të autorizimeve që si gjykatë e shkallë së dytë ka, është

³⁵ “Kryetari i Apelit thotë se prokurorët po tregohen joprofesionalë në mbrojtjen e aktakuzave të korrupsionit”. Betimi për Drejtësi. 13 korrik 2018 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kryetari-i-apelit-thote-se-prokuroret-po-tregohen-joprofesionale-ne-mbrojtjen-e-aktakuzave-te-korrupsionit/>) (Qasur së fundi më 15 janar 2020)

³⁶ “Kreu i Apelit thotë se dënimet me kusht po stimulojnë kryerjen e veprave të korrupsionit”. Betimi për Drejtësi (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kreu-i-apelit-thote-se-denimet-me-kusht-po-stimulojne-kryerjen-e-veprave-te-korrupsionit/>) (Qasur së fundi më 15 janar 2020).

edhe mundësia e ndryshimit të aktgjykimit të shkallës së parë dhe në rastet konkrete të cilave iu është referuar kryetari Shala, edhe të rris dënimet e shqiptuara nga gjykata e shkallës së parë.

Megjithatë, sipas të dhënave që IKD ka siguruar nga Gjykata e Apelit, kjo e fundit gjatë vitit 2018, vetëm në një rast kishte vendosur që t'i ashpërsojë dënimin e shqiptuar të akuzuarve për korrupsion dhe atë, të akuzuarve Hakif Velu e Albert Rakipi, të akuzuar në rastin “Kontrata”, ku akuzohej edhe ish-rektori Enver Hasani, i cili ishte liruar nga Apeli. Kurse, në tri raste të tjera, Apeli kishte zbutur dënimet të akuzuarve për korrupsion.

Gjatë vitit 2019, GjA vetëm në dy raste kishte ashpërsuar dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarve për korrupsion, kurse, në katër raste tjera i kishte zbutur dënimet.

Në këtë mënyrë, IKD vlerëson se akterët e sistemit të drejtësisë, nuk duhet të sillen sikur analistë të problematikave të sistemit të drejtësisë, por duhet të adresojnë të njëjtat probleme sipas kompetencave të tyre ligjore. Në këtë drejtim, GjA para se të jap kritika mbi politikën ndëshkimore, duhet që si shkallë e dytë, përkatësisht si gjykata më e lartë sipas mjeteve të rregullta, të vendosë standarde të politikës ndëshkimore, bazuar në kompetencat e saja ligjore. Në këtë mënyrë, përpos që përmes këtyre standardeve GjA do ti evitonte gabimet e shkallës së parë, e njëjta do të unifikonte praktikën për tërë Gjykatat Themelore.

IKD gjatë monitorimit që i ka bërë Apelit gjatë vitit 2018 dhe 2019, ka gjetur se kjo gjykatë ka trajtuar gjithsej 14 raste ku të akuzuar kishin qenë të akuzuar, zyrtar të lartë publik.

8. Analizë e veçantë e trajtimit të rasteve të korrupsionit nga Apeli

Gjatë viteve 2018 dhe 2019, Gjykatës së Apelit i është dashur të merr vendim në disa raste, ku të akuzuarit i kanë takuar profilin të lartë mes të cilëve ishin, Zëvendëskryeministri Fatmir Limaj, Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ish-Ministri i Shëndetësisë, Ferid Agani, Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ish-kryetari i Komunës së Klllokotit, Sasha Mirkoviq, ish-kryetari i Komunës së Obiliqit, Mehmet Krasniqi, ish-kryetari i Komunës së Lipjanit, Shukri Buja, ish-kryetari i Komunës së Parteshit, Dragan Nikoliq, ish-kryetari i Komunës së Dragashit, Salim Jenuzi, ish-rektori i Universitetit të Prishtinës, Enver Hasani, ish-kryetari i Organit Shqyrtues i Prokurimit, Hysni Hoxha, ish-kryetari i Gjykatës Komunale të Prishtinës, Nuhi Uka, si dhe vet ish-kryetari i Gjykatës së Apelit, Salih Mekaj.

Ajo çka bie në sy nga rastet e lartpërmendura është fakti se nga të gjitha këto raste me të akuzuar të profilin të lartë, vetëm katër nga ta kishin qenë në pozitë të tyre, përkatësisht, Fatmir Limaj, në pozitën e zëvendëskryeministrit, Endrit Shala dhe Valdrin Lluka në pozitë të ministrit si dhe Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj. Por, qoftë zyrtarë apo ish-zyrtar të profilin të lartë, që të gjithë të akuzuarit e profilin të lartë që ishin subjekt i vendimeve të Gjykatës së Apelit gjatë vitit 2018 janë liruar përfundimisht nga GjA, apo rastet e tyre janë kthyer në rigjykim.

Kjo, pasi që për të gjithë këta të akuzuar, Apeli ose ka vërtetuar aktgjykimet liruese të shkallës së parë, siç kishte vepruar në rastet e zëvendëskryeministrit Limaj, ministrave, Shala dhe Lluka, ish-kryetarëve të komunave, Mehmet Krasniqi, Sasha Mirkoviq, ish-kreut të OSHP-së, Hysni Hoxha dhe ish-kryetarëve të gjykatave, Nuhi Uka dhe Salih Mekaj, ose edhe kishte përmbysur aktgjykimet edhe ashtu të rralla dënuese për profilin e lartë dhe kishte liruar nga akuzat, në këtë rast, ish-rektorin e UP-së, Enver Hasani dhe ish-kryetarin e Parteshit, Dragan Nikoliq.

Në katër raste tjera, Apeli i kishte kthyer në rigjykim, rastin e ish-kryetarit të Lipjanit, Shukri Buja, i cili ishte dënuar me 3 vjet burg për korrupsion nga shkalla e parë, rastin e ish-ministrit Ferid Agani, i dënuar me 2 vjet e 6 muaj burg për korrupsion rastin e ish-kryetarit të Dragashit, Salim Jenuzi i cili po ashtu ishte dënuar nga shkalla e parë, kurse në rastin e kryetarit të Malishevës, Ragip Begaj, e kishte hudhur poshtë qysh në fazën fillestare aktakuzën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) të ngritur ndaj Begajt.

1. Rasti “MTPT”, Fatmir Limaj etj

Vepra penale: Krim i organizuar lidhur me veprat penale “Shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit; “Marrje e ryshfeti”; “Dhënie e ryshfeti”; “Keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi”; “Mos deklarimit të parave të pranuar për fushatë”

Kolegji i Apelit: Driton Muharremi; Mejreme Memaj; Afrim Shala

Të akuzuar: Fatmir Limaj; Endrit Shala; Shpëtim Telaku; Florim Zuka; Nexhat Krasniqi

Vendimi i Apelit: Vërtetimi i aktgjyqimit lirues të Gjykatës Themelore në Prishtinë

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK), kishte ngritur aktakuzën e konsoliduar më 28 shtator 2015, me anë të së cilës ishin bashkuar dy aktakuza të mëparshme të rasteve MTPT 1 dhe MTPT 2. Aktakuza e konsoliduar i ngarkonte të akuzuarit Fatmir Limaj, Endrit Shala, Nexhat Krasniqi për veprat penale krim i organizuar, keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, marrje ryshfeti, Shpëtim Telakun për veprat penale, krim i organizuar dhe keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar dhe të akuzuarin e fundit, Florim Zukën, për veprat penale, dhënie ryshfeti dhe keqpërdorim i autorizimeve ekonomike.

Gjykata Themelore në Prishtinë, në nëntor 2017, i kishte liru nga akuzat të gjithë të akuzuarit.

Këtë aktgjykim të shkallës së parë e kishte kundërshtuar, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, për shkak të pretendimeve se ai aktgjykim, është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal. Për këto arsye, PSRK-ja i kishte propozuar Gjykatës së Apelit ta anulojë aktgjykimin e Themelores dhe çështjen t’ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Mirëpo, këto pretendime të PSRK-së i kishte hedhur poshtë si të pabazuara gjykata e shkallës së dytë, më 30 maj 2019.

Sipas vendimit të Apelit, aktgjykimi i shkallës së parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara në ankesë dhe as që ka shkelje tjera të cilat Apeli, si instancë e dytë i shqyrton detyrimsht, e të cilat kishin për ta kushtëzuar anulimin e tij. Po ashtu, Apelit kishte vlerësuar se edhe gjendja faktike në këtë rast ishte vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Aktakuza e parë në këtë rast ishte ngritur qysh në vitin 2012, përkatësisht aktakuza e njohur si “MTPT 1”, kurse aktakuza e dytë, “MTPT 2”, ishte ngritur në vitin 2014. Aktakuza e konsoliduar në këtë rast ishte ngritur në vitin 2015. Nga viti 2012, Limaj dhe të tjerët kishin pasur një aktakuzë aktive deri në maj të vitit 2019, kur edhe ishte marr vendimi nga ana e Apelit.

Edhe pse lëndë e profilit të lartë, kjo lëndë, vetëm në Gjykatën e Apelit kishte pritur të zgjidhej mbi një vit.

Ky rast në shkallën e parë ishte gjykuar nga trupi gjykues në përbërje nga dy gjykatëse të Eulex-it dhe një gjykatësi vendor, kurse kolegji i Gjykatës së Apelit kishte qenë në përbërje nga tre gjykatës vendor.

Gjykata e Apelit nuk kishte mbajtur seancë publike për shqyrtimin e ankesave të palëve në këtë rast.³⁷

Nga ngritja e aktakuzës së parë në këtë rast në vitin 2012 e deri në vendimin e Apelit, kishin kaluar gjithsej 2,367 ditë apo 6 vjet e 5 muaj.

³⁷ *Shënim:* Kodi i Procedurës Penale, në nenin 390 e ka përcaktuar se palët njoftohen për seanca të kolegjit të Apelit vetëm në rastet kur dënimet e shqiptuara në shkallë të parë janë me burgim efektiv. Kësisoj, përveç në raste të rralla, GjA nuk mban seanca publike në rastet kur aktgjykimet e shkallës së parë nuk janë me burg efektiv. “Kur të akuzuarit i është shqiptuar dënimi me burgim, njoftimi për seancën e kolegjit të apelit i dërgohet prokurorit kompetent të shtetit, të dëmtuarit, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij.” – neni 390 i KPRK-së.

2. Rasti “Stenta 1”, Ferid Agani dhe Gani Shabani

Vepra penale: Keqpërdorimi i detyrës apo autoritetit zyrtar

Kolegji i Apelit: Vaton Durguti; Burim Ademi; Ferit Osmani

Të akuzuar: Ferid Agani; Gani Shabani

Vendimi i Apelit: Anulim i aktgjykimit dënues të Gjykatës Themelore - Rigjykim

Prokuroria e Shtetit, më 15 qershor 2016, kishte ngritur aktakuzë kundër ish-ministrit të Shëndetësisë, Ferid Agani, sekretarit të përgjithshëm të MSh, Gani Shabani dhe 62 personave të tjerë, për veprat penale “keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “marrje e ryshfetit”, “dhënie e ryshfetit”, “trajtimi i pandërgjegjshëm mjekësor”, “ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore dhe farmaceutike” dhe “shmangia nga tatimi”.

Ky rast, në shkurt të vitit 2018, ishte veçuar nga kryetarja e trupit gjykues në shkallë të parë, ashtu që Agani dhe Shabani janë gjykuar veçmas, kurse për të akuzuarit tjerë janë duke u zhvilluar dy procedura tjera, në rastet që njihen si “Stenta 2” dhe “Stenta 3”.

Agani dhe Shabani akuzohen se kishin keqpërdorur pozitën e tyre zyrtare me rastin e lidhjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit me spitalet private, si dhe me ndarjen e mjeteve për pacientët që ishin trajtuar në këto spitale.

Lidhur me këto akuza, Gjykata Themelore në Prishtinë më 24 prill 2019 kishte shpallur fajtor ish-ministrin e Shëndetësisë, Ferid Agani dhe ish-sekretarin e kësaj ministrie, Gani Shabani, për keqpërdorim të pozitës zyrtare. Agani ishte dënuar me 2 vjet e 6 muaj burg, kurse Shabani, me 2 vjet burg.

Ankesë kundër aktgjykimit të Themelores, kishin bërë PSRK dhe mbrojtësit e të akuzuarve. PSRK kishte kërkuar nga Apeli rritjen e dënimeve për të akuzuarit, kurse, mbrojtësit e të akuzuarve kishin kërkuar që aktgjykimi të ndryshohet dhe klientët e tyre të lirohen nga akuza apo rasti të kthehet në rigjykim.

Duke vendosur lidhur me këto pretendime ankimore, GjA e kishte anuluar aktgjykimin e Themelores dhe lëndën e kishte kthyer në rigjykim në shkallë të parë. Sipas Apelit, aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e po ashtu edhe gjendja faktike është vërtetuar mënyrë jo të plotë dhe të gabuar, për çka kishte vlerësua se duhet të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Kjo lëndë, e cila është edhe e shënjestruar për liberalizim të vizave, në GjA ishte gjykuar nga Departamenti Special. Në GjA, lënda ishte pranuar më 12 shtator 2019, kurse seanca ku ishin shqyrtuar ankesat ishte mbajtur më 22 nëntor 2019. Vendimi i GjA, palëve u ishte dërguar rreth një muaj pas mbajtjes së seancës.

Duke qenë lëndë në të cilën akuzohen zyrtarë të lartë publik, kjo lëndë ishte trajtuar nga GjA brenda një afati të arsyeshëm kohor apo brenda tre muajve.

Seanca e GjA në këtë rast kishte qenë e hapur për publikun.

Nga ngritja e aktakuzës e deri në vendimin e Apelit, kishin kaluar 1,256 ditë, apo 3 vjet e 5 muaj.

3. Rasti i ish-rektorit të UP-së, Enver Hasani etj.

Vepra penale: Mashtrim në detyrë

Kolegji i Apelit: Afrim Shala; Mejreme Memaj; Hava Haliti

Të akuzuar: Enver Hasani; Hakif Veliu; Albert Rakipi

Vendimi i Apelit: Ndryshim i aktgjykimit të Gjykatës Themelore – Lirim nga akuza për Enver Hasanin, ashpërsim të dënimeve për Velin dhe Rakipin

Një ndër rastet më të përfolura gjatë vitit 2018, kishte qenë rasti i ish-rektorit të UP-së, Enver Hasani, i cili së bashku me Hakif Velin dhe Albert Rakipin akuzoheshin për veprën penale të mashtrimit në detyrë.

Aktakuza e PSRK-së pretendonte se të tre të akuzuarit në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale të “mashtrimit në detyrë”. Sipas PSRK-së, Enver Hasani në cilësinë e rektorit të UP-së, Haki Veliu në cilësi të shefit të Zyrës së Prokurimit në UP dhe Albert Ragipi në cilësi të drejtorit të Institutit për Studime Ndërkombëtare (ISN) me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për këtë institut, kishin falsifikuar kontratën origjinale lidhur me përkthimin e disa librave nga gjuha angleze në atë shqipe. Sipas aktakuzës, të njëjtit kishin hartuar edhe një kontratë të re, duke shfrytëzuar numrin e njëjtë të protokollit nga kontrata origjinale.

Gjykata Themelore në Prishtinë, më 18 tetor 2017, kishte shpallur aktgjykim dënues ndaj Hasanit, Haki Velit e Albert Rakipit, me arsyetimin se të njëjtit kishin kryer veprën penale me të cilën ngarkoheshin.³⁸

Sipas aktgjykimit të shkallës së parë, Enver Hasani ishte dënuar me një vit burgim me kusht, por dënimi ndaj tij nuk do të ekzekutohej nëse ai në periudhën dy vjeçare nuk do kryente vepër tjetër penale. Kurse, Hakif Veliu e Albert Rakipi, ishin dënuar me gjashtë muaj burgim efektiv. Por, ndaj tyre dënimi me burgim, mund të zëvendësohej me gjobë në shumë prej 10 mijë eurosh.

Mirëpo, pas ankesave të palëve, Gjykata e Apelit më 2 maj 2018, kishte ndryshuar aktgjykimin e Themelores, duke liruar nga akuzat Enver Hasanin me arsyetimin se nuk ishte provuar se i njëjti

³⁸ “Enver Hasani dënohet me burgim me kusht dhe obligohet t’ia kthejë UP-së mbi 70 mijë euro” Betimi për Drejtësi. 18 tetor 2017 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/enver-hasani-denohet-me-burgim-me-kusht-dhe-obligohet-tia-ktheje-up-se-mbi-70-mije-euro/>). (Qasur së fundi më 15 janar 2020).

kishte kryer veprën penale për të cilën akuzohej, kurse dy të akuzuarve tjerë, Hakif Veliu dhe Albert Rakipi, u kishte shqiptuar nga një vit burgim efektiv, secilit prej tyre.³⁹

Në arsyetimin e Apelit thuhej se kjo gjykatë nuk ia ka falur besimin dëshmisë së rektorit aktual të UP-së, Marjan Dema të dhënë në shkallë të parë, e ku sipas Apelit, dëshmia e rektorit aktual të UP-së, Marjan Demës, është skajshmërisht e papranueshme, pasi dëshmia e tij e dhënë në procedurën hetimore, ndryshon nga ajo e dhënë në shqyrtimin gjyqësor.

Deri në vendimin përfundimtar të gjykatës së shkallës së dytë, me të cilin e liroi Enver Hasanin nga akuza, erdhi duke u bazuar në parimin “in dubio pro reo”, duke konkluduar se kanë munguar provat valide që i akuzuari të shpallet fajtor.

Kurse, duke vendosur për rritjen e dënimeve për dy të akuzuarit tjerë, Hakif Veliu dhe Albert Rakipi, Apeli kishte vlerësuar se shkalla e parë me rastin e caktimit të dënimit i ka vlerësuar rrethanat lehtësuese të tilla si fakti se të njëjtin nuk kanë qenë të dënuar më parë dhe rrethanat tjera familjare, mirëpo sipas Apelit, rrethanat e tilla nuk e justifikojnë zbutjen e dënimit nën kufirin e parashikuar me ligj, e sidomos duke pas parasysh peshën e veprës penale.⁴⁰

³⁹ “Apeli e liron nga akuzat për korrupsion ish-rektorin e UP-së, Enver Hasani”. Betimi për Drejtësi. 15 maj 2018 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-e-liron-nga-akuzat-per-korrupsion-ish-rektorin-e-up-se-enver-hasani/>). (Qasur së fundi më 15 janar 2020).

⁴⁰ “Arsyetimi i Gjykatës së Apelit për lirimin e ish-rektorit të UP-së, Enver Hasani”. Betimi për Drejtësi. 15 maj 2018 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/arsyetimi-i-gjykates-se-apelit-per-lirimin-e-ish-rektorit-te-up-se-enver-hasani/>). (Qasur së fundi më 15 janar 2020).

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Ky rast, i cili kishte qenë edhe rast i shënjestruar për liberalizim të vizave, kishte shkuar në Gjykatën e Apelit sipas ankesave të PSRK-së dhe mbrojtësve së të akuzuarve, në janar 2018, ndërsa ishte zgjidhur nga Apeli më 2 maj 2018, që do të thotë, se Apeli i ishte dashur pak më shumë se tre muaj që të kryej këtë lëndë.

Mirëpo, ky aktgjykim i Apelit për sa i përket të dënuarve Veliu dhe Rakipi ishte anuluar nga Gjykata Supreme për shkak të shkeljeve që kishte konstatuar dhe lënda i ishte kthyer në rivendosje Apelit. Sipas Supremes, Apeli ishte dashur të mbaj seancë publike në këtë rast, që të akuzuarve tu jepet mundësia të elaborojnë ankesat e tyre para kolegjit të Apelit. Ndërsa, sa i përket Enver Hasanit, Supremja e kishte lënë në fuqi vendimin e Apelit.

Një udhëzim të tillë të Supremes e kishte zbatuar GjA, ashtu që më 16 prill 2019 kishte mbajtur seancë publike për këtë rast, por edhe pas rivendosjes, shkalla e dytë kishte vendosur njëjtë sikurse herën e parë, duke ju shqiptuar burgim efektiv, Velit dhe Rakipit.⁴¹

Seanca e parë kolegjit të Apelit në këtë rast e mbajtur më 2 maj 2018 dhe kishte qenë jo – publike.⁴²

Vendimi i Apelit në këtë rast kishte ardhur pas afërsisht gjashtë muaj e gjysmë pas shpalljes së aktgjykimit në shkallë të parë. Kurse, nga ngritja e aktakuzës në këtë rast e deri në aktgjykimin e plotfuqishëm të Apelit, për sa i përket Enver Hasanit kishin kaluar gjithsej 1,006 ditë, kurse deri te aktgjykimi i Apelit për Hakif Velin dhe Albert Rakipin, kjo kohë kishte qenë më e gjatë, përkatësisht, 1,355 ditë.

⁴¹ “Kontrata e UP-së, Apeli sërish i gjykon me burg efektiv dy të akuzuarit, Hakif Veliu dhe Albert Rakipi”. Betimi për Drejtësi. 29 maj 2019 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kontrata-e-up-se-apeli-serish-i-gjykon-me-burg-efektiv-dy-te-akuzuarit-hakif-veliu-dhe-albert-rakipi/>). (Qasur së fundi më 15 janar 2019).

4. Rasti i Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka etj.

Vepra penale: Konflikt i interesit

Kolegji i Apelit: Tonka Berishaj; Fillim Skoro; Hava Haliti

Të akuzuar: Valdrin Lluka; Eliana Naka

Vendimi i Apelit: Vërtetim i aktgjykimit lirues për Valdrin Llukën; anulim i aktgjykimit dënues – rigjykim, për Eliana Nakën

Prokuroria Themelore në Prishtinë, më 27 tetor 2016, kishte ngritur aktakuzë sipas cilës, Valdrin Lluka akuzohej se në cilësinë e zyrtarit të lartë në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), njëkohësisht edhe Kryeshef i Agjencisë për Promovim të Investimeve, më 23 mars 2014, kishte filluar procedurat për zotimin e mjeteve në vlerë prej 20 mijë euro për Organizatën Jo-Qeveritare (OJQ) “Jakov Innovation Center”, në të cilën OJQ kishte qenë themelues.

Ndërkaq, sipas aktakuzës, sekretarja e përgjithshme e MTI-së, Eliana Naka, me 2 qershor 2014, kishte marrë vendim që mjetet prej 20 mijë eurove, t’i ndahen si mbështetje financiare OJQ-së “Jakov Inovation Center”, ku kishte qenë drejtoreshë e Bordit.

Gjykata Themelore në Prishtinë, më 23 korrik 2018, e kishte shpallur të pafajshëm ish-zyrtarin e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI), aktualisht ministër në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, për veprën penale “konflikti i interesit”. Së bashku me Llukën, për konflikt të interesit, akuzohej edhe ish-sekretarja e përgjithshme e MTI-së, Eljana Naka, e cila nga shkalla e parë ishte shpallur fajtores dhe ishte dënuar me shtatë mijë euro gjobë.⁴³

Lënda kishte shkuar në Apel pas ankesës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë e cila kërkonte nga Apeli që lëndën ta kthej në rigjykim, si dhe pas ankesës së mbrojtjes së të akuzuarës Naka e cila kërkonte po ashtu rigjykim të rastit apo lirim nga akuza të Nakës.

Pretendimet ankimore të prokurorisë, Apeli i kishte vlerësuar si të pabazuara, kurse, ankesën e mbrojtjes së Nakës, gjykata e shkallës së dytë e kishte aprovuar si të bazuar.⁴⁴

⁴³ “Valdrin Lluka lirohet nga akuza për konflikt interesi”. Betimi për Drejtësi. 23 korrik 2018 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/valdrin-lluka-lirohet-nga-akuza-per-konflikt-interesi/>). (Qasur së fundi më 15 janar 2020).

⁴⁴ “Apeli e liron përfundimisht nga akuza për konflikt interesi ministrin Valdrin Lluka, e kthen në rigjykim rastin e ish-sekretares së MTI-së”. Betimi për Drejtësi. 20 dhjetor 2018 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-e-liron-perfundimisht-nga-akuza-per-konflikt-interesi-ministrin-valdrin-lluka-e-kthen-ne-rigjykim-rastin-e-ish-sekretares-se-mti-se/>). (Qasur së fundi më 15 janar 2020).

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Vendimi i Apelit në këtë rast kishte ardhur rreth dy muaj e gjysmë pas shpalljes së aktgjykimit të Themelores, kurse, seanca e kolegjit të Apelit kishte qenë jo publike. Edhe pas kthimit të rastit në rigjykim, Naka ishte dënuar njëjtë sikurse herën e parë.

Nga ngritja e aktakuzës në këtë rast e deri në aktgjykimin e plotfuqishëm të Apelit në këtë rast, kishin kaluar gjithsej 713 ditë apo 1 vit e 9 muaj.

5. Rasti i ish-kryetarit të Klinës, Sokol Bashota

Vepra penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”; “Mos raportim apo raportim të rremë të pasurisë, të ardhurave, dhuratave, apo dobisë tjetër materiale apo detyrimeve financiare”

Kolegji i Apelit: Xhevdet Abazi; Driton Muharremi; Abdullah Ahmeti

Të akuzuar: Sokol Bashota; Enver Berisha

Vendimi i Apelit: Anulim i aktgjykimit dënues të Gjykatës Themelore - Rigjykim

Aktakuza në këtë rast ishte ngritur nga Prokuroria Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), më 4 gusht 2016. Sipas kësaj aktakuze, Sokol Bashota, Enver Berisha, Esat Rraci dhe Fadil Gashi akuzoheshin për veprat penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, në bashkëkryerje. Bashota dhe Berisha akuzohen edhe për mos raportim apo raportim të rremë të pasurisë, të ardhurave, dhuratave, apo dobisë tjetër materiale apo detyrimeve financiare.

Gjykata Themelore në Pejë, ndaj Bashotës dhe Berishës. Rracit dhe Gashit kishte shpallur aktgjykim refuzues për veprën penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, pasi prokurorja e rastit, Sahide Gashi kishte hequr dorë nga ndjekja penale për këtë vepër penale.

Kurse, Bashota ishte dënuar me gjashtë muaj burgim me kusht dhe 1000 euro gjobë, pasi ishte shpallur fajtor për mos deklaram apo deklarim të rremë të pasurisë.

Mirëpo, dënimi me burgim ndaj tij nuk do të ekzekutohet nëse ai nuk kryen vepër tjetër penale brenda një viti, kurse dënimin me gjobë, detyrohet ta paguajë brenda 15 ditësh.

Edhe ish-nënkryetari i kësaj komune, Enver Berisha, ishte dënuar me gjashtë muaj burgim me kusht dhe 1000 euro gjobë.

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë në GjA kishte bërë prokuroria e cila kishte kërkuar dënime më të larta për të akuzuarit si dhe shqiptimin e dënimeve plotësuese, konkretisht, ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik. Ankesa në GjA kishin bërë edhe mbrojtësit e Bashotës dhe Gashit, të cili kishin kërkuar lirimin nga akuzat së të mbrojturve të tyre ose kthimin e rastit në rigjykim.

GjA, më 22 tetor 2019, kishte aprovuar ankesën e mbrojtësve së të akuzuarve dhe lëndën e kishte kthyer në rigjykim në shkallë të parë.

Gjykata e Apelit, kishte konsideruar se aktgjykimi i shkallës së parë, i shpallur është marrë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat kanë ndikuar në vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Aktakuza në këtë rast ishte ngritur në shkurt të vitit 2016 nga ana e PSRK-së, mirëpo e njëjta ishte përfaqësuar pastaj nga prokurorja e Prokurorisë Themelore në Pejë, Sahide Gashi.

Tre vjet pas ngritjes së aktakuzës, në maj 2019, prokurorja kishte hequr dorë nga ndjekja penale për sa i përket veprës penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare ndaj katër të akuzuarve në këtë rast me arsyetimin se nuk është vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer veprat penale me të cilat ngarkoheshin.

Kjo lëndë ishte kthyer në rivendosje fillimisht nga GjA gjatë fazës së konfirmimit të aktakuzës, kurse pasi që Themeloria më 19 prill 2018 kishte refuzuar si të pabazuara kërkesat për hudhje të aktakuzës, më 30 maj 2018 edhe GjA e kishte lënë në fuqi aktakuzën.

Pas kthimit të rastit në rigjykim, Gjykata Themelore në Pejë, e kishte transferuar këtë lëndë nga Departamenti i Krimeve të Rënda në Departamentin e Përgjithshëm.

Seanca e GjA për këtë rast kishte qenë jo-publike.

Nga ngritja e aktakuzës e deri në vendimin e Apelit, kishin kaluar 1,174 ditë, apo 3 vjet e 2 muaj.

6. Rasti i ish-kryetarit të Parteshit, Dragan Nikoliq

Vepra penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Kolegji i Apelit: Tonka Berishaj; Xhevdet Abazi; Fillim Skoro

Të akuzuar: Dragan Nikoliq

Vendimi i Apelit: Ndryshim i aktgjykimit dënues të Gjykatës Themelore – lirim nga akuza

Sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, të ngritur më 25 maj 2016, Dragan Nikoliq, akuzohej se më 10 shkurt 2015, në mënyrë të kundërligjshme, me vendimin 54/2015, ka ndërprerë marrëdhënien e punës të dëmtuarit Bozhidar Periq, në pozitën e asistentit administrativ të Kryetarit të Kuvendit Komunal në Partesh, vendim ky të cilën Inspektorati i Punës në rajonin e Gjilanit e abrogon dhe i njëjti vërtetohet edhe me vendim të shkallës së dytë të Inspektoratit të Punës, i cili kishte kërkuar kthimin në punë së të dëmtuarit dhe kompensimin e pagave të munguara. Në aktakuzë, thuhej se pasi është marr vendimi i Inspektoratit të Punës së Regjionit të Gjilanit që të kthehet në vend të punës i dëmtuari, dhe si kryetar komune Nikoliq nuk ka respektuar këtë vendim. E më pas trupi ekzekutiv i Inspektoratit ka gjobitur të njëjtin me gjobë prej 5,000 euro të cilën Nikoliq thuhet se nuk e ka paguar nga mjetet e tij personale, por ka urdhëruar Drejtorinë për Buxhet dhe Financa që inkasimi i gjobës të bëhet nga mjetet e buxhetit të komunës.

Lidhur me këtë akuzë, Gjykata Themelore në Gjilan më 18 tetor 2017, kishte marr aktgjykim dënues, ashtu që, Nikoliq ishte dënuar me gjashtë muaj burgim, i cili dënim nuk do të ekzekutohej nëse ai nuk kryen vepër tjetër penale brenda një viti.⁴⁵

Më 2 shkurt 2018, Gjykata e Apelit e kishte ndryshuar vendimin e shkallës së parë dhe e kishte liruar Nikoliqin nga akuzat.

Apeli kishte vlerësuar se në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar në shkallë të parë, nuk rezulton se në veprimet e të akuzuarit Nikoliq, përmbushen elementet e veprës penale në fjalë.

⁴⁵⁴⁵ “Apeli e liron nga akuza për korrupsion ish-kryetarin e Parteshit, Dragan Nikoliq”. Betimi për Drejtësi. 23 shkurt 2018 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-liron-nga-akuza-per-korrupsion-ish-kryetarin-e-parteshit-dragan-nikoliq/>). (Qasur së fundi më 15 janar 2020).

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Dragan Nikoliq, kishte qenë një ndër rastet e rralla ku një zyrtar i lartë publik dënohet për korrupsion. Megjithatë, ky dënim ndaj tij i shqiptuar nga shkalla e parë ishte shfuqizuar, pasi rreth tre muaj pas dënimit nga shkalla e parë, Apeli e kishte liruar të njëjtin nga akuza.

Aktgjykimi i Apelit ishte nxjerrë rreth tre muaj e gjysmë pas shpalljes së aktgjykimit në shkallë të parë. Kurse, nga ngritja e aktakuzës në këtë rast e deri në aktgjykimin e plotfuqishëm të Apelit, kishin kaluar gjithsej 618 ditë, apo 1 vjet e 7 muaj.

Seanca e GjA në këtë rast kishte qenë publike.

7. Rasti i ish-kryetarit të Gjykatës së Apelit, Salih Mekaj etj.

Vepra penale: Ushtrim i ndikimit, Shtytje në kryerjen e veprës penale “Ushtrimi i ndikimit”; Dhënia e ryshfetit në tentativë

Kolegji i Apelit: Mejreme Memaj; Driton Muharremi; Fillim Skoro

Të akuzuar: Salih Mekaj; Vlora Gorani; Mentor Seferaj; Ali Seferaj

Vendimi i Apelit: Vërtetim i aktgjykimit lirues të Gjykatës Themelore

Aktakuza në këtë rast ishte ngritur më 31 maj të vitit 2016. Sipas aktakuzës, i pandehuri Salih Mekaj, në cilësinë e personit zyrtar ka shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin e tij zyrtar, me qëllim të përfitimit të dobisë për vete dhe për persona të tjerë. Mekaj i ka premtuar të pandehurës Vlora Gorani se do të angazhohet për caktimin e shqyrtimit gjyqësor në dy raste, si dhe ricilësimin juridik të veprave penale, nga veprat penale më të rënda në ato më të lehta, në mënyrë që dy të pandehur në ato raste të lirohen nga paraburgimi. I pandehuri Mekaj me këtë qëllim ka kërkuar nga gjyqtarja e njërit rast në fjalë që ta caktojë shqyrtimin gjyqësor në atë lëndë, në kundërshtim me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës.

Më 28 maj 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë e kishte liruar nga akuzat Salih Mekajn dhe tre të akuzuarit tjerë në këtë rast.

Ankesë në Apel kundër vendimit të Themelores kishte ushtruar PSRK-ja, mirëpo, kjo ankesë ishte hudhur si e pabazuar nga ana e shkallës së dytë.

Konkretisht, rreth pesë muaj pasi që ishte shpallur i pafajshëm nga Gjykata Themelore në Prishtinë, Salih Mekaj si dhe të bashkakuzuarit e tij, Vlora Gorani dhe Mentor e Ali Seferaj, edhe Gjykata e Apelit, më 28 tetor 2018, kishte vërtetuar aktgjykimin lirues ndaj Mekaj dhe të tjerëve.⁴⁶

Sipas vendimit të Apelit, në aktgjykimin e shkallës së parë të atakuar nuk evidentohen shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë. Tutje, Apeli gjithashtu kishte vlerësuar se nuk ka pas shkelje as të ligjit penal.

⁴⁶ “Gjykata e Apelit vërteton pafajësinë e ish-kryetarit të saj, Salih Mekaj dhe tre të tjerëve”. Betimi për Drejtësi. 23 nëntor 2018 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-e-apelit-verteton-pafajesine-e-ish-kryetarit-te-saj-salih-mekaj-dhe-tre-te-tjereve/>). (Qasur së fundi më 15 janar 2020).

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Seanca në këtë rast kishte qenë jo publike, duke e vulosur kështu këtë rast, si një ndër rastet i cili ishte gjykuar në “terr” total për publikun pasi që edhe i gjithë gjykimi në shkallën e parë kishte qenë i mbyllur për publikun.

Nga ngritja e aktakuzës në këtë rast e deri në aktgjykimin e plotfuqishëm të Apelit, kishin kaluar 880 ditë, apo 2 vjet e 4 muaj.

Pas vendimit të Apelit, Prokurori i Shtetit kishte ushtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, e cila, më 5 qershor 2019, e kishte aprovuar si pjesërisht si të bazuar kërkesën e prokurorisë.

Sipas Supremes, aktgjykimet e Themelores dhe Apelit, për sa i përket Salih Mekajt, për veprën penale të ushtrimit të ndikimit, janë marrë me shkelje të ligjit penal, në favor të të pandehurit.

8. Rasti i ish-kryetarit të Komunës së Lipjanit, Shukri Buja

Vepra penale: Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar; Punët ndërtimore të kundërligjshme; Dhënia e ryshfetit; Marrja e ryshfetit; Ushtrimi i ndikimit

Kolegji i Apelit: Hashim Çollaku, Abdullah Ahmeti dhe Afrim Shala

Të akuzuar: Shukri Buja, Nebih Zeqiri, Halit Gashi, Magbule Sadiku, Fahri Retkoceri, Hasim Vishesella, Edmond Rehxhepi, Driton Avdiu, Burim Kodra, Bajram Rizani

Vendimi i Apelit: Anulim i aktgjykimit të Gjykatës Themelore – Rigjykim

PSRK kishte ngritur aktakuzë në këtë rast më 13 shkurt 2017, sipas së cilës, Buja dhe tetë zyrtarë tjerë të Komunës së Lipjanit akuzoheshin për korrupsion, ndërsa, biznesmeni Fahri Retkoceri akuzohej edhe për punë ndërtimore të kundërligjshme.

Ky ishte një ndër rastet e rralla kur zyrtar të profilit të lartë dënohen me burg efektiv për vepra penale të korrupsionit, pasi në nëntor të vitit 2018 ish-kryetari i Komunës së Lipjanit, Shukri Buja ishte dënuar me tre vjet burg efektiv për keqpërdorim të pozitës zyrtare në vazhdimësi dhe në bashkëkryerje.

Për keqpërdorim të pozitës zyrtare, fajtorë ishin shpallur edhe të akuzuarit e tjerë në këtë rast, Nebih Zeqiri, i cili ishte dënuar me dy vjet e gjashtë muaj burgim, Halit Gashi me gjashtë muaj burgim, Edmond Rexhepi është dënuar me gjashtë muaj burgim, Bajram Rizani me gjashtë muaj burgim, kurse Hasim Vishesella ishte shpallur fajtor për marrje ryshfeti dhe ishte dënuar me pesë muaj burgim.

Ndërsa, ishin liruar nga akuza, Magbule Sadiku, Burim Kodra si dhe Driton Avdiu, kurse ndaj biznesmenit Fahri Retkoceri, aktgjykim lirues ishte marrë për veprën penale, “Punimet ndërtimore të kundërligjshme”, kurse aktgjykim refuzues për shkak të parashkrimit, ishte marrë për veprën penale të dhënies së ryshfetit.

Ankesë kundër këtij vendimi në shkallën e dytë, kishin bërë PSRK dhe mbrojtësit e të dënuarve, me ç’rast, më 12 qershor 2019, Gjykata e Apelit kishte vendosur që të aprovojë ankesat ashtu që kishte anuluar aktgjykimin e shkallës së parë dhe lëndën e kishte kthyer në rigjykim.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Kthimin e rastit në rigjykim, Apeli e kishte arsyetuar në një faqe e gjysmë nga gjashtë faqe sa kishte në total vendimi i saj e ku thuhej se shkalla e parë, për të njëjtën gjendje faktike dhe periudhe kohore kishte shqiptuar dënime për disa pika të akuzës kurse për disa tjera i kishte liruar të akuzuarit apo kishte nxjerrë aktgjykim refuzues.

Po ashtu, sipas Apelit, shkalla e parë nuk kishte specifikuar as vlerën e dëmit të shkaktuar apo se kujt i ishte shkaktuar ky dëm, siç nuk ishte vërtetuar, sipas Apelit, edhe elementi i dashjes tek të akuzuarit.

Në rigjykim, shkalla e dytë i ka rekomanduar shkallës së parë që të vërtetojë dëmin e shkaktuar nga ana e të akuzuarve apo përfitimin nga veprat penale, si dhe të vendos lidhur me pretendimet për arritjen e afatit të parashkrimit të veprave penale.

Seanca në Apel në këtë rast kishte qenë publike, ndërsa nga ngritja e aktakuzës e deri në vendimin e Apelit sipas të cilit rasti ishte kthyer në rigjykim kishin kaluar 729 ditë apo 1 vit e 9 muaj.

9. Rasti i ish-kryetarit të Komunës së Dragashit, Salim Jenuzi

Vepra penale: Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar; Uzurpim i pronës së paluajtshme

Kolegji i Apelit: Mejreme Memaj; Driton Muharremi; Xhevdet Abazi

Të akuzuar: Salim Jenuzi; Nexhat Selaj; Bean Haxhihasani; Vetim Hasani

Vendimi i Apelit: Anulim i aktgjykimit dënues të Gjykatës Themelore – rigjykim për Jenuzin dhe Selajn, vërtetim i aktgjykimit lirues të shkallës së parë për Haxhihasanin dhe Hasanin.

Prokuroria Themelore në Prizren me aktakuzën e ngritur më 10 gusht 2016, pretendonte se Salim Jenuzi, duke qenë kryetar i Komunës së Dragashit, në periudhën 2009-2016, i ka mundësuar Nexhat Selajt, përvetësimin e pronës komunale, të cilën ky e kishte uzurpuar paraprakisht.

Ndërsa, Nexhat Selaj akuzohej se gjatë periudhës 2009-2016, ka uzurpuar në mënyrë të paligjshme pronën komunale të Komunës së Dragashit, në të cilën ka ndërtuar objekt afarist me karakter të përhershëm, megjithëse kishte leje për shfrytëzim të përkohshëm.

Gjykata Themelore në Prizren, më 21 nëntor 2017, ish-kryetarin e Dragashit, Salim Jenuzi e kishte shpallur fajtor dhe dënuar me një vit burgim me kusht për korrupsion. Kurse, i akuzuari tjetër, Nexhat Selaj ishte dënuar me gjashtë muaj burgim me kusht për uzurpim të paligjshëm së pronës.

Ndërsa, të akuzuarit Bean Haxhihasani dhe Vetim Hasani, ishin liruar nga akuza për keqpërdorim të pozitës zyrtare, me arsye se nuk është vërtetuar gjendja faktike, sipas aktakuzës.

Pas ankesave të palëve, gjykata e shkallës së dytë, më 25 janar 2018, kishte vendosur që të anulojë aktgjykimin e Themelores për sa i përket Jenuzit dhe të akuzuarit tjetër në këtë Nexhat Selajt, me arsyetimin se ka shkelje esenciale të procedurës penale. Në aktgjykimin e Apelit thuhej se gjykata e shkallës së parë nuk ka arritur të arsyetojë vendimet për dënimin e të akuzuarve Jenuzi dhe Selaj, duke mos treguar saktësisht veprimet e secilit me qëllim të kryerjes së veprës penale për të cilën akuzohen.

Ky rigjykim kishte rezultuar shumë i frytshëm për Jenuzin, pasi që pas kthimit të rastit në rigjykim dhe mbajtjes së disa seancave gjyqësore, Gjykata Themelore në Prizren kishte shpallur aktgjykim refuzues ndaj ish-kryetarit të Dragashit, Salim Jenuzi, pasi që paraprakisht, prokuroria ishte tërhequr nga akuzat me arsyetimin se vepra penale është parashkruar kurse Nexhat Selaj ishte shpallur i pafajshëm për uzurpim të pronës së paluajtshme.⁴⁷

⁴⁷ “Aktgjykim refuzues ndaj ish-kryetarit të Dragashit, shpallet i pafajshëm i akuzuar për uzurpim prone”. Betimi për Drejtësi. 9 tetor 2018 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/aktgjykim-refuzues-ndaj-ish-kryetarit-te-dragashit-shpallet-i-pafajshem-i-akuzuari-per-uzurpim-prone/>). (Qasur së fundi më 15 janar 2020).

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Vonesa në procedimin e këtij rasti, ka bërë që një zyrtar i lartë publik, i akuzuar për korrupsion, të shpëton pa u gjykuar. Kështu, pasi që ish-kryetari i Dragashit ishte shpallur fajtor për korrupsion, kthimi i rastit në rigjykim kishte bërë pastaj që të njëjtit t'i parashkruhet vepra penale gjë që kishte detyruar prokurorinë të tërhiqet nga akuza ndaj Jenuzit dhe ndaj këtij të fundit, gjykata të mos arrij ta thotë fjalën e fundit, lidhur me fajësinë apo pafajësinë e tij.

Seanca e Apelit në këtë rast kishte qenë jo publike. Nga ngritja e aktakuzës e deri në vendimin e Apelit që e kishte kthyer rastin në rigjykim, kishin kaluar, 533 ditë apo 1.5 muaj.

10. Rasti i ish-kryetarit të Gjykatës Komunale të Prishtinës, Nuhi Uka etj.

Vepra penale: Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar; Mashtrimi; Krimi i organizuar; Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore; Legalizimi i përmbajtjes së falsifikuar; Uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme

Kolegji i Apelit: Fillim Skoro; Abdullah Ahmeti; Xhevdet Abazi

Të akuzuar: Nuhi Uka; Sanije Muqolli; Fehmi Havolli; Mirafete Hashani-Bislimi; Kadrije Hashani; Kimete Hashani-Ukaj; Hilmije Miftari; Ibadete Hashani-Cakaj

Vendimi i Apelit: Vërtetim i aktgjykimit të Gjykatës Themelore

Sipas aktakuzës së ngritur në janar 2014, të akuzuarit në këtë rast kanë përbërë një grup të organizuar kriminal, në krye së të cilit ka qenë Nuhi Uka, ish-kryetari i Gjykatës Komunale në Prishtinë. Nuhi Uka, akuzohej se kishte shfrytëzuar ndikimin e tij në ish-Gjykatën Komunale në Prishtinë, ku ishte kryetar, për t'i mundësuar mikut të tij, përvetësimin e paligjshëm të një pronë në Prishtinë. Tutje, akuzohej se kishte përdorur familjarët e gruas, për të kaluar pronësinë në emër të djalit të tij.

Ish-kryetari i Gjykatës Komunale në Prishtinë, Nuhi Uka, ish-gjyqtarja Sanije Muqolli dhe eksperti i gjeodezisë në Drejtorinë e Kadastrit të Prishtinës, Fehmi Havolli, më 21 tetor 2016, ishin shpallur të pafajshëm nga Gjykata Themelore në Prizren.

Ndërkaq, për pesë të akuzuarat Mirafete Hashani-Bislimi, Kadrije Hashani, Kimete Hashani-Ukaj, Hilmije Miftari dhe Ibadete Hashani-Cakaj, gjykata kishte shpallur aktgjykim dënues.

Kadrije Hashani dhe Kimete Hashani-Ukaj ishin dënuar me nga dy vjet burgim me kusht, ndërsa Mirafete Hashani-Bislimi, Hilmije Miftari dhe Ibadete Hashani-Cakaj ishin dënuar me nga një vit e 10 muaj burgim me kusht.

Gjykata e Apelit, më 16 prill 2018, kishte vendosur që të refuzojë ankesat e palëve në këtë rast, kurse aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren e kishte vërtetuar si të bazuar.⁴⁸

Sipas aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, kjo gjykatë kishte refuzuar si të pabazuara ankesat e ushtruara nga Prokuroria Speciale, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, si dhe ankesat e ushtruara nga mbrojtësit e të akuzuarve me pretendimin se aktgjykimi i shkallës së parë përmbante shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkelje së ligjit penal, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që ankesa të aprovohet dhe aktgjykimi i

⁴⁸ “Apeli vërteton aktgjykimin ndaj Nuhi Ukës dhe të tjerëve të akuzuar për krim të organizuar dhe korrupsion”. Betimi për Drejtësi 18 prill 2018 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-aktgjykimin-ndaj-nuhi-ukes-dhe-te-tjereve-te-akuzuar-per-krim-te-organizuar-dhe-korrupsion/>). (Qasur së fundi më 15 janar 2020).

shkallës së parë të anulohet, çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Aktgjykimi i Apelit në këtë rast kishte ardhur një vit e gjysmë pas shpalljes së aktgjykimit nga Gjykata Themelore në Prizren. Kurse, nga ngritja e aktakuzës në këtë rast e deri në aktgjykimin e plotfuqishëm të GjA-së, kishin kaluar gjithsej 2,089 ditë, apo 5 vjet e 7 muaj.

11. Rasti i ish-kryetarit të Komunës së Klllokotit, Sasha Mirkoviq

Vepra penale: Mashtrimi në detyrë

Kolegji i Apelit: Fillim Skoro; Tonka Berishaj; Have Haliti

Të akuzuar: Sasha Mirkoviq

Vendimi i Apelit: Vërtetim i aktgjykimit lirues të Gjykatës Themelore

Ish-kryetari i Klllokotit, Sasha Mirkoviq, akuzohej se pa shpalljen e tenderit për sigurimin e projektit kryesor për asfaltimin e rrugës Verboc-Mogillë-Ura e Dilit dhe pa pasur kontratë të nënshkruar me nëpërmes kompanisë “Zuka Commerce”, e cila e ka fituar tenderin për të kryer punimet e rrugës, në emër të hartimit të projektit nga firma “Roni-Ing”, ka urdhëruar shërbimin e pagesave të komunës që të paguaj për shumën prej 22,781.11 euro.

Sipas aktakuzës, Sasha Mirkoviq, më 30 gusht 2010 duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar, si kryetar i Komunës së Klllokotit, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, apo personin tjetër, ka kryer veprën penale të mashtrimit në detyrë.

Gjykata Themelore në Gjilan, më 26 prill 2018, Sasha Mirkoviqin e kishte liruar nga akuzat në mungesë të provave.

Gjykata e shkallës së dytë, me aktgjykimin e nxjerrë më 22 nëntor 2018, kishte refuzuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan, të ushtruar kundër aktgjykimit të shkallës së parë duke vërtetuar kështu aktgjykimin lirues për Mirkoviqin.

Siç thuhej në aktgjykimin e Apelit, duke pasur parasysh përkufizimin e veprës penale, fakteve të vërtetuara nga gjykata e shkallës së parë, rezulton se me asnjë provë konkrete nuk janë vërtetuar elementet e veprës penale që të akuzuarit i vihet në barrë sipas aktakuzës, sepse, sipas Apelit, nuk është vërtetuar elementi qenësor i kësaj vepre penale që i akuzuari ka bërë prezantim të rremë apo në ndonjë mënyrë tjetër të ketë vënë në lajthim personin e autorizuar për kryerjen e pagesës me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm për vetë apo për tjetrin.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Aktgjykimi i Apelit në këtë rast ishte marr shtatë muaj pas shpalljes së aktgjykimit në shkallën e parë. Seanca e kolegjit të Apelit kishte qenë jo publike. Nga ngritja e aktakuzës në këtë rast e deri në aktgjykimin e plotfuqishëm të Apelit, kishin kaluar gjithsej 757 ditë apo rreth 2 vjet.

12. Rasti i ish-kryetarit të Komunës së Obiliqit, Mehmet Krasniqi etj.

Vepra penale: Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar; Mashtrim në detyrë; Mashtrim

Kolegji i Apelit: Mejreme Memaj; Driton Muharremi; Afrim Shala

Të akuzuar: Mehmet Krasniqi; Xhavit Krasniqi; Haki Raqi; Nazmi Gashi; Ramdan Hashani; Bajram Paloji; Azem Spanca; Altin Preniqi; Hasnije Dushi; Emir Sopjani; Sami Kadriu; Bujar Alidema; Shpend Kelmendi; Basri Kqiku

Vendimi i Apelit: Vërtetim i aktgjykimit të Gjykatës Themelore

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK), kishte ngritur aktakuzë për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar, më 8 maj 2015 kundër Mehmet Krasniqit, Xhavit Krasniqit, Haki Raqit, Emir Sopjanit, Sami Kadriut, Nazmi Gashit, Ramadan Hashanit, Bajram Palojit, Bujar Alidemës, Shpend Kelmendit, Basri Kqikut, Hasie Dushit, Azem Spancës dhe Altin Preniqit.

Veprat penale për të cilat akuzohej, Mehmet Krasniqi dhe 12 personat tjerë, pretendohej se janë kryer gjatë periudhës kohore 2012-2013, përkatësisht gjatë realizimit të projektit për asfaltimin e disa rrugëve në Komunën e Obiliqit, në të cilën kohë kryetar ishte pikërisht Krasniqi.

Gjykata Themelore në Prishtinë, më 19 maj 2017, në mungesë të provave kishte liruar nga akuza për keqpërdorim të pozitës zyrtare, ish-kryetarin e Komunës së Obiliqit, Mehmet Krasniqi dhe zyrtarët e komunës në fjalë, Xhavit Krasniqi, Haki Raqi, Nazmi Gashi, Ramadan Hashanin, Bajram Palojin, Azem Spancën dhe Altin Preniqin. Ndërsa, Hasnije Dushi ishte liruar nga akuza për mashtrim në detyrë.

Ndërkaq, ndaj të akuzuarve për mashtrim, Emir Sopjanit dhe Sami Kadriut, gjykata kishte shpall aktgjykim dënues, duke iu kishte shqiptuar dënimin me nga një vit e gjashtë muaj burgim me kusht. Bujar Alidema dhe Shpend Kelmendi ishin dënuar me nga dy vjet burgim me kusht dhe 4,000 euro gjobë kurse Basri Kqiku ishte dënuar me një vit burgim me kusht dhe 3,000 euro gjobë.

Në këtë rast, Gjykata e Apelit, më 26 mars 2018, pak pa u bërë një vit nga shpallja e aktgjykimit në shkallën e parë, kishte vërtetuar aktgjykimin e shkallë së parë.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, lidhur me këtë rast, kishte paraqitur Prokurori i Shtetit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, duke i propozuar Gjykatës Supreme që të konstaton se aktgjykimet në fjalë ishin marr me shkelje.

Gjykata Supreme në aktgjykimin e marr më 21 janar 2019, kishte konstatuar se aktgjykimet e Gjykatës Themelore në Prishtinë i 19 majit 2017, si dhe aktgjykimi i Apelit 19 prillit 2018, për këtë rast ishin marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, në favor të të pandehurëve.

Ndryshe, seanca e GjA për këtë rast kishte qenë jo-publike. Nga ngritja e aktakuzës në këtë rast e deri në aktgjykimin e plotfuqishëm të Apelit, kishin kaluar gjithsej 1,053 ditë apo rreth 2 vjet e 8 muaj.

13. Rasti i ish-kryetarit të OSHP-së, Hysni Hoxha etj.

Vepra penale: Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar; Falsifikim i dokumenteve

Kolegji i Apelit: Tonka Berishaj; Driton Muharremi; Hava Haliti

Të akuzuar: Hysni Hoxha; Hysni Muhadri; Arsim Robelli

Vendimi i Apelit: Vërtetim i aktgjykimit lirues të Gjykatës Themelore

Aktakuza e Prokurorisë Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) e ngarkonte Hysni Hoxhën dhe Hysni Muhadrin për kryerje në bashkëpunim të veprës penale “keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”. Sipas aktakuzës, këtë vepër të pandehurit e lartcekur e kishin kryer në qershor të vitit 2013, Hoxha në cilësi të kryetarit të OSHP-së dhe njëherësh kryetar i Panelit Shqyrtues të Prokurimit, ndërkaq Muhadri në cilësi të ekspertit shqyrtues të OSHP-së. Sipas dispozitivit të parë, dy të pandehurit, me dashje direkte i tejkalojnë kompetencat e tyre, pasi kompanisë së ndërtimit “Conex Group” me pronar Veton Fetahun, i sjellin dobi materiale në shumë prej 1,799,759,54 euro. Në anën tjetër, aktakuza e ngarkonte edhe Arsim Robellin, në cilësinë kontabilistit të jashtëm të kësaj kompanie i cili akuzohej se në bashkëkryerje ka falsifikuar dokumente.

Gjykata Themelore në Prishtinë, më 27 nëntor 2017 i kishte liruar nga akuzat, Hoxhën, Muhadrin dhe Robellin.

Pesë muaj pasi që ishte shpallur i pafajshëm për akuzat për korrupsion nga shkalla e parë, ish-kreut të OSHP-së, Hysni Hoxhës i ishte vërtetuar aktgjykimi lirues edhe nga Apeli. Njëjtë si Hoxhës, aktgjykimin lirues të shkallë së parë, Apeli e kishte vërtetuar edhe për dy të akuzuarit tjerë në këtë rast, Hysni Muhadrin dhe Arsim Robellin.⁴⁹

Ky vendim, sipas Apelit, ishte marrë pasi që gjykata e shkalles se parë kishte konstatuar, se më provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor, nuk është vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilat janë akuzuar dhe me këtë konstatim të Themelores e kishte përkrahur edhe Apeli.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Nga ngritja e aktakuzës në këtë rast e deri në aktgjykimin e plotfuqishëm të Apelit, kishin kaluar gjithsej 1,220 ditë apo rreth 3 vjet e 3 muaj.

Seanca e GjA në këtë rast kishte qenë jo-publike

⁴⁹“Apeli vërteton pafajësinë e ish-kreut të OSHP-së, Hysni Hoxha dhe dy të tjerëve”. Betimi për Drejtësi. 23 prill 2018 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-pafajesine-e-ish-kreut-te-oshp-se-hysni-hoxha-dhe-dy-te-tjereve/>). (Qasur së fundi më 15 janar 2020).

14. Rasti i ish-deputetit të Kuvendit të Kosovës, Etem Arifi etj.

Vepra penale: “Mashttrim me subvencione”; “Ushtrim ndikimi”

Kolegji i Apelit: 1. Hava Haliti; Mejreme Memaj; Afrim Shala (Gjykimi i parë)

2. Abdullah Ahmeti; Vaton Durguti; Xhevdet Abazi (Gjykimi i dytë)

Të akuzuar: Etem Arifi; Bajram Gashi

Vendimi i Apelit: Ashpërsim i dënimeve për veprën penale “Mashttrim me subvencione”; Rigjykim për të akuzuarin Arifi për veprën penale, “Ushtrimi i ndikimit”

Prokuroria Themelore në Prishtinë e akuzonte deputetin Etem Arifi se kishte shfrytëzuar pozitën e tij të deputetit për të ndikuar për dhënien e subvencioneve për OJQ-në “Zëri i Ashkalinjëve për Integrim”, duke siguruar në këtë mënyre shumën prej 25,646.00 euro.

Këto para, sipas prokurorisë, nuk janë përdorur për qëllime për të cilat janë dhënë, por janë përvetësuar nga Arifi dhe Gashi për persona të tjerë.

Gjykata Themelore në Prishtinë, më 20 prill 2018, e kishte dënuar me dy vjet burgim me kusht, ish-deputetin e Kuvendit të Kosovës nga radhët e Partisë së Ashkalinjëve për Integrim, Etem Arifi, pasi e kishte shpallur fajtor për veprën penale të mashttrimit me subvencione. Me dy vjet burgim me kusht, për të njëjtën vepër penale ishte dënuar edhe i akuzuari tjetër në këtë rast, Bajram Gashi.

Por, dënimi ndaj tyre, nuk do të ekzekutohej nëse ata nuk kryejnë vepra penale brenda periudhës tre vjeçare.

Etem Arifi, për ushtrim të ndikimit ishte liruar nga akuza, pasi sipas shkallës së parë, nuk është provuar se i njëjti ka kryer këtë vepër penale.

Të akuzuarit ishin obliguar që Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) t’ia kompensojnë shumën prej 22,900 euro si dhe Zyrës për Komunitete në Kryeministri shumën prej 2,749 euro.

Këtë aktgjykim të Themelores, e kishte ndryshuar shkalla e dytë pasi që kishte aprovuar si të bazuar ankesën e organit të akuzës. Gjykata e Apelit, më 28 mars 2019, ia kishte ashpërsuar dënimin Arifit, për veprën penale të mashttrimit me subvencione, duke e dënuar me një vit e tre muaj burgim efektiv.

Po ashtu, shkalla e dytë ia kishte ashpërsuar dënimin edhe të akuzuarit tjetër në këtë rast, Bajram Gashi, duke e gjykuar të njëjtin me një vit burgim efektiv, për dallim nga shkalla e parë e cila e kishte dënuar Gashin me dy vjet burg me kusht për veprën penale të mashttrimit me subvencione.

Gjykata e shkallës së dytë, i kishte obliguar që të dy të akuzuarit, që t'ia kompensojnë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), në emër të dëmit të shkaktuar shumë prej 22,900 euro kurse Zyrës së Kryeministrit, shumë prej 2,749 euro.

Gjithashtu, Apeli e kishte anuluar aktgjykimin e Themelores për sa i përket veprës penale të ushtrimit të ndikimit për çka deputeti Arifi ishte liruar nga akuzat nga shkalla e parë, duke e kthyer çështjen në rigjykim.

Mirëpo, këtë aktgjykim të Apelit e kishte anuluar Gjykata Supreme më 20 qershor 2019, me arsyetimin se e njëjta gjykatëse që kishte vendosur lidhur me ankesat në fazën e konfirmimit të aktakuzës, kishte marr pjesë edhe në kolegjin që e kishte nxjerr aktgjykimin në këtë lëndë.

Pas kthimit në rivendosje në GjA, një kolegji tashmë i ri i Apelit, kishte vendosur në mënyrë identike sikurse herën e parë, ashtu që, deputetit Arifi ia kishte rritur dënimin në 1 vjet e 3 muaj burg për mashtrim me subvencione kurse e kishte kthyer në rigjykim në shkallë të parë për ushtrim të ndikimit. Edhe sa i përket të akuzuarit Gashi, vendimi i GjA-së kishte qenë i njëjtë sikurse herën e parë.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Ashpërsimi i dënimit e aq më shumë, dënim me burg efektiv ndaj një zyrtari të lartë publik, në këtë rast deputet, siç kishte vepruar Apeli në rastin e Etem Arifit, është një rast thuajse i paparë më herët nga kjo gjykatë. Në këtë rast, dënimi me burg efektiv ndaj Arifit ka të bëjë me veprën penale të mashtrimit me subvencione, kurse, për veprën penale të ushtrimit të ndikimit, e cila vepër hyn në kuadër të veprave penale kundër detyrës zyrtare, Arifi do të rigjykohej.

Dy vendimet që GjA ka marr në këtë rast, ai i 28 marsit 2019 dhe 20 gushtit 2019, janë identike me njëri tjetrin, përkundër se janë marrë nga dy kolegje të ndryshme. Në këtë rast, një gabim procedural që ishte bërë nga ana e GjA-së, kur kishte vendosur në herën e parë, ka bërë që në këtë rast, aktgjykimi i plotfuqishëm të zvarritet për rreth 6 muaj.

Seanca e 28 marsit 2019, kishte qenë jo publike, kurse ajo e 20 gushtit, kishte qenë publike.

Nga ngritja e aktakuzës e deri në aktgjykimin e fundit të Apelit, kishin kaluar gjithsej 985 ditë, apo 2 vjet e 8 muaj.

9. Rastet tjera të profilit jo të lartë

9.1 Vërtetim i aktgjytimeve liruese

Nga rastet tjera të monitoruara nga IKD, e ku nuk përfshihen persona të profilit të lartë, IKD ka gjetur se Gjykata e Apelit, më 10 dhjetor të vitit të 2018, kishte vërtetuar pafajësinë e prokurorit **Bajram Hamitaga**, i cili akuzohej se kishte keqpërdorur pozitën e tij zyrtare dhe shoferit të tij, **Luan Delilit**, që akuzohej për veprën penale “frikësim gjatë procedurës penale”,

Shkalla e dytë kishte refuzuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan, të ushtruar kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, e cila më 11 qershor 2018, i kishte liruar nga akuzat me të cilat ngarkoheshin, të akuzuarit Hamitaga dhe Delili, me arsyetimin se nuk kishte prova të mjaftueshme se të akuzuarit kanë kryer veprat penale me të cilat ngarkoheshin.

Në raste tjera, Gjykata e Apelit gjatë vitit 2018, kishte vërtetuar aktgjykimin lirues edhe ndaj ish-drejtorit për Arsim në Komunën e Prizrenit, **Nexhat Çoçaj** dhe drejtorin e gjimnazit “Gjon Buzuku” në Prizren, **Shaip Buduri**. Në këtë rast, ishte vërtetuar aktgjykimi lirues i Gjykatës Themelore në Prizren i marrë më 27 shkurt të vitit 2017.

Gjykata e Apelit, gjatë vitit 2019, i kishte liruar përfundimisht nga akuzat për korrupsion edhe dy zyrtarët e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), **Tefik Sylejmani dhe Ekrem Salihu**, pastaj ish-drejtorin e Pallatit të Rinisë, **Bajram Uka**, i cili akuzohej për keqpërdorim të pozitës zyrtare, inspektoren e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), **Violeta Januzi** dhe udhëheqësen e Zyrës së Prokurimit në Spitalin Rajonal “Dr.Sami Haxhibeqiri”, në Mitrovicë, **Zylfije Halilin**.

Në të gjitha këto raste, GjA i kishte refuzuar ankesat e prokurorisë dhe i kishte vërtetuar aktgjykimet liruese të shkallës së parë.

Po ashtu, gjatë kësaj periudhe, Apeli kishte vërtetuar aktgjykimet liruese edhe për drejtoreshën e Arsimit në Komunën e Parteshit, **Vesna Jovanoviq**, e cila akuzohej për keqpërdorim të detyrës zyrtare, zyrtarit në zyrën për patentë shofer në Mitrovicë **Afrim Geci**, i cili akuzohej për marrje ryshfeti, ish-drejtoreshën e Barnatores Qendrore në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), **Enkelejda Gjonbalaj** dhe zëvendëskomandantit të zjarrfikësve në Komunën e Vitisë, **Naser Abazi**, të cilët gjithashtu akuzoheshin për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar.

Apeli kishte vërtetuar edhe aktgjykimet liruese ndaj tre zyrtarëve të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, **Berat Nika, Krenar Macula dhe Nehat Veliu** të cilët akuzoheshin për keqpërdorim të pozitës zyrtare si dhe biznesmenit **Xhelal Selimi**, i cili akuzohej për “mashttrim me subvencione.

Gjithashtu, Apeli gjatë kësaj periudhe kishte vërtetuar aktgjykimet liruese edhe në rastin mjekut të akuzuar për marrje ryshfeti, **Orhan Gafurri**, dy zyrtarëve të Ujësjellësit Rajonal në Mitrovicë, **Muja Istrefi dhe Hazir Bala**, që akuzoheshin për përvetësim në detyrë, ish-menaxherit të institucionit mikro-financiar “Lesna” në Gjilan, **Abdyl Brestovci**, që akuzohej për keqpërdorim të pozitës zyrtare, ish-drejtorit e shkollës ekonomike në Ferizaj, **Aziz Rexhepi** që akuzohej për përvetësim në detyrë, pastaj, Apeli kishte vërtetuar aktgjykimin lirues edhe ndaj tre zyrtarëve të Kompanisë Rajonale të Mbeturinave (KRM) “Eco-Higjiena” në Gjilan, **Selatin Rashiti**,

Leonora Ajeti dhe **Sabit Shabani** që akuzoheshin për keqpërdorim të pozitës zyrtare, zyrtarit të kompanisë “KEDS”, **Fidan Jashari**, i cili akuzohej për marrje ryshfeti, zëvendëskomandantin e Policisë në Dragash, **Eljam Seferi**, që akuzohej për keqpërdorim të pozitës zyrtare, inspektorit të Komunës së Gjakovës, **Genc Jetishi** i cili gjithashtu akuzohej për keqpërdorim të detyrës, ish-drejtorin e Inspektoratit në Prizren, **Bedri Bytyqi** si dhe inspektorin e ndërtimit në këtë komunë, **Bashkim Krasniqi** si dhe aktgjykimin lirues që shkalla e parë kishte marr ndaj **Abit Kastratit**, i akuzuar për veprën penale të përvetësimit në detyrë.

Apeli gjithashtu kishte vërtetuar aktgjykimin refuzues që Gjykata Themelore në Prishtinë kishte shpallur ndaj zyrtarit të Ferronikelit, **Nasuf Mjekqi**, pasi vepra për të cilën akuzohej ai, “marrja e ryshfeti”, kishte arritur parashkrimin absolut.

Gjykata e Apelit kishte refuzuar akuzat edhe ndaj ish-drejtorit të kompanisë “AgroKosova Holding”, **Habib Usaj**, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale, ashtu siç kishte vepruar edhe ndaj dy ish-zyrtarëve të Komunës së Podujevës, **Tahir Sahiti** dhe **Shefqet Maloku**, që akuzoheshin për keqpërdorim të pozitës zyrtare.

Gjatë vitit 2019, Gjykatës së Apelit i është dashur që në të paktën dy raste të korrupsionit të vendos për të tretën herë. Kështu, pasi kishin kaluar më shumë se 10 vjet nga koha kur prokuroria pretendonte se ish-anëtari i Bordit të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit “Hidrodrini”, në Pejë, **Elez Hajdaraj** kishte kryer veprën penale të përvetësimit në detyrë, Gjykata e Apelit, në gusht të 2019, kishte ardhur në përfundim se kjo vepër tashmë është parashkruar. Për këtë arsye, Apeli kishte vendosur që të refuzojë akuzën për këtë vepër ndaj Hajdarajt, kurse, shkalla e dytë e kishte refuzuar edhe ankesën e Prokurorisë Themelore në Pejë për sa i përket veprës tjetër penale që akuzohej Hajdaraj, atë të frikësimit gjatë procedurës penale duke e liruar kështu përfundimisht nga kjo akuzë të akuzuarin.

Në rastin e ish-zyrtarin e prokurimit në Kompaninë Rajonale të Mbeturinave (KRM) “Pastërtia” në Ferizaj, **Ilir Beqiri**, Gjykata e Apelit kishte vendosur për herë të tretë në janar të vitit 2019, sipas të cilit vendim Beqiri ishte liruar nga akuzat për keqpërdorim të pozitës zyrtare.

Beqiri ishte shpallur dy herë fajtor nga Gjykata Themelore në Ferizaj, mirëpo që të dy herët, lënda ishte kthyer në rigjykim, deri sa më 25 shtator 2018, shkalla e parë e kishte liruar në mungesë të provave Beqirin, vendim i cili ishte vërtetuar pastaj edhe nga Apeli.

9.2 Vërtetim i aktgjykimeve dënuese

Rastin e prokurores **Vahide Badivuku**, Gjykata e Apelit, në muajin maj të vitit 2018, për herë të tretë kishte vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, me të cilin, ish-prokurorja Vahide Badivuku ishte shpallur fajtorë për marrje ryshfeti dhe ishte dënuar me tre vjet burgim.

Apeli kishte refuzuar ankesat e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), e cila kishte kërkuar dënime më të ashpra për të akuzuarit, si dhe ankesat e mbrojtësve së të akuzuarve të cilët kishin kërkuar lirimin nga akuza apo kthimin e rastit në rigjykim.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, me këtë rast kishte ricilësuar veprimet e dy të akuzuarve tjerë të këtij rasti Idriz Kelmendi dhe Isak Smakolli nga “ushtrim ndikimi “ në “dhënie ryshfeti”. I pari

ishite dënuar me një vit burgim, ndërsa të dytit i ishte vërtetuar dënimi me gjobë prej tre mijë eurosh.

Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Apeli e kishte vërtetuar edhe dy herë më parë, në shtator 2016 dhe qershor 2017, mirëpo, në të dy këto raste, kishte qenë Gjykata Supreme ajo që e kishte kthyer rastin në rivendosje.

Gjykata Themelore në Prishtinë, në prill të vitit 2016, ish-prokuroren Vahide Badivuku e kishte shpallur fajtorë për veprën penale të marrjes së ryshfeti dhe për këtë vepër, i kishte shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej tre viteve si dhe ndalim të ushtrimit të profesionit po ashtu në kohëzgjatje prej tre vite.

Badivuku akuzohej se në mënyrë të tërthortë ka kërkuar dhe pranuar dhuratë për vete, në mënyrë që të veprojë në kundërshtim me detyrën zyrtare, në atë mënyrë që në bashkëpunim me të akuzuarin Idriz Kelmendi, duke vepruar si prokurore e çështjes penale PPI.nr.298/2014, kundër të pandehurve Esan, Hasan, Arton dhe Dritan Hasani, në shkëmbim të lirimit nga masa e paraburgimit dhe të të pandehurve Esan dhe Dritan Hasani, ka kërkuar dhe ka marr nga familja Hasani, shumën e të hollave prej 10.000 eurove, përmes të akuzuarit Idriz Kelmendi.

Në prill të vitit 2019, Gjykata e Apelit ua kishte vërtetuar dënimet e shqiptuara nga shkalla e parë edhe drejtorit të Spitalit Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë, **Ahmet Asllani Adnan Brovinës, Skender Ndrecajt, Mirlinda Mullahasani, Mentor Bytyqi dhe Kumrije Kameri** që akuzoheshin lidhur me një tender për furnizim me uniforma të këtij spitali.

Në qershor 2019, GjA e kishte vërtetuar edhe dënimin prej nëntë muaj burgim efektiv dhe 2000 euro gjobë, për ish-drejtorin e repartit të Urologjisë në QKUK, **Rexhep Kasumajn**.

Aktgjykimet dënuese, Apeli i kishte vërtetuar edhe ndaj zyrtarit të Policisë së Kosovës, **Xhevahir Xhimshiti**, i akuzuar për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar i cili ishte dënuar me 10 muaj burgim me kusht nga shkalla e parë, ish-menaxherit të Bankës për Biznes, dega në Kamenicë, **Agim Hoda**, i cili ishte shpallur fajtor nga Gjykata Themelore në Gjiilan për shkak të veprës penale “keqpërdorim i pozitës zyrtare”, dhe ishte dënuar me gjashtë muaj burgim efektiv, i cili dënim me kërkesë të mbrojtjes ishte shndërruar në dënim me gjobë prej 2000 eurosh, pastaj, zyrtarit të Policisë së Kosovës, **Kujtim Kryeziu**, i cili ishte dënuar me 4 mijë euro gjobë për “marrje të ryshfetit”, **Nazmi Rustemit**, i akuzuar se kishte marrë ryshfet në cilësi të rojtarit të pyllit në Agjencinë Pyjore të Kosovës, i cili ishte dënuar me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë muajsh nga shkalla e parë, dënim i cili me pajtimin e të akuzuarit, ishte shndërruar në dënim me gjobë prej 2.700 euro.

9.3 Ndryshim i aktgjykimeve

Përgjysmim të dënimeve kishin përfituar nga Gjykata e Apelit, dy grupe të zyrtarëve policor që ishin dënuar për korrupsion nga shkalla e parë.

Kështu, në maj 2019, 15 prej 20 zyrtarëve të Policisë së Kosovës, të dënuar për marrje ryshfeti nga Gjykata Themelore në Prizren, në janar të vitit 2018, u ishin zbutur dënimet nga Gjykata e Apelit.

Nga kjo zbritje e dënimeve kishin përfituar të akuzuarit, **Shemsi Demolli, Safet Veliu, Naser Rama, Ivica Djokiç, Ismail Azemi, Blerim Zylfaj, Bekim Zogaj, Qerim Beqiri, Azem Goxhufi, , Sasha Nedeljkovic, Shaban Gerguri, Lulzim Gashi, Shefki Zeka dhe Muhamet Buzhala dhe Alush Elshani.**

Kurse, gjykata e shkallës së dytë kishte vendosur që t'i refuzoj ankesat e ushtruara nga të akuzuarit **Ardian Rrecaj, Shemsi Zejnullahu, Aziz Krasniqi, Nuhi Zogaj dhe Afrim Rafuna.**

Në mars 2019, Gjykata e Apelit ua kishte përgjysmuar dënimet me gjobë edhe ish-zyrtarëve të Policisë së Kosovës, **Neshat Avdaj, Driton Bajrami, Myzafer Sylejmani dhe Binak Bytyqi,** të dënuar nga shkalla e parë për marrje ryshfeti.

Në prill 2019, duke vendosur në një lëndë të shënjestruar për viza, siç është rasti “Kohler”, GjA e kishte ndryshuar aktgjykimin dënues të shkallës së parë, duke e liruar të akuzuarin **Avni Alidemaj.** Ky i fundit, ishte dënuar me gjashtë muaj burg me kusht nga shkalla e parë. Për të akuzuarën tjetër, **Vjollca Ajvazi,** e cila po ashtu ishte dënuar me gjashtë muaj burgim me kusht, Apeli e kishte kthyer lëndën në rigjykim.

9.4 Kthimi i rasteve në rigjykim

Ndërsa, raste që i ka përcjellë IKD në këtë periudhë dhe të cilat ishin kthyer në rigjykim nga Apeli, gjatë kësaj periudhe përfshijnë rastin e ish-inspektorëve të Komunës së Prishtinës, që në prill të vitit 2018 ishin dënuar me afër 20 vjet burgim nga Gjykata Themelore në Prishtinë nën akuzat për korrupsion.

Lënda ndaj ish-inspektorëve në fjalë, **Ismet Haliti, Skënder Canolli, Blerina Sylja, Vehbi Abdullahu, Blerim Ibishi, Ardian Muhadri, Arbenita Ajeti, Mërgim Shala, Granit Cenaj, Drita Rukiqi** dhe biznesmenit **Qemail Pozhegu,** ishte kthyer në rigjykim për shkak se sipas Apelit, aktgjykimi i shkallës së parë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës

Në fillim të vitit 2019, Gjykata e Apelit e kishte kthyer në rigjykim edhe rastin e ish-gjykatëses së Gjykatës Themelore në Pejë, degë Deçan, **Safete Tolaj,** djalit të saj, **Fisnik Tolajt** dhe zyrtarit policor, **Granit Shehaj,** që akuzoheshin për korrupsion.

Në vendimin e Apelit thuhej se aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, për pjesën dënuese dhe liruese, për tre të akuzuarit, ku përfshihen veprat penale “ushtrimi i ndikimit në vazhdim”, “falsifikimi i dokumenteve”, “keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “marrja apo

asgjësimi i vulave zyrtare, apo shkresave zyrtare” dhe “ushtrimi i ndikimit në ndihmë”, është anuluar dhe çështja penale i kthehet gjykatës se shkalles së parë në rigjykim dhe vendim, pasi që, sipas Apelit, aktgjykimi është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave esenciale të procedurës penale.

Kurse, sipas vendimit të Apelit, sa i përket pjesës refuzuese që ka të bëjë vetëm me veprën penale “mbajtja ne pronësi ne kontrole apo posedim të pa autorizuar të armëve” për të akuzuarin Fisnik Tolaj, aktgjykimi është vërtetuar.

Ish-gjykatësja Tolaj, më 13 korrik të vitit 2018, ishte shpallur e pafajshme për të gjitha pikat e aktakuzës, me të cilat ngarkohej nga Gjykata Themelore në Ferizaj. I pafajshëm ishte shpallur edhe zyrtari policor, Granit Shehaj, i cili ngarkohej me veprën penale për ndihmë në ushtrimin e ndikimit.

Kurse, djali i saj, Fisnik Tolaj, ishte dënuar me dënim unik prej katër vjet e gjashtë muaj burgim, pasi ishte shpallur fajtor për dy vepra penale “ushtrim i ndikimit” dhe “falsifikim i dokumentit”.

Ky rast është i shënjestruar për liberalizimin e vizave.

Raste tjera që ishin kthyer në rigjykim nga Apeli, janë edhe rasti i ish-drejtoreshës së Inspeksionit në Komunën e Drenasit, **Hyrije Xhemajlaj-Thaqi** si dhe të ish-shefit të Inspeksionit, **Halil Vrellaku**, të cilët ishin shpallur fajtor për keqpërdorim të detyrës zyrtare, nga Gjykata Themelore në Prishtinë.

Po ashtu, në rigjykim nga GjA ishte kthyer edhe rasti i ish-zëvendësministrit të Administratës Publike, **Bujar Nerjovaj**. Ky i fundit ishte dënuar me 6 muaj burg me kusht nga Gjykata Themelore në Prizren, për shkak të veprës penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare. Akuza kishte me veprimet që Nerjovaj kishte bërë gjatë kohës sa kishte qenë Drejtor i Drejtorisë Komunale të Inspektorëve në Komunën e Prizrenit.

Apeli e kishte kthyer në rigjykim dy herë rastin e zyrtarit të Qeverisë të Republikës së Kosovës, **Zahir Bajrami**, i cili ishte dënuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë me një vit e gjashtë muaj burgim, për “keqpërdorim të detyrës zyrtare” dhe djali i tij, **Adrian Bajrami**, i cili gjithashtu nga shkalla e parë ishte shpallur fajtor për veprën penale “mashtrimi”, dhe ishte dënuar me një vit burgim me kusht. Ky rast ishte kthyer në rigjykim fillimisht në vitin 2018, ndërsa edhe pasi kishte shkuar në Apel për herën e dytë në vitin 2019, lënda ishte kthyer sërish në rigjykim për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale.

Në rigjykim ishte kthyer edhe rasti i policit **Hamdi Jashari**, i dënuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë me dënim unik prej një viti burgim dhe 500 euro gjobë, për “keqpërdorim të detyrës zyrtare”, rasti i dy zyrtarëve të Policisë së Kosovës, **Arben Shala dhe Tafa Murseli**, të dënuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë me nga gjashtë muaj burgim efektiv, për “keqpërdorim të detyrës zyrtare”, rasti i **Xhavit Bicajt**, ish-anëtar i komisionit vlerësues për përzgjedhjen e kandidatëve për pozitën e drejtorit të njësive përkatëse të Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, rastin ndaj zyrtarëve të Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, **Ilir Dushi dhe Bersan Kolgeci**, si dhe ndaj biznesmenit **Edon Hajrullaga**, rastin e ish-zyrtarit të

Komunës së Pejës, **Naser Kastrati**, i cili në maj të këtij viti ishte dënuar nga Gjykata Themelore në Pejë me një vit burgim efektiv, pasi ishte gjetur fajtor për keqpërdorim të pozitës zyrtare si dhe rastin e **Esat Fejzës**, i cili ishte shpallur fajtor për dy vepra penale, përvetësim gjatë ushtrimit të detyrës dhe mashtrim në detyrë dhe ishte dënuar me dënim unik, prek shtatë muaj burgim.

Edhe inspektori i komunikacionit në Komunën e Kamenicës, **Sadullah Dërmaku**, i cili ishte shpallur dy herë fajtor për korrupsion dhe ishte dënuar me burg efektiv, ja kishte parë “hajrin” Apelit. Kjo pasi që shkalla e dytë, që të dy vendimet e Themelores i kishte anuluar duke e kthyer lëndën në rigjykim. Dërmaku tashmë është duke u gjykuar për herën e tretë nga Gjykata Themelore në Gjiilan.

10. Trajtimi i rasteve të korrupsionit me rastin e konfirmimit/hudhjeve të aktakuzave

Punë me rastet e profilit të lartë dhe jo vetëm, Apeli kishte pasur edhe në fazën e konfirmimit të aktakuzës.

Në këto raste, Apelit i ishte dashur të vendos në lidhje me ankesat e palëve të cilat nuk ishin pajtuar me aktvendimet e gjykatave të shkallës së parë, për konfirmim apo hudhjen poshtë të aktakuzave të ngritura nga Prokurori i Shtetit.

Kështu, në maj të vitit 2018, Apeli kishte vërtetuar vendimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, me të cilin ishte hudhur poshtë aktakuza ndaj kryetarit të Komunës së Malishevës, **Ragip Begaj**, i cili akuzohej se ka keqpërdorur pozitën e tij zyrtare, kurse, në nëntor 2018, Apeli kishte vendosur të kthej në rivendosje rastin e ish-kryetarit të Gjakovës, **Pal Lekaj** dhe gjashtë të akuzuarve tjerë në këtë rast, të cilët akuzohen nga PSRK për korrupsion.

Në rastin e Lekajt, sipas vlerësimit të Apelit, gjykata e shkallës së parë nuk kishte dhënë arsye të mjaftueshme kur e kishte konfirmuar akuzën për veprën penale të keqpërdorimit të pozitës ndaj të akuzuarve dhe kishte refuzuar ankesat e mbrojtësve të tyre.

Herën e dytë kur kishte ardhur rasti i Pal Lekajt në Apel, kjo e fundit në mars 2019 e kishte konfirmuar aktakuzën ndaj ish-kryetarit të Komunës së Gjakovës.

Në shtator të 2018-ës, Apeli e kishte kthyer në rivendosje edhe rastin e ish-kryetarit të Komunës së Gjiilanit, **Qemajl Mustafa** dhe 38 të akuzuarve tjerë që akuzoheshin për “krim i organizuar”, “shpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar” si dhe “keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi”. Shkalla e parë, në muajin prill të këtij viti, e kishte konfirmuar pjesërisht aktakuzën në këtë rast, me ç’rast, kishte miratuar hudhjen e aktakuzës për veprën penale “krimi organizuar”, lidhur me veprat penale “keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi”, kundër të pandehurve Basri Kqiku, Avdil Pireva, Florim Zuka, Skender Imeri, Naser Mehmeti, Mejdi Ahmeti, Burim Govori, Rustem Hajdari, Asllan Asllani dhe Asllan Sylja.

Njëjtë sikurse te rasti i Pal Lekajt, edhe te rasti i ish-kryetari të Gjilanit, Qemajl Mustafa, Gjykata e Apelit në shkurt 2019, e kishte konfirmuar aktakuzën e PSRK-së, ashtu që tashmë gjykimi ndaj Mustafës dhe të tjerëve është në procedim e sipër në shkallë të parë.

Dy herë i ishte dashur të vendos Apelit edhe për një rast tjetër të korrupsionit ku përfshihet një ish-kryetar komune. Kështu, në shkurt të 2019, Apeli e kishte kthyer në rivendosje rastin e ish-kryetarit të Komunës së Drenasit, **Nexhat Demaku** i cili akuzohet për korrupsion, kurse, pasi që shkalla e parë kishte vendosur që sërish të vërtetohet aktakuzën e prokurorisë, njëjtë pastaj kishte vepruar edhe Apeli. Gjykimi ndaj Demakut tashmë është në zhvillim e sipër në shkallën e parë.

Apeli gjatë vitit 2019, i kishte konfirmuar edhe aktakuzën ndaj kryetarit të Komunës së Istogut, **Haki Rugova**, i cili po akuzohet për konflikt interesi, si dhe ish-kryetarit të Komunës së Suharekës, **Sali Asllanaj**.

Ndërsa, në dy raste tjera, Gjykata e Apelit gjatë vitit 2018 kishte vërtetuar aktakuzën e ngritur për arratisjen nga Qendra Klinike dhe Universitare e Kosovës, të ish-kryetarit të Komunës së Skenderajt, **Sami Lushtaku** dhe të tjerëve, ashtu siç kishte vërtetuar edhe aktakuzën në rastin e njohur si “Stenta”, ku i akuzuar është ish-ministri i Shëndetësisë, **Ferid Agani** dhe ish-sekretari i Ministrisë së Shëndetësisë, **Gani Shabani**.

Në rastin e ish-kryetarit të Komunës së Klinës, **Sokol Bashota**, Apelit i ishte dashur të vendosur dy herë në lidhje me ankesat kundër aktvendimit të Themelores.

Fillimisht, në shkurt 2018, Apeli kishte vendosur të kthej në rivendosje rastin e ish-kryetarit Bashota, pasi sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, aktvendimi i ankimor ishte përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Kurse, herën e dytë, në muajin maj 2018, Gjykata e Apelit e Kosovës e kishte lënë në fuqi aktvendimin e Gjykatës Themelore në Pejë, e cila më 19 prill 2018, kishte refuzuar si të pabazuara kërkesat për hudhje të aktakuzës, në rastin e ish-kryetarit të Klinës, Sokol Bashota, drejtorit të Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, Esat Raci dhe asamblistëve të kësaj komune, Enver Berisha e Fadil Gashi. Sipas Apelit, vendimi i shkallës së parë është i drejtë.

Në janar 2019, Gjykata e Apelit e kishte përmbysur vendimin e shkallës së parë e cila e kishte hudhur poshtë aktakuzën në rastin “Z-Mobile” ku ish-shefat e Telekomit, **Agron Mustafa**, **Rexhë Gjonbalaj** dhe **Ejup Qerimi** akuzoheshin për korrupsion. Gjykata e Apelit e kishte aprovuar ankesën e ushtruar nga ana e PSRK-së, pasi kishte vlerësuar se ka prova të mjaftueshme që kjo çështje të shkoj në gjykim ku do të vërtetohet pastaj fajësia apo pafajësia e të akuzuarve.

Pak më shumë se katër muaj pasi që Prokuroria Speciale kishte ngritur aktakuzë ndaj ish-drejtorit të Krimeve Ekonomike të Policisë së Kosovës, **Emin Beqiri**, Gjykata e Apelit, kishte vendosur që të hudhë poshtë këtë aktakuzë sa i përket Beqirit, kurse e kishte kthyer në rivendosje rastin për të akuzuarin tjetër në këtë rast, **Rrahim Hashimi**.

Mirëpo, nuk kishte shkuar edhe shumë, përkatësisht pas afër një muaji, Apeli kishte vendosur që të eliminojë komplet korrupsionin nga kjo lëndë që është edhe e shënjestruar për liberalizim të vizave, pasi që kishte pushuar procedurën penale për veprën penale të ushtrimit të ndikimit ndaj të akuzuarit Hashimi.

Ndryshe, Beqiri e Hashimi, pretendohet se u kishin marrë 100 mijë euro drejtuesve të organizatës Qendra për Avokim dhe Diplomaci (QAD), për t'ua mbyllur një rast.

Duke vendosur në lidhje me ankesat kundër vendimeve të shkallës së parë, lidhur me kërkesat për hudhje të aktakuzave, Apeli në periudhën monitoruese në fjalë, kishte vërtetuar hudhjen e aktakuzës së ngritur kundër zyrtarëve të Agjencisë Kosovare për Produkte dhe Pajisje Medicinale, **Ilir Dushi, Remzie Thaqi, Rifat Muriqi, Lendita Fetahu dhe Lindita Avdyli**, për veprën penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, hudhjen e aktakuzës ndaj zyrtarëve të institucionit miko-financiar “KosInvest”, **Avni Biqkaj dhe Astrit Metaj**, të akuzuar për keqpërdorim të pozitës zyrtare si dhe në rastin e ish-drejtorit të Inspektoratit në Komunën e Prizrenit, **Bujar Hasani** dhe dy inspektorëve të ndërtimit në këtë Komunë, **Enver Bytyqi e Flurim Islami**, të akuzuar për keqpërdorim të pozitës zyrtare.

Kurse, në rastet kundër ish-gjykatëses së Gjykatës Themelore në Pejë, dega në Deçan, **Safete Tolaj**, djalit të saj **Fisnik Tolaj** dhe zyrtarit policor **Granit Shehaj**, rastin e zyrtarëve policorë **Ahmet Hasani, Arton Bimbashi, Avdi Beqiri, Avni Mehmeti, Bojan Saviq, Esat Haxhiu, Halit Shabani, Jovica Trajković, Nazim Hamiti, Rushit Hoti, Sabit Hajdari, Sedat Haxhimehmeti dhe Zeki Shala**, si dhe në rastin e njohur si “Stenta 2”, Gjykata e Apelit kishte lënë në fuqi aktvendimet e gjykatave të shkallës së parë, të cilat kishin refuzuar kërkesat për hudhje të aktakuzës.

Kurse, në një rast tjetër, Gjykata e Apelit kishte aprovuar ankesën e Prokurorisë Themelore të Prishtinës, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, me të cilin ishte hedhur poshtë aktakuza ndaj **Durim Ramadanit dhe Zeqir Fetoshit**, pasi kishte vlerësuar se shkalla e parë kishte arritur në përfundim të gabuar lidhur me këtë rast, duke e udhëzuar të njëjtën se që të vazhdon gjykimin sipas dispozitave procedurale. Sipas Apelit, edhe ndaj të akuzuarit të tretë **Armend Selimi**, ndaj të cilit gjykata kishte refuzuar kërkesën për hudhje të aktakuzës, do të vazhdojë procedura gjyqësore në shkallë të parë.

Gjykata e Apelit, në nëntor 2019 e kishte konfirmuar aktakuzën edhe në rastin e njohur si “Stenta 3”, ku për korrupsion dhe vepra tjera penale po akuzohen, **Ali Hocaoglu, Mahmut Çakmak, Raif Çavolli, Borce Petrovski, Shpend Elezi, Blerim Zuna, Abdullah Tuna, Astrit Bakiqi, Driton Sylejmani, Arton Beqiri dhe Lulzim Brovina**. Kështu, pas plot tre viteve që kur ishte ngritur kjo aktakuzë, e njëjta ka marrë dritën e gjelbër për të filluar me shqyrtim gjyqësor.

11. Analizë e rasteve të përzgjedhura jo-korrupsion

Përveç rasteve të korrupsionit, në GjA gjatë vitit 2018 dhe 2019 janë shqyrtuar edhe raste të zëvendëskryeministrave, ministrave, deputetëve e ish-deputetëve që nuk kanë të bëjnë me vepra penale të korrupsioni.

Po ashtu, viti 2019 do të mbahet mend edhe për dy dënime me burgime të përjetshme të cilat i kishte shqiptuar Apeli, edhe që të dy këto dënime ishin anuluar pastaj nga Gjykata Supreme dhe lëndët janë në rigjykim në shkallë të parë.

1. Festa me armë e politikanëve

Të akuzuar: Dardan Gashi; Endrit Shala; Sami Lushtaku; Behar Amerllahu; Fadil Demiri dhe Sherif Krasniqi

Vepra penale: “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”

Vendimi i Apelit: Vërtetim i aktgjykimit dënues të Gjykatës Themelore

Festa me armë, për lirimin nga akuzat për korrupsion në rastin MTPT, të Fatmir Limajt, Endrit Shalës dhe të tjerëve, i kishet kushtuar këtij të fundit si dhe zëvendëskryeministrit Dardan Gashi, ish-kryetarit të Komunës së Skenderajt, Sami Lushtaku dhe tre të tjerëve, me dënime me gjobë.

Të gjithë këta akuzoheshin sipas aktakuzës së ngritur më 16 maj 2018, se kishin kryer veprën penale “mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”.

Gjykata Themelore në Gjakovë, dega në Malishevë, më 1 mars 2019, të akuzuarit Dardan Gashi, Endrit Shala, Sami Lushtaku, Behar Amerllahu, Fadil Demiri dhe Sherif Krasniqi i kishte shpallur fajtor për këtë vepër.

Ish-ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi ishte dënuar me 1700 euro gjobë, kurse, ish-ministri i Tregtisë dhe Industrisë Endrit Shala ishte dënuar me 2400 euro gjobë.

Ish-kryetari i Skenderajt, Sami Lushtaku ishte dënuar me 1700 euro gjobë, aq sa ishin dënuar edhe edhe tre të akuzuarit e tjerë, Behar Amerllahu, Fadil Demiri si dhe Sherif Krasniqi.

Kundër këtij vendimi, ankesë në Apel kishte bërë prokuroria, mirëpo, GjA në korrik të 2019 kishte vendosur të refuzojë ankesën dhe të vërtetojë aktgjykimin e Themelores.

Sipas GjA, rrethanat e pretenduara rënduese në ankesën e prokurorisë, sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk janë të asaj rëndësie, që të ndikonin në shqiptimin e një dënimi tjetër nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë

Lidhur me këtë rast, Gjykata e Apelit nuk kishte mbajtur seancë publike.

2. Rasti “Bellanica”

I akuzuar: Fatmir Limaj

Vepra penale: “Përgjegjësia e komandës”

Vendimi i Apelit: Vërtetim i aktgjykimit lirues të Gjykatës Themelore

Sipas aktakuzës së PSRK-së, Fatmir Limaj dyshohej se në cilësinë e komandantit ushtarak të Brigadës 121, të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), nuk ka ndërmarrë masa të arsyeshme dhe të nevojshme brenda kompetencave të tij, për të parandaluar apo ndaluar vrasjen e Ramiz Hoxhës nga fshati Bellanicë dhe Selman Binishit, nga fshati Banjë, Komuna e Malishevës, të cilët me arsyetimin se janë bashkëpunëtorë të okupatorit serb, janë marrë peng nga disa persona me maska, më 2 tetor 1998, dhe më pas janë ekzekutuar. Me çka, sipas PSRK-së, i akuzuari ka shkelur nenin 3 të Konventave të Gjenevës dhe Kodin Penal, i cili e inkriminon si vepër penale edhe “përgjegjësinë e komandës”.

Lidhur me këtë akuzë, Gjykata Themelore në Gjakovë, më 9 mars 2018 e kishte shpallur të pafajshëm Fatmir Limajn.

Kundër vendimit të Themelores, ankesë në Apel kishte ushtruar PSRK-ja, mirëpo, kjo ankesë ishte hudhur poshtë nga Apelit me arsyetimin shkalla e parë ka dhënë arsye të qarta dhe të plota lidhur me pafajësinë e të akuzuarit Limaj.

Seanca e Gjykatës së Apelit në këtë rast kishte qenë jo-publike.

3. Dënime të përjetshme për vrasjen e familjarëve

I akuzuar: Pjetër Ndrecaj

Vepra penale: “Vrasje e rëndë”; “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”

Vendimi i Apelit: Ndryshim i aktgjykimit – Dënim i përjetshëm për të akuzuarin

Sipas aktakuzës, Pjetër Ndrecaj akuzohej se më 7 gusht 2018, në Gjakovë, në shtëpinë e familjes së viktimës, me dashje ka privuar nga jeta bashkëshorten e tij V.N, dhe vajzën e tij K.N. Në aktakuzë thuhet se i akuzuari ka shkuar në shtëpinë e vëllezërve të viktimës i armatosur, ku ka qëlluar më pushkën automatike në drejtim të shtëpisë, si dhe ka qëlluar me armë bashkëshorten dhe vajzën e tij, të njëjtat nga plagët e marra kanë ndërruar jetë.

Në nëntor 2018, Pjetër Ndrecaj, dënuar nga Gjykata Themelore në Gjakovë me 24 vejt burgim efektiv. Ndrecaj ishte dënuar me 23 vjet burgim për vrasje të dyfishtë, dhe me dy vjete burgim për armëmbajtje pa leje, ndërsa, si përfundim, ndaj tij, ishte shqiptuar dënim unik në kohëzgjatje prej 24 vjet.

Mirëpo, dy muaj më vonë, Gjykata e Apelit e kishte ndryshuar këtë aktgjykim të Themelores, ashtu që, të akuzuarit Ndrecaj i kishte shqiptuar dënim me burgim të përjetshëm. Siç kishte vlerësuar Apeli duke qenë se janë shkaktuar pasoja tejet të rënda si objekt mbrojtës i veprës penale vrasje e rëndë, e që është jeta e njeriut si vlera më e madhe e mbrojtjes penale juridike dhe vepra është kryer në rrethana posaçërisht renduese, ishin plotësuar dy kushte ligjore nga neni 44 i KPRK-së, për shqiptimin e dënimit me burgim të përjetshëm.

Megjithatë, as ky aktgjykim nuk e kishte pasur jetën e gjatë pasi që, Gjykata Supreme, në qershor 2019 e kishte kthyer lëndën në pikën zero. Sipas vendimit të Supremes, pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit ishte bërë në kundërshtim të plotë me dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, pasi që Ndrecaj akuzohet se ka kryer veprën penale të vrasjes së rëndë, e cila kryhet në rastet kur me dashje kryhen dy apo më shumë vrasje, kurse deklarimi i tij ishte vetëm përkitazi me vrasjen e ish-bashkëshortes së tij e jo edhe për vajzën e tij. Sipas Supremes, shkalla e parë nuk ka guxuar të kalojë mbi këtë shkelje dhe të procedojë me gjykim, shkelje të cilën pastaj nuk e kishte marr parasysh as Apeli. Kjo çështje tashmë është duke u gjykuar për herën e dytë në shkallën e parë.

I akuzuar: Naser Pajazitaj

Vepra penale: “Vrasje e rëndë”; “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”

Vendimi i Apelit: Vendimi i parë – Rigjykim; Vendimi i dytë – Vërtetim i aktgjykimit të shkallës së parë

Sipas Prokurorisë Themelore në Pejë, Naser Pajazitaj akuzohej se me 9 nëntor 2015 rreth orës 14:30 në bjeshkët e Strellcit të Komunës së Deçanit, me armë, në mënyrë mizore ka privuar nga jeta të ndjerën Donjeta Pajazitaj. Derisa e ndjera ka qenë duke shkuar në punë në këmbë, aty kalon i pandehuri me veturën e tij, e merr të ndjerën, e dërgon në bjeshkët e lartcekura, ku fillimisht e privon nga jeta duke shtënë dy herë në kokë të saj, e më pas për të humbur gjurmët të njëjtën e mbulon me disa drunj dhe largohet nga vendi i ngjarjes. Trupi i të ndjerës gjendet pas më shumë se një muaji.

Gjykata Themelore në Pejë, më 6 mars 2018, e kishte liruar nga akuza Naser Pajazitajn, mirëpo, në shtator 2018, Gjykata e Apelit e kishte kthyer në rigjykim rastin.

Pas rigjykimit, shkalla e parë të akuzuarit Pajazitaj i kishte shqiptuar dënim me burgim të përjetshëm. E këtë dënim, në qershor 2019 e ka vërtetuar edhe Gjykata e Apelit. Sipas Apelit, meqenëse në veprimet e të akuzuarit qëndrojnë rrethana posaçërisht renduese, ashtu sikurse ka vlerësuar edhe gjykata e shkallës së parë, dënimi me burgim të përjetshëm është në harmoni me rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre dhe shkallen e përgjegjësisë penale të akuzuarit, dhe më këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit.

Mirëpo, aktgjykimet e shkallës së parë dhe Apelit, i kishte anuluar Gjykata Supreme, e cila kishte konstatuar se të dy aktgjykimet kanë qenë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, për shkak të mos arsyetimit të refuzimit të propozimeve të bëra nga mbrojtësi i të pandehurit.

4. “Drita e gjelbër” për gjykimin e rastit “Pronto”

Të akuzuar: Adem Grabovci; Besim Beqaj; Zenun Pajaziti; Nijazi Kryeziu; Arbenita Pajaziti; Ilhami Gashi; Fatmir Shurdhaj; Sedat Gashi; Ismet Neziraj; Xhavit Dakaj; Rexhë Abazi

Vepra penale: “Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës” në bashkëkryerje

Vendimi i Apelit: Refuzim i ankesave, vërtetim i aktvendimit të Gjykatës Themelore

Në këtë rast të akuzuar janë, ish-shefi i grupit parlamentar të PDK-së, Adem Grabovci, ish-ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, ish-deputeti i PDK-së, Zenun Pajaziti, ish-kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Prizrenit, Nijazi Kryeziu, ish-shefja e Njesisë për furnizim në Ministrinë e Shëndetësisë, Arbenita Pajaziti, ish-sekretari i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ilhami Gashi, ish-zëvendësministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Fatmir Shurdhaj, ish-këshilltari politik në MPB, Sedat Gashi, Ismet Neziraj, Xhavit Dakaj dhe Rexhë Abazi.

Të gjithë këta po akuzohen për kryerjen e veprës penale “Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës në bashkëkryerje”, nga neni 193 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, prej të cilave disa prej veprave kanë mbetur në tentativë.

Në maj 2019, Gjykata e Apelit e kishte dhënë “dritën e gjelbër”, për fillimin e gjykimit të një prej rasteve më të njohura në Kosovën e pasluftës, rastit “Pronto”. Apeli i kishte refuzuar ankesat e mbrojtësve së të akuzuarve duke e lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë e cila po ashtu kishte vlerësuar se ka prova të mjaftueshme që ky rast të procedohet në shqyrtim gjyqësor.

Paraprakisht, në shtator 2018, Gjykata e Apelit e kishte caktuar si kompetent Departamentin e Krimeve të Rënda të Gjykatës Themelore në Prishtinë për ta gjykuar këtë rast, pasi që e kishte aprovuar si të bazuar ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës kundër vendimit të shkallës së parë e cila kishte vlerësuar se Departamenti i Krimeve të Rënda nuk është kompetent për ta gjykuar këtë rast.

5. Dy rastet e krimeve të luftës

Të akuzuar: Skënder Bislimi

Vepra penale: “Krime kundër popullatës civile”

Vendimi i Apelit: Vërtetim i aktgjykimit dënues të Gjykatës Themelore

Prokuroria Themelore në Prishtinë, më 28 dhjetor 2012, kishte ngritur aktakuzë ndaj Skënder Bislimit të cilin e ngarkon me veprën penale “krime kundër popullatës civile” nenet 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, aktualisht i penalizuar sipas neneve 31 dhe 152 të Kodit Penal të Kosovës.

Në aktakuzë thuhet se më 26 mars të vitit 1999, në Fushë Kosovë, në bashkëkryerje me të paktën dhjetë autorë tjerë të njohur dhe të panjohur, duke vepruar si pjesëtarë të forcave të armatosura serbe, Bislimi ka dhunuar integritetin trupor dhe shëndetin e më shumë se 40 cilëve, meshkuj shqiptarë të Kosovës.

Gjykata Themelore në Prishtinë, më 25 tetor 2018, kishte dënuar me dhjetë vjet burg të akuzuarin për krime lufte ndaj popullatës civile në Kosovë në vitin 1999, Skënder Bislimin.

E kënaqur me dënimin e shqiptuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, kishte mbetur Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSKR), e cila nuk kishte ushtruar fare ankesë në shkallën e dytë, kurse mbrojtja e Bislimit kishte kërkuar nga Apeli lirimin e të akuzuarit ose zbutje të dënimit.

GjA, më 20 gusht 2019, kishte refuzuar ankesat e mbrojtësve të Bislimit duke lënë në fuqi dënimin e shqiptuar nga shkalla e parë.

Të akuzuar: Remzi Shala

Vepra penale: “Krime kundër popullatës civile”

Vendimi i Apelit: Ndryshim i aktgjykimit të Gjykatës Themelore – Zbutje e dënimit

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, kishte ngritur aktakuzë ndaj Ish-komandanti i UÇK-së, i njohur si komandant “Molla e Kuqe”, për vrasjen e një civili gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Shala akuzohej nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës se gjatë kohës së luftës në Kosovë, më 26 qershor 1998, duke vepruar si pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), së bashku edhe me disa pjesëtarë tjerë të paidentifikuar, kanë marrë nga shtëpia e tij, viktimën Haxhi Përteshi. Sipas aktakuzës, Remzi Shala, i cili ishte i vetmi pa maskë në kokë, së bashku edhe me 5-6 pjesëtarë tjerë të UÇK-së, të maskuar, nën dyshimin se i ndjeri ishte bashkëpunëtorë i forcave serbe, kanë shkuar në fshatin Duhël dhe të njëjtin e kanë dërguar në një vend të panjohur.

Në aktakuzë thuhet se djali i viktimës, Agron Përteshi, i kishte parë ata të largoheshin, së bashku me babanë e tij, në drejtim të fshatit Grajqevc dhe pas disa dite trupi i pajetë i të ndjerit ishte gjetur në afërsi të rrugës, afër qendrës së fshatit Duhël.

Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda më 8 korrik 2019, kishte marr aktgjykim me të cilin të akuzuarin Shala e kishte shpallur fajtor për veprën penale krime lufte kundër popullatës civile duke u dënuar me 14 vite burg.

Duke vendosur lidhur me ankesat e palës së dëmtuar në këtë rast, e cila kishte kërkuar dënim më të lartë për Shalën, si dhe ankesën e mbrojtjes së të akuzuarit e cila kishte kërkuar lirimin nga akuza apo kthimin e rastit në rigjykim, GjA me 26 nëntor 2019, kishte vendosur që Shalës t’i zbutej dënimi nga 14 vjet burg, në 10 vjet.

Gjykata e Apelit kishte gjetur se në veprimet e të akuzuarit manifestohen vetëm elementet e veprës penale “*Krimet e luftës kundër popullsisë civile*” nga neni 142 lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal Jugosllav, lidhur me nenin 3 (1.a) të Konventës së IV të Gjenevës, por jo edhe elementet e veprës penale nga neni 152 par. 1 dhe 2 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

11. Rekomandime

1. Gjykata e Apelit t'i trajtojë në mënyrë më të kujdesshme rastet e profilit të lartë dhe t'i evitojë shkeljet në favor të akuzuarve, shkelje të cilat të paktën në disa raste të profilit të lartë janë konstatuar edhe nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, e cila sipas kufizimeve ligjore, nuk ka mundësi që këto raste t'i kthej në rigjykim.
2. Përkundër se nuk janë të obliguar me ligj në mbajtjen e seancave publike në rastet kur dënimet e shqiptuara në shkallë të parë nuk janë me burg efektiv, në raste të cilat janë me interes për publikun, Gjykata e Apelit të mbaj seanca publike.
3. GjA t'i trajtojë me prioritet rastet e shënjestruara për liberalizimin e vizave.
4. Për të shmangur parashkrimin e veprave penale për të akuzuarit, Gjykata e Apelit në rastet kur ia mundëson ligji, të vendos në mënyrë meritore dhe lëndët mos të kthehen në rigjykim shumë herë ashtu që të mos krijohet "ping-pong" gjyqësor.
5. Gjykata e Apelit të vazhdojë praktikën e publikimit të dhënave individuale të punës të secilit gjykatës veç e veç.
6. Gjykata e Apelit të adresojë problemet e Politikës Ndëshkimore duke respektuar dhe zbatuar Udhëzuesin për Politikë Ndëshkimore të miratuar nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës.
7. GjA të publikojë të gjitha aktgjykimet në faqen zyrtare të gjykatës, në afat prej 60 ditë nga data e nxjerrjes së aktgjykimit, ashtu siç edhe kërkohet me Ligjin për Gjykatat.
8. Të publikohet me rregull orari i seancave publike në faqen zyrtare të gjykatës.
9. Gjyqtarët e GjA-së të arsyetojnë mjaftueshëm aktgjykimet e GjA-së, në atë mënyrë që palët dhe publiku të kuptojnë drejtë se pse në rastin konkret një gjyqtarë ka vendosur në këtë mënyrë.
10. Gjyqtarët e GjA-së të bëjnë përpjekje që në aktgjykimet e tyre t'i shmangen gabimeve drejtshkimore dhe sintaksore, në mënyrë që aktgjykimet të jenë të paktën të kuptueshme.
11. Gjykata e Apelit të përmbahen në kritikën sa i përket politikës ndëshkimore, por problemet me politikën ndëshkimore të adresojë në kuptim të kompetencave të saja ligjore, në atë mënyrë që të vendosë standarde dhe praktikë të duhur juridike në këtë fushë.
12. KGJK dhe GjA të kujdesen që të dhënat statistikore të jenë të sakta dhe në harmoni.
13. KGJK me anë të mekanizmave të saj të brendshëm, të vlerësojë performancën dhe të mbajë përgjegjësi në kuadër të mandatit ligjor gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, rastet e të cilëve prishen shumë herë nga Gjykata Supreme.
14. KGJK të ndërmarrë masa ndaj gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit, Divizioni në Mitrovicë, të cilët as për së afërmi nuk zgjidhin lëndë me normën orientuese të përcaktuar nga KGJK në kuadër të mandatit ligjor për shkak të performancës së dobët.